

**LIGJ**  
**I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE (\*)**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Lënda e rregullimit**

Me këtë ligj rregullohen parimet dhe objektivat për menaxhimin e mbeturinave, strategjitë, planet dhe programet për menaxhimin e mbeturinave, të drejtat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, mënyra dhe kushtet me të cilat mund të kryhet mbledhja, transportimit, përdorimi i përsëritshëm, trajtimi, ruajtja, përpunimi dhe largimi i mbeturinave, eksporti, importi dhe transiti i mbeturinave, vendosja e sistemit informativ, si dhe financimi dhe mbikëqyrja mbi menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 2**

**Zbatimi i ligjit**

Dispozitat e këtij zbatohen në të gjitha llojet e mbeturinave të përmendura në listën e llojeve të mbeturinave të nenit 15 të këtij ligji, përveç të;

- 1) gazrave të lëshuar në atmosferë;
- 2) tokës, duke përfshirë truallin e pagropuar të kontaminuar dhe truallin nën ndërtesat të cilat janë përgjithmonë të lidhur me të;
- 3) tokës jo të kontaminuar dhe materialeve të tjera natyrore të gërmuara gjatë aktiviteteve ndërtimore, kur është e sigurt që materiali do të përdoret për qëllime të ndërtimitarisë në gjendjen e tij natyrore në vendin nga ku është gërmuar;
- 4) mbeturinat radioaktive;
- 5) eksplozive të çaktivizuara dhe mjete dhe materiale plasëse;
- 6) ujëra të zeza, me përjashtim të mbeturina të lëngshme;
- 7) produkteve të kafshëve, duke përfshirë përpunimin e produkteve të përfshira me rregullativat për nus produktet të origjinës së kafshëve, përveç të atyre të cilat janë të dedikuara për djegie, deponim ose për përdorim në stacionet për biogaz ose kompostim;
- 8) kufomat e kafshëve të cilat largohen në pajtim me rregullativat për nus produktet me origjinë të kafshëve;
- 9) mbeturina cila krijohet si rezultat i hulumtimit, shfrytëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së minierat e lëndëve të para dhe puna e kamenolomit në pajtim me rregullativat për minierat e lëndëve të para;
- 10) sedimentet u zhvendosura në ujërat sipërfaqësore për menaxhimin e ujit për shkak të menaxhimit të ujërave dhe rrjedhave të ujërave ose për parandalimin e përmytjeve ose për të zbutur efektet e përmytjeve dhe thatësirave, ose për të përmirësuar bonifikimin e tokës nëse sedimentet nuk janë të rrezikshme dhe
- 11) materiet fekale, nëse nuk janë përfshirë me pikën 7) të këtij neni, kashtë dhe materiale të tjera natyrore bujqësore ose pylltarisë të cilat nuk janë të rrezikshme dhe përdoren në bujqësi, pylltari ose për prodhimin e energjisë së biomasës nëpërmjet proceseve ose metodave që nuk rrezikojnë shëndetin e njeriut dhe nuk dëmtojnë mjedisin jetësore.

\*Me këtë ligj bëhet harmonizimi me direktivën 2008/98EC të Parlamentit Europian dhe të këshillit nga 19 nëntori 2008 për hedhurina dhe heqjen e direktivave të caktuara (CELEX 32008L0098).

### **Neni 3** **Objektivat e ligjit**

Objektivat e këtij ligji janë të sigurohet:

- 1) shmangia edhe në sasi sa më të madhe të mundshme, zvogëlimi i sasisë së mbeturinave të krijuara;
- 2) shfrytëzim të përbërësve të përdorshëm në mbeturina;
- 3) zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet ruajtjes dhe kursimit të resurseve natyrore;
- 4) parandalimit të ndikimeve negative të mbeturinave mbi mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut në pajtim me parimet e qarkullimit të ekonomisë;
- 5) largimi i mbeturinave në mënyrë që është e pranueshme për mjedisin jetësor dhe
- 6) shkalla e lartë e mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

### **Neni 4** **Veprimtari e interesit publik**

Menaxhimi i mbeturinave është veprimtari e interesit publik, e cila kryhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullativave të miratuar në bazë të këtij ligji.

### **Neni 5** **Zbatimi i dispozitave të ligjit**

(1) Në menaxhimin e mbeturinave zbatohet edhe Ligji i Mjedisit Jetësor, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me këtë ligj.

(2) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj zbatohet Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me këtë ligj.

### **Neni 6** **Përkufizimet**

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **“Mbeturina”** është secila substancë, materie apo lëndë e kategorisë së mbeturinave të përmendura në listën e mbeturinave në pajtim me nenin 15 të këtij ligji, që prodhuesi apo poseduesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo prej tij kërkohet ta hedhë;

2. **“Mbeturinat e rrezikshme”** është mbeturinë e cila në pajtim me karakteristikat që i posedon një ose më shumë veti të rrezikshme të cilat mund të shkaktojnë rrezik ndaj mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut, në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;

3. **“Mbeturinat e parrezikshme”** është mbeturinë e cila nuk posedon asnjë veti të mbeturinave të rrezikshme;

4. **“Mbeturinat e amvisërisë”** është mbeturinë e cila rregullisht mbledhet nga amvisëritë, duke i përfshirë edhe mbeturinat që lihen në vendet e mbledhjes dhe qendra mbledhëse dhe mbeturinat e ndara të mbledhura të rrezikshme nga amvisëritë, mbeturinat e rënda, mbeturinat e kopshtarisë dhe etj.

5. **“Mbeturinat komunale”** është mbeturinë e amvisërive, si dhe lloje të tjera të mbeturinave të cilat krijohen nga sektori komercial dhe industria i cili për shkak të karakteristikave të saj, përbërjes dhe sasia e ngjashme me mbeturinat e amvisërisë;

6. **“Lagjja e izoluar”** është lagje me më shumë se 50 banorë, por jo më shumë se 500 dhe jo më shumë se 5 banorë në metër katror, e cila është e larguar nga aglomeria urbane me e afër me së paku 250 banorë në metër katror, por më pak se 50 km ose ku vendi i qasjes është i rënduar në periudha kohore të caktuara të vitit për shkak të kushteve hidrometeorologjike;

7. **“Mbeturinat interne”** është mbeturinë e cila është rezistuese dhe nuk i nënshtrohet asnjë transformimit të rëndësishëm fizik, kimik ose biologjike, dhe nuk tretet, nuk digjet, nuk reagon në ndonjë mënyrë tjetër fizike dhe kimike, nuk biogradohet, ndërsa mbeturinat dhe pjesët e saj nuk ndikojnë në materiet të cilat vinë në kontakt, në mënyrë me të cilat do të rrezikohet mjedisi jetësor, jeta dhe shëndetit i njeriut me çka sasia dhe përmbajtja e përgjithshme e substancave ndotëse në mbeturina dhe ekotoksike e procedurimit patjetër të jetë i pa rëndësishëm që të mos e ndotë cilësinë e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor;

8. **“Mbeturinat komerciale”** është çdo lloj tjetër të mbeturinave e cila krijohet nga personat fizik dhe juridik gjatë kryerjes së veprimtarive komerciale, industriale, tregtare, shërbyese, administrative dhe veprimtarit të ngjashme sipas natyrës ose përbërjes së mbeturinave të amvisërisë (veprimtari tregtare në shumicë dhe pakicë, shërbime hotelerike dhe baret, zyrat ose tregjet, si dhe mbetjet e sektorit shërbyes);

9. **“Mbeturinat biozbërthyesë”** është çdo mbeturinë e cila mund të degradohet nga proceset e zbërthimit anaerobe (pa oksigjen) ose aerobe (me praninë të oksigjenit), siç janë mbeturinat e ushqimit ose kopshtarisë, si dhe letra dhe kartoni;

10. **Biombeturina** - mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga amvisëritë, restorantet, objektet hotelerike dhe shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme me mbeturinë që krijohet nga kapacitete përpunuese të ushqimit, si dhe mbeturina të ngjashme me veti biodegraduese e cila është e ngjashme sipas natyrës, përbërjes dhe sasisë;

11. **“Mbeturinat ndërtimore”** është mbeturinë e cila krijohet gjatë ndërtimit dhe rrënimit;

12. **“Mbeturinat industriale”** është mbeturinë e cila krijohet në proceset e prodhimit në industri dhe dallon nga mbeturinat komunale sipas sasisë, karakteristikave dhe përbërjes së saj;

13. **“Mbeturinat mjekësore”** është mbeturinë e cila krijohet në institucione shëndetësore dhe institucione veterinarë dhe ndodh si prodhim i përdorimit të mjeteve dhe materialeve gjatë diagnostimit, mjekimit, trajtimit dhe preventivit të sëmundjeve të njerëzimit dhe kafshët.;

14. **“Bifenile poliklorin”** janë:

- bifenile poliklorinike (në tekstin e mëtutjeshëm: PCB),
- terfenile poliklorinike (në tekstin e mëtutjeshëm: PCT),
- metan monometiltetraklorodifenil,
- metan monometildiklorodifenil,
- metan monometildibromodifenil,
- si dhe çdo përzierje që përmban ndonjë nga substancat e mësipërme, në një sasi totale mbi 0.005 të përqindjeve të yndyrave;

15. **„Pajisja që përmban PCB”** është pajisje e cila përmban ose ka përmbajtur PCB, për shembull, transformatorët, kondensatorët, kontejnerët dhe kontejnerët e tjerë që përmbajnë mbetje të PCB, pajisje të tjera që përmbajnë ose kanë përmbajtur PCB dhe jo të dekontaminuara, si dhe pajisje të tjera që përmbajnë PCB e cila trajtohet si përmbajtës i PCB, përveç nëse ka arsye të supozohet e kundërta;

16. **„ PCB-të e përdorura”** janë të gjitha PCB-të që krijuesi ose poseduesi i hedh, synon t'i hedhë ose kërkohet prej tij që t'i hedhë;

17. **“Mbeturina të dioksidit të titanit”** është çdo mbetje nga prodhimi, përpunimi dhe përdorimi i dioksidit të titanit që prodhuesi ose poseduesi e hedh, synon ta hedhë ose kërkohet nga ai ta hedhë;

18. **„Mbeturinat e azbestit”** janë mbetje nga prodhimi, përpunimi dhe përdorimi i asbestit, si dhe substancave, materialeve dhe produkteve që përmbajnë asbest, të cilat prodhuesi ose pronari i hedh, synon t'i hedhë ose kërkohet nga ai t'i hedhë;

19. **“Mbeturinat e vajit”**- janë vajrat minerale ushqimore, sintetike ose vajra industriale të cilat gjenden të lëngshme ose gjysmë të lëngshme të cilët janë bërë të papërshtatshme për përdorje për dedikimin e parë që kanë pasur, e veçanërisht vajrat e përdorura për motor me djegie të brendshme, vajrat për ndërruesit e shpejtësisë, vajrat për lubrifikim, vajrat për turbina dhe vajrat hidraulike, duke përfshirë edhe vajrat e mbetjeve nga rezervatet, përzierja e ujit dhe vajit dhe emulsionet;

20. **„Mbeturinat e ushqimit”** është mbeturinë e definuar në pajtim me rregullativat për ushqoim;

21. **„Krijuesi i mbeturinave”** është person juridik dhe fizik i cili krijon mbeturina si rezultat i veprimtarisë ose aktivitetit të cilën e kryen (krijuesi i parë) dhe ose çdo person i cili kryen operacione të parapërpunimit, përzierjes ose ndonjë operacion tjetër për shkak të cilave ndryshohet karakteri ose përbërja e krijuesit parësor të mbeturinës (krijues sekondar);

22. **„Zotëruesi i mbeturinave”** është person juridik dhe fizik i cili ka mbeturina në menaxhimin e tij;

23. **„Ndërmjetësuesi i personit juridik”** i cili organizon përpunimin dhe largimin e mbeturinave, në emër dhe në llogarit të ndonjë subjektit tjetër duke përfshirë edhe ndërmjetësuesit të cilët nuk posedojnë mbeturina;

24. **„Tregtari i mbeturinave”** është person juridik i cili në emër dhe në llogari të tij blen dhe shet mbeturina, edhe atëherë kur nuk është posedues i mbeturinës;

25. **„Rrjedhat e veçanta të mbeturinave”** janë lloje të veçanta të mbeturinat të cilët kanë karakteristika përkatëse për shkak të cilave janë shënuar rregulla të veçanta për menaxhim të përmendura në këtë ligj ose me ndonjë ligj të veçantë;

26. **„Ofruesi i shërbimit”** është person juridik i themeluar nga, ose i cili ka lidhur kontratë në kohë të caktuar me organi e qeverisë qendrore ose lokale për ofrimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave në rajon të caktuar, për kohë të caktuar ose të pacaktuar;

27. **„Operatori i sistemit rajonal”** është person juridik i cili kryen shërbime për menaxhim të mbeturinave në sistemin rajonal i cili mund të jetë i themeluar nga, ose shumica e menaxhimit e kanë komunat, gjegjësisht Qyteti i Shkupit, gjegjësisht është i themeluar ose shumicën e menaxhimit e ka Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose e kryen shërbimin me lidhje të kontratës në procedurë të ankandit me koncesion për menaxhim me sistemin rajonal në pajtim me rregullativat për koncesion dhe partnerit privato-publik;

28. **„Menaxhimi i mbeturinave”** është veprimtari, gjegjësisht aktivitet i cili përfshin operacione të grumbullimit, transportimit, ruajtjes, përpunimit, ripërdorimit, asgjësimi dhe qarkullimit të mbeturinave, duke përfshirë edhe mbikëqyrje mbi këto operacione, si dhe masat e mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut gjatë orarit të punës në objektet dhe instalimet për largim të mbeturinave, si dhe kujdesje të instalimeve pas ndërprerjes së punës së tyre ose lokacionit ku është largua mbeturina, duke i përfshirë edhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e ndërmjetësuesit dhe tregtarit me mbeturina ;

29. **„Grumbullimi i mbeturinave”** është përmbledhje e aktiviteve të organizuar duke i përfshirë edhe procedurat me të cilat përgatitet mbeturina për seleksionim dhe ruajtje parësore për shkak të transportimit të saj;

30. **„Grumbullimi i mbeturinave veçmas”** (selektimi) është mbledhja e mbeturinave veçmas të mbeturinave të selektuara sipas llojit dhe karakteristikave të mbeturinave që të lehtësohet trajtim përkatës;

31. **„Vendi i grumbullimit”** është vend ku janë vendosur një ose më shumë kontejnerë të cilët shërbejnë për mbledhje dhe selektim të mbeturinave për shkak të marrjes së saj me qëllim të realizimit të aktiviteve për menaxhimin e mbeturinave ose transportimit të saj deri në qendrat mbledhëse ;

32. **„Qendra e grumbullimit“** është objekti ose pjesa e objektit ku mbeturinat komunale lihen pa pagesë nga ana e amvisërive, duke përfshirë edhe mbeturinat e dedikuara për riciklim të cilat mbledhen dhe ruhen përkohësisht, i cili për shkak të vëllimit të madh ose për shkak të karakteristikave të rrezikshme që i ka mbeturina të njëjta nuk lejohen të hidhen në shporta ose kontejnerë për mbeturinave të vendosura në vendet mbledhëse;

33. **„Grumbulluesi i mbeturinave“** është person juridik i cili posedon leje për mbledhje dhe transportim të mbeturinave të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

34. **„Parandalimi i krijimit të mbeturinave”** janë aktivitetet dhe masat e ndërmarra para substancat, materialet ose produktet të bëhen mbeturina me çka zvogëlohet:

- sasia e mbeturinave, përfshirë edhe nëpërmjet përdorimit të përsëritshëm të produktit ose vazhdimin e kohëzgjatjes së jetës së produktit;

- ndikimet negative të mbeturinave të krijuara mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njeriut; ose

- përmbajtja e materieve të dëmshme në materialet dhe produktet;

35. **„Përdorimi i përsëritshëm i mbeturinave”** është çdo aktivitet ose masë me të cilën sigurohet që produktet ose pjesë të produkteve të cilat nuk janë mbeturinë përsëri të përdoren për të njëjtën qëllim për të cilën kanë qenë të dedikuara në gjendjen e mëparshme;

36. **„Përgatitja për përdorim të përsëritshëm”** është çdo aktivitet i kontrollit, pastrimit ose riparimit me të cilën produktet ose pjesë e produkteve të cilat janë bërë mbeturina, ndërsa të cilat janë mbledh nga personat të cilët posedojnë leje përkatëse për menaxhimin e mbeturinave nëpërmjet sistemit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesi të vendosura me

rregullativat për menaxhimin e mbeturinaveve të rrjedhjeve të veçanta, përgatiten që të mund përsëri të përdoren pa përpunim plotësues;

37. „**Trajtimi i mbeturinave**” janë aktivitetet e përpunimit ose largimit të mbeturinave, duke përfshirë edhe aktivitetet parapërgatitore për përpunim ose largim të mbeturinave;

38. „**Ripërpunimi i mbeturinave**” është çdo operacion në të cilin rezultati kryesor është që mbeturinat të shërbejnë si një zëvendësim për materialet që përndryshe do të përdoren për të kryer një funksion të veçantë ose mbeturinat që janë duke u përgatitur për të kryer atë funksion, instalim ose qëllim tjetër ekonomik;

39. „**Riciklimi i mbeturinave**” është çdo aktivitet me të cilat mund të përpunohet në prodhimtari, materie ose substancë nga dedikim parësor ose ndonjë dedikim tjetër. Riciklimi i mbeturinave përfshinë ripërpunim të materieve organike, por sidomos aktivitet e ripërpunimit të mbeturinave për fitimin e energjisë ose ripërpunim në materie të cilat janë të dedikuara për përdorim të karburantit ose ndonjë material tjetër për mbulim ose hedhje;

40. „**Mbushja dhe hedhja**” është çdo operacion i përpunimit të mbeturinës kur mbeturina përkatëse përdoret për mbulimin e tokës ose për qëllime inxhinierie në rregullimin e peizazhit ose ndërtimit, në vend të përdorimit të materialeve tjera jo-mbetrine të cila do të përdoren për këtë qëllim;

41. „**Ruajtja**” është ruajtja kohore dhe e organizuar e mbeturinave në objektet të cilat i plotësojnë kushtet e shënuara për këtë dedikim, pas marrjes paraprake të lejes për ruajtje të mbeturinave të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, për periudhë më të shkurtë se tre vjet, kur mbeturina e ruajtur është dedikuar për përpunim, ose periudhë më të shkurtë se një vjet, kur mbeturina është dedikuar për largim;

42. „**Ripërtërimi i mbeturinave të vajit**” është çdo aktivitet riciklimi që mund të krijojë vajra bazë me rafinimin e mbeturinave të vajrave, në veçanti duke hequr papastërtitë, produktet e oksidimit dhe aditivët që përmbahen në këto vajra;

43. „**Menaxhuesi i mbeturinave**” është person fizik i cili posedon vërtetim dhe është përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 47 dhe 48 të këtij ligji;

44. „**Menaxhuesi i lartë i mbeturinave**” është person fizik i cili posedon certifikatë për operator në pajtim me nenin 47 dhe 49 të këtij ligji;

45. „**Largimi i mbeturinave**” është aktivitet i cili nuk paraqet ripërpunim të mbeturinave, madje edhe atëherë kur me operacionin për largim të mbeturinave si pasojë sekondare del shfrytëzimi i substancave, materieve ose energjisë në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;

46. „**Deponimi**” është operacion për largimin e mbeturinave në deponi;

47. „**Deponia**” është instalim i dedikuar për largim të mbeturinave, e cila mund të jetë sipërfaqësore (mbi tokë) ose nëntokësore (në tokë) duke i përfshirë edhe instalimet të dedikuara për largim të mbeturinave nga ana krijuesit të mbeturinave në vendin e tij të krijimit. Për deponi nuk llogariten instalimet ku mbeturina përgatitet për përpunim me qëllim të transportimit të tij deri te instalimet për trajtim, përpunim ose largim.

Deponia i përfshin edhe:

- lokacionet e brendshme për largim të mbeturinave ku krijuesi i mbeturinave e largon mbeturinë që e ka në pronësi nga vendi i krijimit

- vendndodhje e caktuar që përdoret vazhdimisht për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave (për më shumë se një vit), me përjashtim të vendeve për stacionet e transferimit dhe vendeve për ruajtje (magazininim) e mbeturinave të nenit 41 të këtij ligji;

48. „**Teknikat e disponueshme më të mira**” janë teknikat të definuar me rregullativat e mjedisit jetësor;

49. „**Stacionet e transferimit të mbeturinave**” është lokacion ose objekt për ruajtjen, përgatitjen dhe transferim të përkohshëm të mbeturinave komunale ose mbeturinave komerciale për shkak të vetive të saj të përafërta me mbeturinat komunale, të dedikuara për transport deri tek objektet tjera ose impiantet për ruajtje, ripërpunim, trajtim ose largim sipas nenit 45 të këtij ligji;

50. „**Impiantet e djegies**” është çdo njësi ose pajisje e palëvizshme ose e lëvizshme për trajtimin termik të mbeturinave, me ose pa përdorimin e energjisë të fituar nga djegia, duke i përfshirë edhe djegien e mbeturinave nëpërmjet rrugës së oksidimit, si dje proceset e tjera për trajtim termik, siç janë piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, me çka substancat e

fituara me trajtim ngadalë ngadalë digjen. Instalimi përfshirë vendndodhjen, të gjitha linjat e trajtimit termik, objektet dhe impiantet për pranimin, ruajtjen dhe para-trajtimin e mbeturinave në lokacion, sistemet e shtyerjes së mbeturinave, karburanti dhe ajri, kazanet, stacionet për trajtimin e mbeturinave të gazit, për trajtim dhe ruajtje të ujërave të zeza dhe mbetjet e djegies, si dhe oxhaqeve, pajisjeve dhe sistemeve për kontrollimin, regjistrimin dhe monitorimin e kushtet e djegies;

51. „**Impiantet e djegies**“ është çdo stacion i palëvizshëm ose i lëvizshëm qëllimi kryesor i të cilit është të gjenerojë energji ose të prodhojë produkte materiale, ku mbeturinat përdoren si lëndë djegëse primare ose ndihmëse ose mbeturinat trajtohen termikisht për asgjësimin, duke përfshirë vendndodhjen, të gjitha linjat e trajtimit termik, objektet dhe instalimet për pranimin, ruajtjen dhe para-trajtimin e mbeturinave në lokacion, sistemet e shtyerjes së mbeturinave, karburanti dhe ajri, kazanet, stacionet për trajtimin e mbeturinave të gazit, për trajtim dhe ruajtje të ujërave të zeza dhe mbetjet e djegies, si dhe oxhaqeve, pajisjeve dhe sistemeve për kontrollimin, regjistrimin dhe monitorimin e kushtet e djegies;

52. „**Karburanti i fituar nga ripërpunimi i mbeturinës**“ është mbeturin tjetër komunale e cila në pajtim e specifikacionet e përcaktuara në kontratën me shkrim në mes prodhuesit të karburantit dhe shfrytëzuesit të fundit i cili ka leje për trajtim të mbeturinave në impiantet për djegie ku janë cementuar dhe ngjitura sobat (furrat) (Residual derivate fuel);

53. „**Karburanti i ngurtë i fituar me ripërpunimin e mbeturinave**“ është karburant i ngurtë i përgatitur nga mbeturinat e parrezikshme për shkak të përdorimit të saj për energji në stacionet e djegies, e cila është në pajtueshmëri me klasifikimet dhe kërkesat e përcaktuara me standardet evropiane (Solid recovered fuel);

54. „**Organi i mjedisit jetësor**“ është organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të fushës së mjedisit jetësor gjegjësisht Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikim hapësinor;

55. „**Organi profesional**“ është Drejtoria e mjedisit jetësor, organ në kuadër të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikim hapësinor (në tekstin e mëtutjeshëm: organ profesional) i formuar në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor ;

56. „**Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit**“ ( në tekstin e mëtutjeshëm: përgjegjësi e zgjeruar) është përmbledhje e rregullave dhe procedurave për prodhuesi të cilat me kryerjen e veprimtarisë dhe/ose aktivitetit plasojnë produkte të caktuara në treg me përdorimin e tyre krijohet mbeturinë e cila bën pjesë në mbeturinat e rrjedhjeve të veçanta dhe me këtë në mënyrë plotësuese e ngarkon mjedisin jetësor për shkak se ka detyrim të ndërmerr masa plotësuese në pajtim me Ligjin për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuese për menaxhimin e mbeturinave të rrjedhave të veçanta, si dhe në rregullativat për menaxhimin e mbeturinaveve të rrjedhave të veçanta

57. „**Ekonomia qarkulluese**“ do të thotë ruajtja e vlerës së produkteve, materialeve dhe burimeve për aq kohë sa të jetë e mundur duke i kthyer ato në ciklin e prodhimit të fundit të përdorimit të tyre, duke minimizuar krijimin e mbeturinave;

58. „**Pragu i disponueshmërisë së amvisërive**“ është kufiri i sipërm i shprehur si përqindje e disponueshmërisë financiare të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave të llogaritur në nivelin e rajoneve të planifikimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilën çmimi i shërbimit nuk kalon një përqindje të caktuar të të ardhurave totale mesatare për amvisëritë në rajonin ku ofrohet shërbimi; dhe

59. „**Importi**“ në kuptim të këtij ligji është lëshimi në qarkullim të lirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me rregullativat për procedurë doganore.

## **Neni 7**

### **Parimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor gjatë menaxhimit të mbeturinave**

Gjatë ndërmarrjes së veprimtarive dhe aktiviteteve të caktuar në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, personat juridik dhe fizik janë të obliguar të sigurojnë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut .

## **Neni 8**

### **Parimi i kujdesit**

Në qoftë se në bazë të njohurive bashkëkohore shkencore dhe tekniko-teknologjike, konkluzohet se një aktivitet i caktuar ose kryerja e veprimtarisë së caktuar gjatë menaxhimit të mbeturinave mund të shkakton pasoja të dëmshme ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut, do të merren masat dhe aktivitetet përkatëse për largimin e rrezikut, para se të merren dëshmitë shkencore se pasojat dëmshme do të ndodhin.

#### **Neni 9**

##### **Parimi “ndotësi paguan”**

Krijuesi ose poseduesi i mbeturinave është i obliguar t'i bartë të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë menaxhimit të mbeturinave, duke i përfshirë edhe shpenzimet e mbledhjes, transportimit, trajtimit, ruajtjes, përdorimit të përsëritshëm, riciklimin, riciklimin final, largimin, deponimin, parandalimin e krijimit të mbeturinave, mbikëqyrjen dhe monitorimin e mbeturinave, si dhe shpenzimet për masat e reeditimit dhe sanimit të dëmit e cila është shkaktuar nga menaxhimi me mbeturina ose dëmi i cili do të shkaktohej nga mbeturinat.

#### **Neni 10**

##### **Parimi i shërbimit universal**

Universaliteti i shërbimeve të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave duhet të sigurohet nëpërmjet:

- 1) mosdiskriminimit;
- 2) qëndrueshmërisë së shërbimit;
- 3) cilësisë dhe efikasitetit;
- 4) transparencës;
- 5) çmim ekonomik të pranueshëm e cila nuk e kalon pragun e disponueshmërisë, gjegjësisht mundësia që popullata ti paguan shërbimet për menaxhimin me mbeturina, dhe
- 6) mbulim i tërësishëm i territorit në të cilën ofertuesi e kryen shërbimin publik për menaxhimin e mbeturinave, e sidomos të lagjeve të izoluar në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), pika 6) të këtij ligji.

#### **Neni 11**

##### **Parimi i afërsisë**

- (1) Mbeturina parimisht duhet të mblidhet dhe të përpunohet në vendi ku janë krijuar.
- (2) Mbeturina e cila për shkak të shkaqeve të arsyeshme ekonomike dhe tekniko-teknologjike nuk mund të përpunohet në vendin ku është krijuar, gjegjësisht në rajonin ku është krijuar, patjetër duhet të dërgohet për përpunim ose të largohet në vendin më të afërt të përcaktuar për atë dedikim .
- (3) Menaxhimi rajonal me mbeturina realizohet në përputhje të parimit të afërsisë nëpërmjet miratimit, zhvillimit dhe zbatimit të dokumenteve strategjike dhe të planit për menaxhimin e mbeturinave, si dhe miratimin e vendimeve nga ana e organe qeveritare qendrore dhe lokale, duke i respektuar të gjitha vlerësimet e ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe pragun e disponueshmërisë financiare të çmimi të shërbimit për popullatën e cila është e përfshirë me menaxhim rajonal.

#### **Neni 12**

##### **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit**

Prodhuesi, eksportuesi ose personi juridik i cili lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut produkte të caktuara të cilat në fund të jetëgjatësisë së tyre krijojnë mbeturina, të cilat bëjnë pjesë në mbeturina rrjedhëse të veçanta në pajtim me këtë ligj, si dhe në pajtim me rregullativat për mbeturina rrjedhëse të veçanta, dhe i cili e ngarkon mjedisin jetësor, sipas ligjit janë përgjegjës për menaxhimin e tij.

#### **Neni 13**

##### **Parimet e përbashkëta**

Organet e administratës shtetërore, komunat në Qytetin e Shkupit, Qyteti i Shkupit dhe personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturina janë të obliguar gjatë ndërmarrjes

së masave dhe aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave të udhëheqin sipas parimeve dhe dispozitave të këtij ligji, si dhe sipas parimeve të cekura në Ligjin për mjedisin jetësor.

#### **Neni 14**

##### **Hierarkia gjatë menaxhimit të mbeturinave**

(1) Për shkak të arritjes së objektivave për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut gjatë zhvillimit të politikave të menaxhimit të mbeturinave, zbatohet hierarkia e menaxhimit të mbeturinave edhe atë sipas renditjes dhe prioritetit të fundit:

- parandalimi i krijimit të mbeturinave;
- përgatitja e mbeturinave për përdorim të përsëritshëm;
- riciklim të mbeturinave;
- llojet e tjera të përpunimit të mbeturinave, duke përfshirë përpunimin për fitimin e energjisë, dhe
- largimin e mbeturinave.

(2) Organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe personat e tjerët të cilët kryen veprimtari dhe aktivitete për mbrojtje të mjedisit jetësor për shkak të respektimit të hierarkisë gjatë menaxhimit të mbeturinave sipas paragrafit (1) të këtij neni, janë të obliguar të ndërmarrin masa me të cilat do të mundësohet arritja e rezultateve më të mira për mjedisin jetësor në pajtim me parimet për mbrojtje të mjedisit jetësor, parimi i kujdesit dhe parimi i qëndrueshmërisë, madje duke pasur llogari mbrojtjen e resurseve, realizueshmëria teknike dhe qëndrueshmëria ekonomike, si dhe ndikimi mbi shëndetin e njeriut, politikat ekonomike dhe sociale.

(3) Hierarkia e vendosur e menaxhimit të mbeturinave sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund të shmanget nga menaxhimi i llojeve të caktuara të mbeturinave vetëm për aq kohë sa ky devijim bazohet në analizën e ciklit jetësor të ndikimit total të atyre mbeturinave të veçanta në mjedis jetësor gjatë krijimit dhe menaxhimit të tij, duke marrë parasysh parimet e kujdesit dhe qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor, realizueshmërinë teknike dhe ekonomike, mbrojtjen e resurseve, si dhe parimin ndotësi paguan.

(4) Në rastet sipas paragrafit (3) të këtij neni, me kërkesë të organit të mjedisit jetësor ose organit profesional krijuesi i mbeturinës është i obliguar të dorëzojë dëshmi me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet për lëshimin e pëlqimit të paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Për shkak të nxitjes së respektimit të hierarkisë në menaxhimin me mbeturina, ndërsa në drejtim të barazimit të kushteve në treg, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të futen të dhëna të veçanta të cilat do të kontribuojnë drejt zbatimit më të madh të hierarkisë të menaxhimit të mbeturinave, gjegjësisht do t'i zvogëlojë përjashtimet në zbatimin e tij.

## **II. LLOJET DHE KLASIFIKIMI I MBETURINAVE**

#### **Neni 15**

##### **Lista e llojeve të mbeturinave**

(1) Mbeturina në pajtim me burimin e krijimit, vetive të saj, gjegjësisht karakteristikat klasifikohen në lloje në Listën e llojeve të mbeturinave dhe e njëjta paraqet përmbledhje të llojeve të mbeturinave e klasifikuar në kategori, ku secili lloj etiketohet me shenjë të veçantë.

(2) Mbeturinat në listën e llojeve të mbeturinave (në tekstin e mëtutjeshëm: Lista e mbeturinave) klasifikohen sipas kategorive në vijim:

01 Mbeturinat që ndodhi si rezultat të hulumtimit, minierës, shfrytëzimi i gurit, trajtimi fizik dhe kimik i mineraleve;

02 Mbeturinat e bujqësisë, hortikulturës, akuakulturës, pylltarisë, gjuetisë dhe peshkimit, përgatitja dhe prodhimi i ushqimit;

03 Mbeturinat nga prodhimet e drurit dhe prodhimet e paneleve, puplave, letrës dhe kartonit;

04 Mbeturinat industriale e lëkurës, leshit dhe tekstilit ;

05 Mbeturinat nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror dhe qymyri pirolitik të trajtuar;

06 Mbeturinat nga proceset kimike joorganike;

07 Mbeturinat nga proceset kimike organike ;



- 08 Mbeturinat nga prodhimtaria, formulimi, furnizimi dhe përdorimi yndyrës për lubrifikim, (ngjyra, llake dhe qelqe) ngjitëse dhe boja për printim
- 09 Mbeturina nga industria e fotografisë ;
- 10 Mbeturina nga proceset termike ;
- 11 Mbeturina nga trajtimi sipërfaqësore kimik dhe mbështjellësve metalik dhe materialet tjera si nga përpunimi hidrometalurgjisë të metaleve të ngjyrosura ;
- 12 Mbeturina nga formësimi dhe trajtimi mekanik dhe fizik të metalit dhe plastikës;
- 13 Mbeturinat e vajit dhe mbeturinat e karburanteve të lëngshme (përveç vajet që përdoren për ushqim 05 dhe 12) ;
- 14 Mbeturina të tretësve organik, mjeteve për ftohje dhe karburanti (përveç 07 dhe 08) ;
- 15 Mbeturinat e paketimit, thithësit, pecetat, materialet filtruese dhe veshjet mbrojtëse që nuk specifikohen ndryshe;
- 16 Mbeturinat që nuk janë të specifikuar ndryshe në listë;
- 17 Mbeturinat nga rrënimet dhe nga ndërtimtaria (duke përfshirë edhe tokën e grupuar nga lokacionet e kontaminuara);
- 18 Mbeturinat nga mbrojtja shëndetësore e njerëzve ose kafshëve ose hulumtimet të përafërta (përveç mbeturinat nga kuzhina dhe restorant i cili nuk del drejtpërdrejtë nga mbrojtja shëndetësore);
- 19 Mbeturinat nga kapacitetet për menaxhimin e mbeturinave, stacionet pastruese të ujërave të zeza jashtë lokacionit dhe përgatitja e ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut dhe ujit për përdorim industrial;
- 20 Mbeturinat komunale (mbeturinat e amvisërive dhe mbeturinat e ngjashme komerciale, veprimtaritë industriale dhe administrative) duke i përfshirë edhe rrjedhat e mbledhura të veçanta;
- (3) Në listën e mbeturinave janë të klasifikuara në mënyrë të veçantë në pajtim me dispozitat e këtij ligji mbeturina e cila sipas vetive të saj gjegjësisht karakteristikat bën pjesë në grupin e mbeturinave të rrezikshme pa marrë parasysh origjinën e saj, megjithatë nëse është e domosdoshme klasifikimi i tij atëherë merren parasysh edhe vlerat kufitare të substancave dhe materieve të përqendruar në mbeturinë të cilat kanë veti të rrezikshme.
- (4) Nëse mbeturina e cila në pajtim me listën e mbeturinave nuk është e definuar si e rrezikshme, i njëjti do të llogaritet si i rrezikshëm nëse me testimin e tij do të përcaktohet se ka një ose më shumë veti të rrezikshme.
- (5) Ndalohet hollimi ose përzjerja e mbeturinave të rrezikshme me mbeturina të tjera në mënyrë që të zvogëlohet përqendrimi fillestar i substancave ose materieve të rrezikshme në një nivel nën vlerat kufitare për përcaktimin e mbeturinave të rrezikshme për shkak të klasifikimit të tij si mbeturinë e parrezikshme.
- (6) Klasifikimi i mbeturinës mbi bazë të vetive të saj në pajtim me listën e mbeturinave e kryen krijuesi gjegjësisht poseduesi i mbeturinës.
- (7) Krijuesi gjegjësisht poseduesi i mbeturinave i cili në bazë të dhënave të disponueshëm nuk mund të bëjë klasifikimin e mbeturinës, në pajtim me këtë nen është i obliguar të angazhon person juridik të akredituar në pajtim me nenin 17 të këtij ligji, i cili në emër dhe llogarit të tij do të kryej klasifikim të mbeturinës.
- (8) Personi juridik i akredituar sipas nenit 17 kryen testimin dhe vlerësimin të karakteristikave gjegjësisht vetive të mbeturinave dhe kryen klasifikimin në pajtim me Listën sipas paragrafit (1) të këtij neni.
- (9) Në listën e mbeturinave përcaktohen kategoritë e mbeturinave, mënyra e etiketimit të mbeturinave me shifër dhe mënyra e përcaktimit në kategori të veçantë të cilën e përshkruan ministri i cili udhëheq me organin e mjedisit jetësor (në tekstin e mëtutjeshëm: ministri).

## **Neni 16**

### **Vlerësim të karakteristikave të mbeturinave**

(1) Vlerësimi i karakteristikave të mbeturinave të nenit 15, paragrafi (7) të këtij neni e kryen person juridik i akredituar për vlerësim të karakteristikave të mbeturinave, për metodën e cilës është akredituar në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(2) Marrja e mostrave të mbeturinave, si dhe testimi i karakteristikave të saj kryhet në pajtim me standardet relevante nacionale dhe ndërkombëtare dhe praktikat evropiane nga fusha e menaxhimit të mbeturinave.

(3) Vlerësim të karakteristikave të mbeturinave kryhet për të gjitha llojet e mbeturinave, me përjashtim të mbeturinave komunale.

(4) Nëse ekziston dyshim se ndonjë mbeturinë e caktuar përmban karakteristika të rrezikshme ose karakteristikat e tij nuk përputhen me të dhënat e formularit identifikues të nenit 50, paragrafi (4) të këtij ligji, poseduesi është i detyruar menjëherë të njoftojë organi profesional.

(5) Organi profesional pas marrjes së njoftimit sipas paragrafit (4) të këtij neni është i detyruar të kryhen kontroll të karakteristikave të mbeturinave në llogari të poseduesit nga ana e personit juridik të akredituar në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(6) Personi juridik i akredituar sipas paragrafit (2) të këtij neni, përgatit raport për karakteristikat e testuara, gjegjësisht vetit e mbeturinave, dhe një mostër e dorëzon deri tek organi profesional.

### **Neni 17**

#### **Kushtet e marrjes së akreditimit për vlerësimin e karakteristikave të mbeturinave**

(1) Vlerësim gjegjësisht kontroll të karakteristikave të mbeturinave kryhet nga personi juridik i akredituar i cili posedon akreditim për kryerjen e vlerësimit të vetive gjegjësisht të karakteristikave të mbeturinave në pajtim me rregullativat e standardizimit.

(2) Standardet për akreditim për kryerjen e vlerësimit të karakteristikave të mbeturinave të cila duhet ti plotësojë personi juridik i akredituar i përcakton ministri dhe ato i shpall në ueb faqen e organit të mjedisit jetësor.

### **Neni 18**

#### **Lënda e parë sekondare**

(1) Substancat, materiet ose produkti i cili është rezultat i procesit prodhues, ndërsa qëllimi i tij primar nuk është prodhimi i kësaj substance, materie ose produktit, nuk do të llogaritet si mbeturinë në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), pika 1 të këtij ligji, gjegjësisht të njëjta do të llogaritet si lëndë e parë sekondare nëse i plotëson kushtet në vijim:

- përdorim të mëtjeshëm të substancave, materieve ose produkteve të jetë e sigurt nga asketi i mjedisit jetësor, gjegjësisht ekzistojnë kufijtë se substanca, materia ose produkti nuk do të largohet si mbeturinë dhe ato nuk do të ruhen në kohë të pacaktuar;
- substanca, materiet ose produkti mund të përdoren drejtpërdrejt, pa përpunim të mëtjeshëm, në proceset e zakonshme industriale;
- substanca, materia ose produkti është një pjesë integrale e procesit të prodhimit dhe
- lejohet përdorimi i mëtjeshëm i substancës, materies ose produktit, pra substanca, materia ose produkti i plotëson kërkesat dhe standardet e nevojshme të përshkruara për përdorimin e tyre në drejtim të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut, si dhe që përdorimi i tyre nuk do të çojë në ndikime negative në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut.

(2) Në mënyrë që një substancë, materie ose produkt të konsiderohet si një lëndë e parë sekondare, krijuesi i mbeturinave është i detyruar deri tek organi profesional të dorëzojë kërkesë për regjistrim të substancës, materies ose produktit si proces i prodhimit në të cilën është krijuar lënda e parë sekondare në Regjistrin e mbeturinave të nenit 100 të këtij ligji (në tekstin e mëtutjeshëm: Regjistri) i cili i përmban të dhënat e mëposhtme:

- emri i lëndës së parë sekondare;
- për mënyrën e ndodhjes, pra përshkrimin e procesit të prodhimit nga i cili është krijuar lënda e parë sekondare, dhe
- për substancën, materien ose produktin për të cilin kërkohet regjistrimi në regjistër se i plotëson kushtet / specifikimet si produkte të tjera të ngjashme të produktit të tregut.

(3) Në kërkesën sipas paragrafit (2) të këtij neni, krijuesi i mbeturinave dorëzon edhe:  
- prova e mënyrës së ndodhjes, pra përshkrimi i procesit të prodhimit nga i cili krijohet lëndë e parë sekondare;

- specifikimi teknik i substancës, materies ose produktit që do të përdoret si lëndë e parë sekondare, dhe

- dokumente të tjera që janë ose mund të kërkohen për të provuar qëllimin ose karakteristikat e substancës, materies ose produktit që të futet në regjistër.

(4) Organi profesional është i detyruar që brenda pesë ditëve nga dita e plotësimit të kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni me dokumentacionin e nevojshëm sipas paragrafit (3) të këtij neni ta dorëzojë atë në trupin punues për mbeturina sipas nenit 20 të këtij ligji me qëllim të marrjes së një mendimi.

(5) Organi profesional, bazuar në mendimin sipas nenit 20 paragrafi (3) të këtij ligji është i detyruar që brenda 60 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të miraton aktvendim për lëndë të parë sekondare ose të refuzojë kërkesën sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(6) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (5) të këtij neni, krijuesi i mbeturinës sipas paragrafit (2) të këtij neni mund të dorëzojë ankesë në pajtim me rregullativat për procedurë të përgjithshme administrative.

(7) Aktvendimi për lëndën e parë sekondare sipas paragrafit (5) të këtij neni në veçanti përmban:

- emri i lëndës së parë dytësore;

- tarifa për shpërndarje të mallrave në pajtim me Tarifat doganore;

- procesi i prodhimit nga buron substanca, materia ose produkti;

- kushtet që duhet të plotësojë substanca, materia ose produkti që ajo të trajtohet si një lëndë e parë sekondare, me sqarimin se nëse substanca, materia ose produkti nuk përdoret për përdorimin e saj të synuar ose nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në aktvendimin për lëndë të parë sekondare sipas paragrafit (5) të këtij neni, do të konsiderohet mbeturinë në përputhje me Ligjin e Menaxhimit të Mbeturinave;

- momenti në procesin e prodhimit kur substanca, materia ose produkti i krijuar pushon të jetë mbeturinë, pra kur e njëjta konsiderohet si lëndë e parë sekondare në përputhje me qëllimin e përcaktuar në aktvendimin sipas paragrafit (5) të këtij neni dhe

- përcaktimin e mënyrës së njoftimit deri tek organi profesional për llojin, mënyrën e krijimit dhe qëllimin për përdorimin e substancës, materies ose lëndës si lëndë e parë sekondare.

(8) Nëse në procesin e prodhimit identifikohen lloje të reja të lëndës së parë sekondare, të ndryshme nga ato të cekura në aktvendimin për lëndën e parë sekondare sipas paragrafit (5) të këtij neni, fillohet procedurë e re për përcaktimin e lëndës së parë sekondare.

(9) Lëndë e parë sekondare e përcaktuar me Aktvendimin për lëndën e parë sekondare sipas paragrafit (5) të këtij neni, regjistrohet detyrimisht në regjistrin që e udhëheq organi profesional.

(10) Përveç lëndës së parë sekondare, Regjistri gjithashtu shënohen edhe proceset e prodhimit nga të cilat e njëjta është krijuar.

(11) Krijuesit e lëndëve të para sekondare sipas regjistrit janë të detyruar të mbajnë evidencë dhe për këtë të njoftojnë në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

(12) Organi profesional për çdo lëndë të parë sekondare e cila është e regjistruar në Regjistrin e njofton organin e doganës, ndërsa organi doganor nuk do të lejon eksport të lëndës së parë sekondare nëse e njëjta nuk është regjistruar në Regjistër.

(13) Parashtruesi i kërkesës së paragrafit (2) të këtij neni gjatë parashtrimit të kërkesës është i obliguar të paguan kompensim në shumë prej 15.000 denarë në llogari të veçantë të organit të mjedisit jetësor.

## **Neni 19**

### **Heqja e statusit të mbeturinave**

(1) Mbeturina të llojeve të veçanta (letrat, qelqi, goma, tekstili, materialet kompozite, metali dhe të tjera) do të ndërprerjen të jenë mbeturina në pajtim me nenin 6, paragrafin (1) pika 1

të këtij ligji, nëse këto me procedurën e përpunimit, përfshinë edhe riciklim, i plotësojnë kushtet:

- substanca, materie ose produkti përdoret për një qëllim specifik;
- ekziston kërkesa e tregut për substancën, materien ose produktin;
- substanca, materie ose produkti i plotëson kërkesat teknike për qëllimin dhe plotëson rregullativat dhe standardet të cilat kanë të bëjnë me produktin; dhe
- përdorimi i substancës, materies ose produktit nuk do të çojë në ndikime negative mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut.

(2) Ministri i përshkruan kërkesat teknike të cilat duhet të plotësohen:

- kërkesat teknike që duhet të plotësohen për ndonjë lloj të mbeturinave të veçanta që të mos jetë mbeturinë, në pajtim me vendosjen e praktikave dhe mënyrës së përshkrimit të tyre në Bashkimin Europian;

- kërkesat teknike për ndonjë lloj të veçantë të mbeturinave të cilat nuk janë përfshirë në alinenë 1 të këtij paragrafi për të cilat janë vendosur praktikat dhe nuk është vendosur mënyra e përshkrimit të tyre në Bashkimin Europian;

- vlerat kufitare të substancave ndotëse dhe materiet e pranishme në ndonjë lloj të mbeturinave të alinesë 1 dhe 2 të këtij paragrafi, duke pasur parasysh edhe mundësitë të ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njeriut dhe

- forma dhe përmbajtja e kërkesës për heqje të statusit të mbeturinave të ndonjë llojit të veçantë, dokumentet e nevojshme dhe mënyra e kontrollit të plotësimit të kërkesës paragrafit 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

(3) Menaxhuesi i mbeturinave tek organi profesional dorëzon kërkesë për heqjen e statusit të mbeturinës.

(4) Organi profesional është i obliguar në afat prej 5 ditë nga dita e kompletimit të kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni ta dorëzojë deri te trupi punues për mbeturina të nenit 20 të këtij ligji për shkak të marrjes së mendimit për të.

(5) Organi profesional në bazë të mendimit të paragrafit (4) të këtij ligji dhe nëse janë plotësuar kushtet për heqje të statusit të mbeturinave në pajtim me këtë nen, është e detyruar në afat prej 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës të miratohet aktvendim për heqje të statusit të mbeturinave për ndonjë lloj të mbeturinave ose ta refuzojë kërkesën.

(6) Menaxhuesi i mbeturinave kundër këtij aktvendimit sipas paragrafit (5) të këtij neni me të cilën refuzohet kërkesa për heqje të statusit të mbeturinës mund të parashtrojë ankesë në pajtim me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

(7) Nëse për një lloj të caktuar të mbeturinave nuk përshkruhen kushtet që duhet të plotësohen për të hequr statusin e tyre të mbeturinave, organi profesional vendos nga rasti në rast nëse statusi i mbeturinave të një lloji të caktuar të mbeturinave do të hiqet duke marrë parasysh kushtet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, si dhe duke marrë parasysh praktikën dhe përvojën që ekziston në Bashkimin Europian.

(8) Parashtruesi i kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni, gjatë dorëzimit të kërkesës, është i detyruar të paguajë kompensim në shumë prej 15.000 denarë në llogarit të veçantë të organit të mjedisit jetësor.

(9) Menaxhuesi i mbeturinave për të cilin është hequr statusi i mbeturinave është i detyruar të mbajë evidencë dhe të njoftojë në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

(10) Sasitë e mbeturinave që kanë pushuar të mbeten mbeturina në pajtim me këtë nen mund të konsiderohen se janë të gatshme për përdorim, riciklim dhe përpunim të përsëritshëm për shkak të përfshirjes në sasitë totale të përdorimit, riciklimit ose përpunimit të përsëritshëm të mbeturinave në pajtim me objektivat e riciklimit, gjegjësisht përpunimit të mbeturinave

## **Neni 20**

### **Trupi punues për mbeturina**

(1) Për përcaktimin e statusit të lëndës së parë sekondare të nenit 18 të këtij ligji dhe për prezantimin e statusit të llojeve të veçanta të mbeturinave në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, ministri formon trup punues të veçantë për mbeturina të përbërë nga përfaqësuesit e

administratës shtetërore, institucionet shkencore dhe arsimore, organizatat, ekspertë e fushës së menaxhimit të mbeturinave dhe përfaqësues të sektorit të biznesit

(2) Trupi punues i mbeturinave mund të ketë së paku 5, ndërsa më shumë 7 anëtarë me arsim të altë të mbaruar nga fusha e shkencave natyrore dhe teknike të cilat kanë përvojë së paku dhjetë vjet në menaxhimin e mbeturinave.

(3) Trupi punues është i obliguar në afat prej 30 ditësh nga marrja e kërkesës sipas nenit 18, paragrafi (2) të këtij neni dhe neni 19, paragrafi (3) të këtij neni të dorëzon mendim tek organi profesional se vallë substanca, materia ose produkti mund të regjistrohet në regjistër sipas nenit 100 të këtij ligji, gjegjësisht a janë plotësuar kushtet për ndërprerje të statusi të mbeturinës të ndonjë lloji të veçantë të mbeturinës.

(4) Punët administrative të trupit punues i kryen organi profesional

(5) Për punën e trupit punues, anëtarëve të trupit punues sipas paragrafit (1) të këtij neni ju takon kompensim lartësia e të cilës përcaktohet në varësi të numrit të kërkesave të dorëzuar në pajtim me nenin 18 dhe 19 të këtij ligji.

(6) Përbërja, mënyra e punës së trupit punues dhe lartësia e kompensimit përcaktohet nga ministri.

(7) Trupi punues financohet nga kompensimi i përcaktuar në nenin 18, paragrafin (13) dhe nenin 19, paragrafin (8) të këtij ligji.

### **III. STRATEGJIA, PLANI DHE PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE**

#### **Neni 21**

##### **Planifikim gjatë menaxhimit të mbeturinave**

(1) Organet kompetente të administratës shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bordet ndërkomunale për menaxhimin e mbeturinave, komunat dhe Qyteti i Shkupit, si dhe personat fizik dhe juridik të cilët menaxhojnë me mbeturina në pajtim me këtë ligj, janë të obliguar të miratojnë dhe të zbatojnë dokumente strategjike, të planit dhe programe për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të sigurohet:

- mbrojtje të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut;
- analizë të gjendjes në fushën e mbeturinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- definimi i masave për përmirësim të mjedisit jetësor me qëllim të zvogëlim të krijimit të mbeturinave;
- definimi i masave për përpunim, përdorim, riciklim dhe largim të përsëritshëm të mbeturinave;
  - zbatimi i parimeve themelore të hierarkisë të menaxhimit të mbeturinave, udhëzime për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullativat tjera të menaxhimit të mbeturinave;
  - themeli i sistemit rajonal të menaxhimit të mbeturinave me infrastrukturën e nevojshme për mbledhje, seleksionim, ruajtje, përpunim dhe largim të mbeturinave;
  - arritja e objektivave të menaxhimit të mbeturinave, të përcaktuara në këtë ligj ose rregullativat tjera të menaxhimit të mbeturinave;
  - lëvizje e papenguar e mbeturinave për shkak të përpunimit, riciklimit dhe trajtimit të tij
- ;
- vendosja e vetëqëndrueshmërisë financiare univarsiale dhe sistem të disponueshëm për sigurim të shërbimeve për mbledhje të mbeturinave i cili është me cilësi i cili i plotëson kushte minimale për menaxhimin e mbeturinave;
- realizimi i detyrimeve të ndërlidhura me menaxhimin e mbeturinave, të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut i ka marrë në nivel ndërkombëtar dhe

- monitorimi i zbatimit të dokumenteve strategjike, të planit dhe programit dhe kontributi i tyre në plotësimin e objektivave dhe kërkesave të veçanta të përcaktuar në rregullativat për menaxhim të mbeturinave

(2) Në procedurën për miratim të dokumenteve strategjike, të planit dhe programit në pajtim me dispozitat e këtij neni kryhet vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor, në pajtim me rregullativat e mjedisit jetësor

## **Neni 22**

### **Strategjia e menaxhimit të mbeturinave**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në propozim të ministrit miraton strategji për menaxhimin e mbeturinave.

(2) Në strategjinë e menaxhimit të mbeturinave të paragrafit (1) të këtij neni përcaktohen:

- a) politika e përgjithshme e menaxhimit të mbeturinave në nivel nacional;
  - b) përshkrim dhe vlerësim të gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave;
  - c) qëllimet nacionale afatgjata dhe afatshkurta të cilat duhet të arrihen në procesin e menaxhimit të mbeturinave;
  - ç) indikatorët e suksesshmërisë së politikës së menaxhimit të mbeturinave;
  - d) udhëzime me menaxhimin e mbeturinave të rrjedhjeve të veçanta
  - dh) masat e realizimit të politikës së menaxhimit të mbeturinave;
  - e) kriteret mbi bazë të së cilës përcaktohet kapaciteti, gjegjësisht lokacioni për përpunim dhe largim të mbeturinave;
  - ë) vlerësimi i përdorimit përkatës të instrumenteve ekonomike dhe të tjera në menaxhimin me probleme të ndryshme të mbeturinave, për shkak të zbatimit të hierarkisë së mbeturinave dhe arritja e objektivave të menaxhimit të mbeturinave;
  - f) identifikimi i aktiviteteve dhe masave të cila kontribuojnë drejt parandalimit të krijimit të mbeturinave dhe për shkak të uljes së tyre, identifikimi i indikatorëve përkatës kuantitativ dhe cilësor të suksesit të masave për parandalim të mbeturinave, me definim të qartë të kornizës kohore për arritjen e tyre;
  - h) aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe sigurimit të informacione të drejtuara drejt publikut të gjerë ose grupe të konsumatorëve dhe çështje tjera në rëndësi për zhvillim të menaxhimit të mbeturinave.
- (3) Strategjia e menaxhimit të mbeturinave ka të bëjë për periudhë 12 vite, ndërsa e njëjta revidohet së paku në vitin e gjashtë të miratimi të saj.

## **Neni 23**

### **Plani për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

(1) Për realizimin e strategjisë për menaxhimin e mbeturinave të nenit 22 të këtij ligji, organi i mjedisit jetësor, miraton planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: Plani).

(2) Plani sipas paragrafit (1) të këtij neni miratohet për periudhë gjashtëvjeçare dhe në veçanti përmban:

1. përshkrim të gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
2. objektivat nacionale të cilat duhet të arrihen në raport me përgatitje për përdorim, riciklim, përpunim dhe largim të përsëritshëm të mbeturinave dhe afateve kohore për zbatimin e tyre;
3. qasja e menaxhimit të mbeturinave;
4. korniza juridike dhe institucionale e menaxhimit të mbeturinave;
5. detyrimet e organeve të administratës shtetërore dhe njësisive të vetëqeverisje lokale, duke përfshirë dhe shpërndarje të përgjegjësisive në mes pjesëmarrësve publik dhe privat të cilët kryejnë menaxhimin e mbeturinave;

6. planifikim rajonal për menaxhim të mbeturinave dhe dhënia e shërbimit ;
  7. mirëmbajtja e bazës të të dhënave për menaxhimin e mbeturinave;
  8. masat dhe aktivitetet për implementim të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave;
  9. masat dhe aktivitetet për implementim të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesve;
  10. masat për rregullim të eksportit, importit dhe transitit të mbeturinave;
  11. masat për rehabilitimin e deponive jostandarde dhe të paligjshme dhe rajonet e kontaminuara;
  12. mënyra e menaxhimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave (mbeturinash komunale, komerciale, industriale, ndërtime, të rrezikshme, mjekësore, mbeturina të rrjedhjeve të veçanta, si dhe menaxhimi i llumës nga stacionet e pastrimit të ujërave të zeza);
  13. masat dhe aktivitetet për themelimin e deponive;
  14. plani aksional për menaxhimin e mbeturinave;
  15. indikatorët për monitorimin e planit dhe
  16. përmbajtjen e programeve për menaxhimin e mbeturinave rrjedhëse të veçanta edhe atë: mbeturinat e paketimit, mbeturinat elektrike dhe pajisjet elektronike, mbeturinat e baterive dhe akumulatorët dhe mbeturinat tjera rrjedhëse të veçanta.
- (3) Organi kompetent për zbatimin e planit është organi profesional.
  - (4) Monitorimi i zbatimit të planit bëhet nga organi i mjedisit jetësor.
  - (5) Organi profesional mund të propozojë ndryshim të plani çdo tre vjet nga miratimi i tij, dhe organi mjedisor jetësor do kryejë revizion të planit.
  - (6) Organi profesional përgatit raport për zbatim të planit në çdo tre vjet nga dita e miratimit.
  - (7) Organi i mjedisit jetësor raportin sipas paragrafit (6) të këtij neni do t'ia dorëzojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Neni 24**

### **Planet rajonale për menaxhimin e mbeturinave**

- (1) Këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, në propozim të bordit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 32 të këtij ligji, miraton plan rajonal për menaxhimin e mbeturinave (në tekstin e mëtutjeshëm: Plani rajonal), me të cilën rregullohet dhe bëhet përputhja e objektivave të përbashkëta të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal.
- (2) Plani rajonal në veçanti përmban:
  - teknologjitë dhe metodat e planifikuara për menaxhimin e mbeturinave;
  - përshkrim të sistemit ekzistues për menaxhimin e mbeturinave dhe instalime kryesore për largim dhe përpunim duke përfshirë edhe instalimet për vendosje me mbeturina të rrjedhave të veçanta;
  - vlerësim të nevojave për sistem të ri të mbledhjes, mbylljes të instalimeve ekzistuese për mbeturina, infrastrukturë plotësuese të instalimeve për mbeturinë në pajtim me nenin 45 të këtij ligji dhe sipas nevojës edhe investimet të ndërlidhura me të;
  - masat për edukim dhe ngritje të vetëdijes publike për menaxhimin e mbeturinave;
  - objektivat që duhet të arrihen në procesin e menaxhimit të mbeturinave në raport të përgatitjes për përdorim, riciklim, përpunim dhe largim të përsëritshëm të mbeturinave dhe afatet kohore për zbatimin e tyre;
  - masat për mbledhje, seleksionim, riciklim, përpunim dhe largim të mbeturinave;
  - vlerësim të mjeteve financiare të nevojshme për realizim të planit rajonal, si dhe instrumentet ekonomike për vendosjen e menaxhimit rajonal me mbeturina;
  - indikatorët e monitorimit të suksesshëm të realizimit të planit rajonal, dhe
  - vlerësim të numrit të lagjeve të izoluara dhe mënyra e përfshirjes së tyre në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- (3) Plani rajonal miratohet për periudhë gjashtëvjeçare.
- (4) Bordi ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave të nenit 32 të këtij ligji mund sipas nevojës në çdo tre vjet të propozon ndryshim dhe plotësim të planit rajonal.
- (5) Plani rajonal, para se të miratohet nga këshillat e komunave, përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit, dorëzohet për aprovim deri tek organi i mjedisit jetësor.

(6) Bordi ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 32 të këtij ligji, në çdo tre vjetë nga fillimi i planit rajonal do të dorëzojë raport për realizimin e planit rajonal deri te Këshilli i Komunës, gjegjësisht te Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe deri te organi profesional.

(7) Përbajtja më e përafërt e planit rajonal përcaktohet nga ministri.

## **Neni 25**

### **Plani për parandalimin e krijimit të mbeturinave**

(1) Organi i mjedisit jetësor miraton plan për parandalimin të krijimit të mbeturinave në të cilën janë përshkruar masat për parandalim të krijimit të mbeturinave, si dhe mënyrat me të cilat vlerësohet implementimi i tyre, duke përfshirë shembuj me të cilat parandalohet krijimi i mbeturinave, si dhe masat tjera përkatëse.

(2) Në planin për parandalim të krijimit të mbeturinave janë të përcaktuara objektivat nacionale kuantative dhe kualifikuese për parandalimin e krijimit të mbeturinave, si dhe indikatorët e caktuar, në bazë të së cilës do të monitorohet dhe vlerësohet përparimi në zbatimin e masave për parandalim të krijimit të mbeturinave .

(3) Objektivat nacionale për parandalim të krijimit të mbeturinave duhet të përcaktohet në mënyrë me të cilat zhvillimi ekonomik dhe ndikimi mbi mjedisin jetësor janë ndërmjet vetit të varura me sasinë e mbeturinave të krijuara, me çka zhvillimi më i madh ekonomik do të qojë deri në parandalim më të madh të krijimit të mbeturinave.

(4) Plani sipas paragrafit (1) të këtij neni miratohet për periudhë gjashtëvjeçare.

(5) Organi i mjedisit jetësor e përcjellë realizimin e planit sipas paragrafit (1) të këtij neni, ndërsa organi profesional e zbaton.

(6) Organi profesional mund të propozon ndryshime të planit në çdo tre vjet nga miratimi i tij, ndërsa organi i mjedisit jetësor bën revizion të planit.

## **Neni 26**

### **Strategjia nacionale për menaxhimi me llum**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në propozim të ministrit miraton strategji nacionale afatgjate për menaxhim me llum.

(2) Strategjia sipas paragrafit (1) të këtij neni miratohet për periudhë jo më të shkurtë se dhjetëvjeçare.

(3) Strategjia sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti i përmban:

- përshkrim dhe vlerësim të gjendjes ekzistuese të menaxhimit me llum;
- kornizë juridike dhe institucionale të menaxhimit me llum;
- prodhim aktual dhe të ardhshëm të llumit;
- objektivat nacionale afatgjate dhe afatshkurte në menaxhimin me llum;
- vlerësim të opsioneve për ripërdorim, trajtim dhe largim të llumit dhe potenciali strategjik i tyre;
- projektimi i prodhimit në trajtimin e llumës nga stacionet pastruese;
- udhëzime dhe kodeks të praktikave të mirat të përdorimit të llumës në bujqësi dhe për qëllime tjera dhe
- çështje tjera me rëndësi për menaxhimin me llum në nivel nacional.

(4) Strategjia nacionale për menaxhim me llum do të revidohet së paku në vitin e pesë të realizimit të saj.

## **Neni 27**

### **Programe për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Personat të cilët kryerjen e veprimtarisë së tyre gjatë vitit kalendarik krijojnë më shumë se 200 kilogram të mbeturinave të rrezikshme me më shumë se 100 ton të mbeturinave të parrezikshme, miratojnë program për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me strategjinë për menaxhimin e mbeturinave, planin, planin për parandalim të krijimit të mbeturinave dhe planet rajonale për menaxhimin e mbeturinave

(2) Programi sipas paragrafit (1) të këtij neni miratohet për periudhë trevjeçare.



- (3) Programi sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti i përmban;
- 1) nivelin ekzistues i krijimit të mbeturinave, sipas llojit, sasisë dhe burimit të krijimit dhe parashikimi i llojit dhe sasisë së mbeturinave që do të krijohet në tri vitet e ardhshme;
  - 2) masat ekzistuese dhe planifikuese tekniko-organizative dhe masat e tjera për shmangien dhe për zvogëlimin e krijimit dhe uljen e dëmshmërisë së mbeturinave;
  - 3) të dhënat për kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara tekniko-organizative të personave juridikë;
  - 4) masat ekzistuese dhe të planifikuara teknike, organizativ dhe masat e tjera (duke i përfshirë ndërhyrje investituese) për menaxhimin e mbeturinave (seleksionimi, trajtimi, përpunim, shfrytëzimi i energjisë, ruajtja dhe largimi) ;
  - 5) kornizën kohore për zbatim të standardeve të cilat kanë të bëjnë me përbërjen dhe përpunimin e produkteve të veçanta dhe paketimi i tyre përkatës për përdorim ose përpunim të përsëritshëm duke përfshirë edhe riciklimin;
  - 6) masat për mbrojtje të ndikimit të dëmshëm të mbeturinave në mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut;
  - 7) futjen e sistemit ndërkombëtar për mbrojtje të mjedisit jetësor (ISO 14000 dhe të tjera);
  - 8) aktivitetet e planifikuara për edukim dhe trajnim të kuadrit të menaxhon me mbeturina dhe
  - 9) masat tjera me rëndësi për realizimin e programit për menaxhimin e mbeturinave.
- (4) Organi profesional mund të kërkon nga personat juridik të paragrafit (1) të këtij neni të bëjë ndryshim dhe plotësim të programit të tyre, kur do të vërtetoj se ata janë në kundërshtim me strategjinë, planin, planin për zvogëlim të krijimit të mbeturinave dhe planit rajonal.

## **Neni 28**

### **Obligimet e komunave dhe Qytetit të Shkupit për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe mbeturina tjera të parrezikshme**

- (1) Kryetarët e Komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, në pajtim me planin dhe planin rajonal është i obliguar të:
- 1) kujdeset për mbeturinat që krijohen nga amvisëritë, si dhe mbeturinave tjera të cilat krijohen në sektorin komercial dhe industrial për shkak të karakteristikave, përbërjes dhe sasisë së tyre të njëjtë me mbeturinat e amvisërisë (mbeturinat komunale) dhe nga kryerja e veprimtarive dhe aktivitetëve në rajonin e komunës;
  - 2) siguron kushte për seleksionimi dhe menaxhimin me rrjedha të veçanta të mbeturinave të cilat janë pjesë e sistemit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit ;
  - 3) kujdeset për pastërtinë publike dhe për mbledhje dhe pastrim të mbeturinave të lëna;
  - 4) propozon dhe miraton akte me të cilat rregullohet, parandalohet, zvogëlohet, selektohet, mbledhja dhe transportimi i mbeturinave komunale, si dhe masat e ndërmarra për realizim të akteve të miratuara;
  - 5) detyrimisht bashkëpunon me kryetarët e komunave tjera/ose me Qytetin e Shkupit për vendosjen dhe funksionimin e sistemit rajonal për menaxhimin e mbeturinave, ndërsa në lidhje me menaxhimin e mbeturinave komunale dhe komerciale;
  - 6) realizimi i projekteve dhe masat e ndërmarra për përmirësim të gjendjes me menaxhimin e mbeturinave;
  - 7) vepron në pajtim me rregullat e përgjithshme për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe llojeve tjera të mbeturinave për të cilat me ligj janë detyrë e komunës gjegjësisht të Qytetit të Shkupit për menaxhim dhe
  - 8) bashkëpunon me menaxhuesit e rrjedhave të veçanta të mbeturinave në kornizë të sistemit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhim me rrjedha të veçanta të mbeturinave në pajtim me rregullativat për përgjegjësisë të zgjeruar të prodhuesit.
- (2) Ndaj mbeturinave komerciale veprohet në të njëjtën mënyrë ashtu siç veprohet ndaj mbeturinave komunale, vetëm nëse kjo nuk është krijuar nga personi fizik të cilët krijojnë mbeturina të rrezikshme më shumë se 200 kilogramë, gjegjësisht mbeturina të parrezikshme më shumë se 100 ton në vit.

## **Neni 29**

### **Njoftim për realizim të programeve për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Personat sipas nenit 27 të këtij ligji janë të obliguar të dorëzojnë raport vjetor për realizim të programeve të tyre deri tek organi profesional, më së voni deri 31 janar të vitit aktual, për vitin e paraprak.

(2) Në bazë të rezultateve të marra nga raportet e zbatimit të programit për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 27 të këtij ligji, organi i mjedisit jetësor mund të bëjë ndryshim dhe plotësim të dokumenteve të planit të cilat i miraton organi i mjedisit jetësor.

## **Neni 30**

### **Zbatimi i dokumenteve strategjike dhe të planit për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet publike, ndërmarrjet dhe organizatat janë të obliguar t'i monitorojnë dhe në mënyrë përkatëse të kujdesen për zbatim të masave dhe objektivave të vendosura në dokumentet strategjike, të planit dhe programet të këtij ligji për menaxhimin e mbeturinave.

(2) Personat juridikë dhe fizikë të cilët krijojnë ose menaxhojnë mbeturinat janë të obliguar masat dhe aktivitetet që i ndërmarrin të jenë në pajtim me objektivat dhe masat e dokumenteve strategjike, të planit dhe programeve të këtij ligji.

## **IV. MENAXHIMI I MBETURINAVE NË NIVEL RAJONAL**

### **Neni 31**

#### **Menaxhimi i mbeturinave në nivel rajonal**

(1) Për nxitje dhe zhvillim të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal në pajtim me planin, këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit nga rajoni përkatës për menaxhimin e mbeturinave miraton vendim për lidhje të marrëveshjes për bashkim për vendosje të sistemit për menaxhimin e mbeturinave në nivel rajonal (në tekstin e mëtutjeshëm; sistem rajonal).

(2) Me marrëveshjen sipas paragrafit (1) të këtij neni veçanërisht rregullohen të drejta dhe detyrimet e ndërsjellta të komunave dhe Qytetit të Shkupit në bashkimin për vendosjen dhe sigurimit të kushteve për funksionim të sistemit rajonal sipas paragrafit (4) të këtij neni, si dhe çështje tjera të interesit të përbashkët për organizim dhe realizim të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal (në tekstin e mëtutjeshëm: menaxhim rajonal).

(3) Marrëveshja sipas paragrafit (1) të këtij neni detyrimisht përmban :

- sasi të minimale të mbeturinave të lëna në stacioni ngarkues në nivel komunal ose objekte qendror për largim të mbeturinave në nivel rajonal dhe

- dispozita tjera të cilat e rregullojnë mundësinë e pjesëmarrjes së sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave në sistemin rajonal në varësi të planit rajonal.

(4) Sistemi rajonal përbëhet nga objektet qendrore për menaxhimin e mbeturinave (deponia rajonale për mbeturina), stacionet dhe objektet dhe instalimet tjera për menaxhimin e mbeturinave.

(5) Në përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, këshilli i komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të vendosin të bashkohen drejt një rajonit tjetër për menaxhimin e mbeturinave i ndryshëm nga rajoni i përcaktuar me plan, nëse ajo nuk e pengon, gjegjësisht e rëndon procedurën e vendosjes ose të organizimit dhe funksionimit të sistemit rajonal në rajonin përkatës për menaxhimin e mbeturinave, si dhe pas marrjes paraprake të pëlqimit nga ministri.

(6) Komunitat dhe Qyteti i Shkupit të cilat janë bashkuar për vendosjen e sistemit rajonal janë të detyruar ta njoftojnë organin e mjedisit jetësor dhe ti dorëzojnë aktet për vendosje të bashkimit, në afat prej 30 ditësh nga dita e bashkimit.

(7) Në raste kur të gjitha komunitat, gjegjësisht Qyteti i Shkupit bëjnë pjesë në një rajon, nuk ka bashkim, gjegjësisht nuk do të lidhin marrëveshjen sipas paragrafit (1) të këtij neni në afat në të cilën është përcaktuar në plan, pra nuk do të vendosin sistem rajonal në afat prej dy vite nga dita e miratimit të marrëveshjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, në propozim të

ministrit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton vendim për vendosjen e sistemit të menaxhimit të mbeturinave për një rajon të caktuar.

(8) Me vendimin sipas paragrafit (7) të këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton rajonin, si dhe komunat dhe/ose Qytetin e Shkupit të cilët detyrimisht do të hyjnë në sistemin rajonal për menaxhim të mbeturinave, mënyra e vendosjes dhe financimit të sistemit për menaxhimin e mbeturinave në nivel rajonal, mënyra e menaxhimit të sistemit dhe periudha e menaxhimit, vendosja organizative, si dhe çështjet tjera të cilat janë me rëndësi për sistemin e menaxhimi të mbeturinave në nivel rajonal.

### **Neni 32**

#### **Bordi ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Për realizim të menaxhimit rajonal, realizim të planit rajonal sipas nenit 24 të këtij ligji dhe realizim të marrëveshjes sipas nenit 31, të këtij neni, për secilin rajon për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuar në lanin formohet bord ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave (në tekstin e mëtutjeshëm; bordi)

(2) Anëtarët e bordit janë kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit të cilët bëjnë pjesë në rajon, ose persona tjetër të autorizuar nga kryetarët e komunave dhe Qytetit të Shkupit.

(3) Me bordin kryeson kryetari i zgjedhur nga rendi i anëtarëve të bordit, për periudhë një vjeçare në parimin e rotacionit .

(4) Bordi mban seancë për mbajtjen e të cilës është e nevojshme prania e më së pakut e gjysmës së anëtarëve të bordit.

(5) Vendimet e bordit miratohen me shumicë një të tretën e anëtarëve të pranishëm në seancë.

### **Neni 33**

#### **Kompetencat e bordit**

Bordi i kryen këto punë:

- 1) e përcakton projektin e planit rajonal për menaxhimin e mbeturinave;
- 2) kryen mbikëqyrje mbi aktivitetet për realizim të planit rajonal ;
- 3) i miraton propozim - projektet për realizim të planit rajonal, si dhe projektet tjera në interes të zhvillimit të sistemit rajonal, vetëm në raste kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar vendim në pajtim me nenin 31, paragrafi(7) të këtij ligji;
- 4) propozon këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit miratimin e vendimeve për çështjet të cilat janë të ndërlidhura me veprimtarinë dhe shërbimet për menaxhimin e mbeturinave të cilat janë në kompetencë të tyre në pajtim me këtë ligj, Ligjin për koncesion dhe partneritet privato-publik, furnizime publike, si dhe çështje tjera të ndërlidhura me zhvillimin e menaxhimit rajonal dhe çështje tjera nga kompetenca e tyre;
- 5) miraton studimin e fizibilitetit me të cilën vendoset dhe organizohet sistemi rajonal për menaxhimin e mbeturinave;
- 6) e miraton kontratën për vendosjes së partneritetit privato-publik, gjegjësisht dhënie në koncesim për menaxhim rajonal me sistemin rajonal kur procedura është udhëheq nga ana e komunave ose Qytetit të Shkupit, vetëm në raste kur Qeveria ka miratuar vendim në pajtim me nenin 31, paragrafi (7) të këtij ligji;
- 7) e miraton projektin e raportit vjetor për realizim të planit rajonal ;
- 8) i koordinon aktivitetet për realizim të projekteve investuese për nxitjen dhe zhvillimin e menaxhimit rajonal me mbeturina komuna dhe llojet tjera të mbeturinave të parrezikshme të financuara nga burimet e përmendura në nenin 104 të këtij ligji;
- 9) bën përzgjedhjen e operatorit të sistemit rajonal dhe ia propozon këshillave të komunave dhe Qytetit të Shkupit për vendimmarrje;
- 10) inicion shqyrtimin e çështjeve të ndërlidhura me sistemin rajonal për të cilat është e domosdoshme koordinim mes komunave dhe Qytetit të Shkupit, agjencive dhe institucioneve shtetërore dhe partnerët nga sektori privat dhe civil dhe
- 11) kryen edhe punë tjera të fushës së menaxhimit të mbeturinave në sistemin rajonal përkatës, të cilat do i delegojë këshilli i komunës, gjegjësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit.

### **Neni 34**

#### **Mënyra e punës së bordit**

(1) Mënyra e punës së bordit rregullohet me rregullore.

(2) Punë profesionale, administrativo-teknike, planifikimi, udhëheqja e projekteve investuese dhe punët me rëndësi për menaxhim rajonal, realizim të planit rajonal dhe zhvillim të sistemit rajonal, monitorimi mbi vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera dhe punë tjera me rëndësi për zhvillimin e menaxhimit rajonal i kryen njësia organizative për menaxhim rajonal me mbeturina e themeluar në Qendrën për zhvillim të planit rajonal sipas nenit 35 të këtij ligji.

### **Neni 35**

#### **Njësia organizative për menaxhim rajonal me mbeturina**

Në kornizë të Qendrës për zhvillim të secilit plan rajonal në të cilën është lidhur marrëveshja në pajtim me nenin 31 të këtij ligji, formohet njësi organizativ për menaxhim rajonal me mbeturina (në tekstin e mëtuftjeshëm: njësia organizative).

### **Neni 36**

#### **Kompetencat e njësisë organizative për menaxhimin e mbeturinave**

Njësia organizative në koordinim me komunat e rajonit përkatës i kryen punët në vijim:

1) përpilon plan rajonal për menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë edhe objektivat vjetore të cilat duhet të arrihen në menaxhimin me mbeturina në nivel rajonal në pajtim me Planin e nenit 23 të këtij ligji;

2) përgatit dhe propozon projekte tjera dhe aktivitete për realizim të planit rajonal, si dhe projekte tjera në interes të zhvillimit të sistemit rajonal;

3) zbaton dhe menaxhon me projektet dhe ndërmerr aktivitet tjera të ndërlidhura me realizimin e planit rajonal dhe zhvillim të sistemit rajonal ;

4) siguron shërbime kontraktuese dhe kapacitet për menaxhimin e mbeturinave në sistemin rajonal;

5) përgatit dhe realizon procedura për përzgjedhjen e sistemit rajonal dhe propozon përzgjedhje të operatorit të sistemit rajonal;

6) zbaton dhe menaxhon me projekte investuese për nxitjen dhe zhvillimin e menaxhimit rajonal me mbeturina komunale dhe mbeturina të llojit tjetër të parrezikshme, të financuara nga burimet e përshkruara në nenin 104 të këtij ligji;

7) e përcjell zbatimin dhe përgatitjen e raportit për realizim të planit rajonal ;

8) përgatit raport për punën e njësisë organizative;

9) përgatit program vjetor për punën e njësisë organizative;

10) udhëheq bazën e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal dhe siguron informacione për palët e interesuar në lidhje me pyetje e ndërlidhura me sistemin rajonal, si dhe aktivitet e tjera të komunikimit me opinionin;

11) përgatit propozimvendime për çështje të cilat janë të ndërlidhura me veprimtarinë dhe shërbimet të menaxhimit të mbeturinave sipas nenit 33, pika (4) të këtij ligji, si dhe çështje të tjera për zhvillim të menaxhimit rajonal;

12) kryen edhe punë tjera të fushës së menaxhimit të mbeturinave në sistemin rajonal përkatëse të cilat do ia besojë bordi, dhe

13) e njofton organi e administratës shtetërore kompetent për punë të fushës së mjedisit jetësor dhe komunave të cilat e themelojnë bordin në nivel vjetor për arritjet e objektivave, me rekomandime për përmirësimin e praktikave më të mira investuese në menaxhimin e mbeturinave.

## **V. RREGULLAT E PËRGITHSHME TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE**

### **Neni 37**

#### **Rregullat për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Menaxhimi i mbeturinave patjetër duhet të realizohet me kujdes dhe mënyrë përgjegjëse me të cilën do të shmanget:

1) rrezikimi i mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut,;

2) ndotja e medimeve të mjedisit jetësor mbi kufizë e shënuara në pajtim me rregullativat;

3) krijimi i zhurmës, aromës së keqe ose rritje të numrit të zogjve, insekteve dhe dëmtuesve;

4) shkatërrimi i kushteve natyrore për jetë të shtazëve dhe të bimëve;

5) shkatërrimi i trashëgimisë mbrojtëse kulturore dhe natyrore,  
dhe

6) mbindërtimi dhe parregullsia e objekteve dhe hapësirave në zonat urbane dhe në rajonet jashtë zonave urbane.

(2) Krijuesi i mbeturinave është i obliguar të kujdeset për mbeturinë e krijuar deri në largimin e saj përfundimtarë, gjegjësisht deri në operacionin e fundit të menaxhimit të mbeturinave, pa marrë parasysh se a menaxhon drejtpërdrejtë me mbeturinat ose menaxhimin ja ka dhënë ndërmjetësuesit, tregtarit me mbeturina ose menaxhimin ja ka besuar personit të tretë i cili menaxhon me një rrjedhje të veçantë të mbeturinave në kornizë të sistemit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesve.

(3) Krijuesi i mbeturinave është obliguar të kujdeset që të sigurojë të dhëna për mbeturinën që e krijon me çka do të mundësohet të vërtetohet se menaxhimi i duhur me mbeturinat e tija do të kryhet në pajtim me ligjin.

(4) Ndalohet djegia e mbeturinave në lokacione të cilat nuk janë të dedikuara për atë qëllim, si dhe përdorimi i aparaturave dhe impianteve për të cilat nuk janë dhënë leje përkatëse në pajtim me ligjin ose në të cilat bëhet djegia e mbeturinave mund të rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(5) Subjektet të cilat kryen veprimtari të menaxhimit të mbeturinave, mbeturinat mund ta blejnë nga personi fizik ose juridik nëse atë e ka fituar në pajtim me ligjin.

(6) Ndalohet lënia dhe hedhja e mbeturinave në lokacionet të cilat nuk janë të përcaktuara për këtë dedikim, si dhe djegia ose largimi i saj në kundërshtim të rregullativave për menaxhimin e mbeturinave.

### **Neni 38**

#### **Menaxhimi i mbeturinave të cilat gjenden në pronësi private**

(1) Menaxhimi i mbeturinave të cilat gjenden në pronë private, i cili mund të shkakton dëm mbi mjedisin jetësor ose shëndetit të njeriut, është detyrë e pronarit ose shfrytëzuesit të pronës.

(2) Nëse pronari ose shfrytëzuesi i pronës në të cilin gjendet mbeturina nuk e largon ose refuzon ta largon mbeturinë në mënyrë të parashikuar me këtë ligj, mbeturinë do e largon ofruesi i shërbimit, gjegjësisht person i autorizuar për mbledhje dhe transportim të mbeturinave, në bazë të aktit juridik për largim të dhënë nga kryetari i komunës, gjegjësisht kryetari i Qytetit të Shkupit ose komunat e Qytetit të Shkupit, në shpenzim të pronarit ose shfrytëzuesit të pronës.

(3) Nëse mbeturina është lënë në pronë private pa lejen e pronarit ose shfrytëzuesit të pronës, pronari ose shfrytëzuesi i pronës e informon kryetarin e Komunës dhe Qytetit të Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit, i cili duhet të ndërmerr masa përkatëse për largim të mbeturinës si dhe masa në pajtim me ligjin kundër shkelësit.

(4) Nëse ekzistojnë njohuri se në pronë që është në pronësi private kryhet ruajtja dhe mbledhja e mbeturinave në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor ka të drejtë të kryen mbikëqyrje të pronës e cila është në pronësi private në pajtim me këtë ligj.

### **Neni 39** **Përpunim i mbeturinave**

(1) Mbeturinat që cilat përmbajnë materie përdoruese duhet të përpunohen, nëse është e mundshme shfrytëzimi i mëtutjeshëm i vetive të saj dhe nëse ekzistojnë kushte teknike dhe teknologjike për atë.

(2) Përpunimi i mbeturinave patjetër të kryhet pa zbatimin e proceseve dhe metodave të cilat e rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(3) Nëse përpunimi i mbeturinave mund të shkaktojë rrezikim të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut ose shpenzimet e përpunimit të mbeturinës janë të mëdha dhe ekonomikisht të papagueshme, mbeturina mund të largohet ose eksportohet nga Republika e Maqedonisë së Veriut në një shtet ku i njëjti mund të përpunohet ose të asgjësohet në mënyrë e cila është e sigurt për mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(4) Obligim për përpunim të detyrueshëm të mbeturinave sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk do të zbatohet, nëse largimi i mbeturinave shkakton rrezik më të vogël të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut se sa përpunimi i saj, ashtu që duhet të ketë parasysh:

- 1) shfrytëzimi i resurseve natyrore;
- 2) energjia e cila do përdoret për përpunimin ose e fituar nga mbeturinat;
- 3) përmbajtja e materieve të rrezikshme në mbeturinat të krijuara pas përpunimit dhe
- 4) emisionet e substancave dhe energjia e medimeve të mjedisit jetësor.

(5) Për shkak të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurës së përpunimit, mbeturina duhet të mblidhet veçmas nëse ajo teknikisht, ekologjik dhe ekonomik është e ndashme dhe të mos përzihet me mbeturina të tjera ose me materiale me veti dhe karakteristika të ndryshme.

### **Neni 40** **Operacione për përpunimin e mbeturinave**

(1) Mbeturinat përpunohen me zbatimin e një ose me shumë të operacioneve në vijim:

- R1- përdorimin e karburantit si dedikim primar ose ndonjë produkt tjetër për prodhimin e energjisë;
- R2 - rigjenerimin / përmirësimin e vetive të tretësve;
- R3 – riciklimin/përmirësimin e vetive të materieve organike të cilat nuk përdoren si tretës (duke përfshirë edhe kompostirimin dhe proceset e tjera të transformimit biologjik);
- R4 - riciklimin/përmirësimin e vetive të metaleve dhe përbërjeve metalike;
- R5 - riciklimin/përmirësimin e vetive të materialeve tjera jorganike;
- R6 – rigjenerimi i acideve ose të bazave;
- R7 - përpunimin e përbërësve që përdoren për uljen e ndotjes;
- R8 – përpunimin e përbërësve të katalizatorëve ;
- R9 - rafinimi i vajit dhe yndyrës së përdorur ose formave të tjera të naftës dhe vajit të përdorur;
- R10 – trajtimin e tokës, në dobi të mjedisit jetësor dhe të bujqësisë;
- R11 – përdorimin e mbeturinave të fituar nga ndonjë operacion i përmendur nga pika R1 deri në R10 të këtij paragrafi;
- R12- shkëmbimi i mbeturinave për shkak të nënshtrimit të ndonjë prej operacioneve të përmendura në pikat R1 deri R11 të këtij paragrafi
- R13- ruajtje të mbeturinave e cila duhet ti nënshtrohet ndonjë prej operacioneve të përmendura

në pikat R1 deri në R12 të këtij paragrafi (me përjashtim të kohës së ruajtjes, para mbledhjes, në vendin ku është krijuar mbeturina)

(2) Operacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni, gjatë importit, eksportit dhe transit të mbeturinave me dokumente përcjellëse të shënuara me shkronjë latine „R“ pas të cilës vijon numri i operacionit përkatëse për përpunim sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Ministri e përshkruan në mënyrë të përafërt mënyrën e përpunimit të mbeturinës për fitimin e energjisë ose përdorim të mbeturinës si ndonjë produkt tjetër për prodhimin e energjisë sipas paragrafit (1) pika R1 të këtij neni.

#### **Neni 41**

##### **Ruajtja e mbeturinave**

(1) Mbeturina e cila mund përsëri të përdoret, përpunohet ose të shfrytëzohet si burim i energjisë, mund të ruhet në vendet të veçanta të parashikuar për këtë dedikim, nëse ruajtja nuk shkakton rrezik ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

(2) Mbeturina mund të ruhet në vende të cilat janë teknikisht të pajisura për ruajtje të përkohshme të mbeturinave, në lokacione të krijuarit të mbeturinës, në vendin për mbledhje, stacionet transferimit dhe lokacionet tjera për mbledhje në pajtim me këtë ligj.

(3) Personat juridik të cilët krijojnë mbeturina mund mbeturinat përkohësisht ta ruajnë në vendin e krijimit, por më së shumti një vjet nga dita e krijimit të saj, nëse mbeturina është dedikuar për largim, gjegjësisht më së shumti tre vjet nga dita e krijimit të saj nëse mbeturina është e dedikuar për trajtim dhe përpunim.

(4) Ruajtja e përkohshme e mbeturinave të paragrafit (3) të këtij neni personat e kryen në mënyrë dhe në vende të cilat i plotësojnë kushtet teknike minimale në raport të mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

(5) Ministri e përshkruan mënyrën e ruajtjes së mbeturinave si dhe kushtet teknike minimale të cilat duhet të plotësojnë vendet në të cilat kryet ruajtja e mbeturinave sipas paragrafit (4) të këtij neni.

#### **Neni 42**

##### **Përdorimi dhe riciklimi i përsëritshëm**

(1) Për shkak të arritjes së nivelit të lartë të shfrytëzimit të resurseve dhe nxitja e zhvillimit ekonomik, personat juridik dhe fizik i ndërmarrin masat dhe aktivitetet në drejtim të arritjes së përdorimit dhe riciklimit të përsëritshëm të materialeve të mbeturinave e sidomos të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit.

(2) Me qëllim të arritjes së nivelit të lartë të efikasitetit të resurseve dhe nxitja e qarkullimit të ekonomisë, në planin sipas nenit 23 të këtij ligji, planet rajonale të nenit 24 të këtij neni, si dhe Plani për parandalim të krijimit të mbeturinave të nenit 25 të këtij ligji duhet të përmbajë masat dhe objektivat e përgatitjes për përdorim dhe riciklim të përsëritshëm.

#### **Neni 43**

##### **Largimi i mbeturinave**

(1) Mbeturina e cila nuk mund të përdoret, riciklohet dhe përpunohet përsëri si burim i energjisë, largohet me zbatimin e operacioneve të veçanta për largim, të përcaktuar në pajtim me nenin 44, paragrafin (1) të këtij ligji.

(2) Para se të largohet, mbeturina duhet ti nënshtrohet trajtimit mekanik, fizik, kimik, termik ose biologjik, me qëllim të zvogëlohet sasia e mbeturinave, volumi i tyre dhe ndikimet negative në mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(3) Para se të bëhet qasja për largim të mbeturinave, ai njëherë duhet të selektohet dhe të klasifikohet në pajtim me listën e llojeve të mbeturinave si në nenin 15 të këtij ligji.

(4) Mbeturinat të cilat nuk mund të selektohen dhe të klasifikohen sipas listës së llojeve të mbeturinave, detyrimisht të bëhet vlerësimi i karakteristikave të saj në pajtim me nenin 16 të këtij ligji, me qëllim të përcaktohet mënyra e veprimit me të njëjtën.

(5) Largimi i mbeturinave kryet në impianteve të dedikuara të veçanta më afër vendit të ndodhjes së mbeturinave e cila është e dedikuar për largim të mbeturinave, dhe e cila ka leje përkatëse në pajtim me dispozitat e këtij neni .

(6) Në planin e nenit 23 të këtij ligji janë të shënuara objektivat për zvogëlimin e deponimit të mbeturinave komunale si operacion i veçantë për largimin e mbeturinave.

#### **Neni 44**

##### **Operacionet për largim të mbeturinave**

(1) Operacionet për largim të mbeturinave janë:

- D 1 – deponimi – shtrirja në ose mbi tokë (për shembull, deponitë etj.);
- D 2 – Trajtimi i tokës (për shembull, biodegradimi i lëngut ose slurit në tokë, etj.);
  
- D 3 – injektimi i thellë (për shembull, injektimi i mbeturinave që mund të derdhen në puse ose zgavra natyrore - shpella, gropa, etj.);
  
- D 4 – kapjes sipërfaqësore (për shembull, vendosja e mbeturinës së lëngshme ose slurit në gropa, liqene ose në laguna etj.);
- D 5 – konstruimi i veçantë i deponisë (për shembull, strehimi në qeli të ndërtuara individuale të cila janë të mbyllura dhe izoluara njëra nga tjera dhe nga mjedisi jetësor etj.);
- D 6 - shtrirja në trupa të mëdhenj ujore përveç deteve / oqeanëve;
- D 7 - shtrirja në dete/oqeanë duke përfshirë përputhje të shtratit të detit;
- D 8 - trajtimi biologjik i cili nuk është definuar në ndonjë vend tjetër me këtë ligj, ndërsa i cili del nga përbërje ose përzierjet finale të cilat largohen me ndonjë nga operacionet e përmendura në pikat prej D1 deri D12 të këtij paragrafi;
- D 9 - trajtimi kimiko-fizik i cili nuk është definuar në ndonjë vend tjetër me këtë ligj, ndërsa i cili del nga përbërje ose përzierjet finale të cilat largohen me ndonjë nga operacionet e përmendura në pikat prej D1 deri D12 të këtij paragrafi (për shembull, avullimi, tharja, kalcinimi, etj.);
  
- D 10 - djegia e tokës, në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe rregullativat e tjera të cilat kanë të bëjnë me djegien;
- D 11 – djegia në det;
- D 12 - ruajtja e përhershme (për shembull, vendosja e kontejnerëve në miniera etj.);
- D 13 - përzierja para nënshtrimit të ndonjë nga operacionet e përmendura në pikat D1 deri D12 të këtij paragrafit;
- D 14 - ripaketimi para nënshtrimit të ndonjë nga operacionet e përmendura në pikat D1 deri D12 të këtij paragrafit dhe
- D 15 – ruajtje deri në kryerjen e ndonjë nga operacionet e përmendura në pikat D1 deri D14 të këtij paragrafit (me përjashtim të kohës së ruajtjes, para mbledhjes në vendin në të cilën është krijuar mbeturina).

(2) Largimi i mbeturinave me zbatim të operacioneve sipas paragrafit (1) të pikave D1 deri D12 të këtij neni llogaritet si zgjidhje e përhershme e menaxhimit të mbeturinave pas të cilës nuk mund të zbatohet në asnjë operacion tjetër për menaxhim të mbeturinave.

(3) Operacionet sipas paragrafit (1) të këtij neni, gjatë importit, eksportit dhe transit të mbeturinave me dokumente përcjellëse të shënuara me shkronjë latine „D“ pas të cilës vijon numri i operacionit përkatës për largim sipas paragrafit (1) të këtij neni.

#### **Neni 45**

##### **Rrjeti i integruar për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Me qëllim të mundësisit të mbledhjes, selektimit, përpunimit sa më të sigurt dhe më ekonomik, si dhe largimit të mbeturinave në impiantet të cilat janë më të afërta të vendit të krijimit të mbeturinës, si dhe përdorimi i metodave dhe teknologjive më të përshtatshme me të cilat sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut, menaxhimi me mbeturina komuna organizohet në pajtim me hierarkinë e menaxhimit të mbeturinave, në rrjetin e integruar për menaxhimin e mbeturinave.

(2) Instalimet e dedikuara për largimin e mbeturinave mund të lidhen me stacionet e transferimit, si dhe me infrastrukturën tjetër për mbledhjen, përzgjedhjen dhe përpunimin e mbeturinave në një rrjet të integruar të menaxhimit të mbeturinave.



(3) Rrjeti i integruar për menaxhimin e mbeturinave mund të jetë i organizuar në nivel të një ose më shumë rajoneve për menaxhimin e mbeturinave.

(4) Në rrjetin e integruar të menaxhimit të mbeturinave që është i organizuar në nivel të një ose më shumë rajoneve, mund të përfshihet një instalim për heqjen e mbeturinave ndërtimore.

(5) Ministri e përshkruan mënyrën dhe kushtet e përafërta të funksionimit të rrjetit të integruar për menaxhimin e mbeturinave komuna e organizuar në nivel rajonal, gjegjësisht në nivel të një ose më shumë komunave ose Qytetit të Shkupit në pajtim me Planin e nenit 23 të këtij ligji.

## **Neni 46**

### **Stacionet transferimit për mbeturina**

(1) Mbeturinat komunale dhe mbeturinat komerciale e cila nga natyra e saj është e përafërt me atë komunale, të dedikuara për ruajtjen, përpunimin ose largimin, mund të transportohen nga vendi i krijimit deri në stacione transferimit, nga ku transportohen deri tek objektet dhe deri te impiantet për ruajtje, përpunim ose largim.

(2) Stacionet transferimit janë pjesë e rrjetit integruar për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 45 të këtij ligji.

(3) Stacionet transferimit duhet të jenë të vendosura në vende ku mund të sigurohet transportimi i mbeturinave të jetë më efikas dhe më ekonomik dhe të siguron funksionim vetjak të qëndrueshëm të sistemit integruar për menaxhimin e mbeturinave, duke pasur parasysh objektivat e shërbimit universal dhe objektivat e afërsisë, dhe të jenë të vendosura në vende dhe të punojnë në atë mënyrë me të cilën do të mundësohet ndikim sa më i vogël i mundshëm mbi mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(4) Ministri i përshkruan kushtet teknike minimale të përafërta të paragrafit (3) të këtij neni të cilat duhet t'i plotësojnë stacionet në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit jetësor, kushtet e përafërta që duhet t'i plotësojnë lokacionet në të cilat ndërtohen gjegjësisht vendosen stacionet, si dhe mënyra dhe afatet e ruajtjes së mbeturinave në stacionet sipas llojit të mbeturinave.

## **Neni 47**

### **Provimi profesional për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Për menaxhim të sigurt dhe të përshtatshëm me mbeturina, personat juridik të cilët menaxhojnë me mbeturina detyrimisht duhet të angazhojnë person të aftësuar profesional për menaxhimin e mbeturinave.

(2) Personi i aftësuar profesional për menaxhimin e mbeturinave është personi i cili ka kaluar provimin profesional për kontroll të njohurive të nevojshme profesionale nga fusha e menaxhimit të mbeturinave dhe ka fituar:

- Vërtetim për menaxhues me mbeturina ose
- Certifikatë për menaxhues të lartë të mbeturinave.

(3) Personi i aftësuar profesional jep provim profesional për menaxhues ose menaxhues të lartë të mbeturinave paraprakisht kur mbaron trajnimin për menaxhues, gjegjësisht menaxhues të lartë të mbeturinave.

(4) Për kandidatin i cili jep provimin profesional mund të paraqitet vetëm person i cili posedon vërtetim për trajnim të kryer nga personi juridik i autorizuar nga ana e ministrit.

(5) Autorizimi sipas paragrafit (4) të këtij neni me të cilën fitohet e drejta që personi juridik të kryen trajnim të paragrafit (4) të këtij neni jepet me vlefshmëri së paku pesë vjet dhe mund ti jepet personit juridik vendor dhe të huaj me:

- 1) hapësirë të pajisur për mbajtjen e trajnimeve;
- 2) kapaciteti teknik për realizim të trajnimit;

- 3) kurrikula e dedikuar për trajnim dhe
- 4) minimum tre persona të angazhuar për realizim të trajnimit me minimum vjet vite përvojë në fushën e shkencave teknike dhe natyrore, ndërsa të ndërlidhura me menaxhimin me mbeturina.
- (6) Vërtetimi gjegjësisht certifikata sipas paragrafit (2) të këtij neni fitohet pas kalimit të provimit profesional, i cili jepet para komisionit të formuar nga ministri, i përbërë nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të cilët kanë së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e menaxhimit të mbeturinave ose me mjedisin jetësor.
- (7) Tre anëtarët dhe zëvendësit e tyre në komisionin sipas paragrafit (.) të këtij neni janë nga organi i mjedisit jetësor, ndërsa dy anëtarët dhe zëvendësit e tyre zgjidhet nga rendi i ekspertëve të shquar nga fusha e menaxhimit të mbeturinave të cilët së paku pesë vjet kanë përvojë në menaxhimin e mbeturinave në bazë të shpalljes publike.
- (8) Komisioni sipas paragrafit (6) të këtij neni për punën e tij mban libër protokollin
- (9) Anëtarëve të komisionit sipas paragrafit (6) të këtij neni ju takon kompensim lartësia e të cilës përcaktohet në varësi të numrit të kandidatëve që janë paraqitur për dhënien e provimit.
- (10) Kandidati për dhënie e provimit paguan kompensim në llogari të veçantë hyrëse të organit të mjedisit jetësor.
- (11) Lartësia e kompensimit sipas paragrafit (9) të këtij neni përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale të bërë për dhënien e provimit profesional.
- (12) Personi i cili e ka kaluar provimin profesional, organi i mjedisit jetësor i jep vërtetim për menaxhues me mbeturina, gjegjësisht certifikatë për menaxhues i lartë me mbeturina.
- (13) Ministri miraton program për dhënien e provimit profesional.
- (14) Ministri e përshkruan mënyrën e dhënies së provimit profesional, formularit të vërtetimit dhe certifikatës, si dhe lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për dhënien e provimit profesional.
- (15) Organi i mjedisit jetësor udhëheq listë të ekspertëve për menaxhimin e mbeturinave në të cilën janë të regjistruar personat e aftësuar profesional të paragrafit (2) të këtij neni si dhe personat juridik të autorizuar për realizimin e trajnimeve sipas paragrafit (5) të këtij neni .
- (16) Lista sipas paragrafit (15) të këtij neni shpallet në ueb faqen e organit për mjedis jetësor dhe rregullisht azhurohet.

#### Neni 48

##### Menaxhuesi i mbeturinave

- (1) Personat sipas nenit 27 dhe nenit 64, paragrafit (1) të këtij ligji janë të obliguar të emërojnë së paku një person të aftësuar profesional - menaxhues të mbeturinave i cili ka autorizim për menaxhues të mbeturinave.
- (2) Provimi profesional për menaxhues të mbeturinave mund të jep personi i cili i plotëson kushtet në vijim:
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
  - të ketë të mbaruar së paku shkallën e VI të arsimit të lartë ose arsim të lartë me së paku VII/1, gjegjësisht diplomë me së paku 180 kredi sipas sistemit elektronik i transferit të kredive (SETK),
  - të mos ti jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa gjatë pasoja e ndalesës
  - të ketë së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit në menaxhimin të mbeturinave ose të mjedisit jetësor.
- (3) Menaxhuesi i mbeturinave është i obliguar të kryerje aktivitetet në vijim:
- e përpilon dhe kujdeset për zbatimin e programit për menaxhimin e mbeturinave të personit,
  - e monitoron gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave,
  - ndërmerr masa dhe aktivitete për zvogëlimin e krijimit të mbeturinave ,
  - kujdeset për zbatimin dhe implementimin e procedurave për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me këtë ligj ose rregullativat tjera ,
  - mban evidencë dhe përpilon raporte në pajtim me nenin 50 të këtij ligji dhe rregullativat për menaxhimin e mbeturinave,

- përpilon programe për fatkeqësitë dhe ndodhitë të mund të ndodhin gjatë menaxhimit të mbeturinave ,
- e kontrollon krijimin e mbeturinave në proceset teknologjike ;
- i informon organet përgjegjëse gjegjësisht personin përgjegjës të personit juridik për mundësin e ndotjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut si rezultat i prodhimit, trajtimit, përpunimit dhe largimit të mbeturinave dhe propozon zgjidhje konkrete dhe
- i kontrollon llojin dhe sasinë e mbeturinave që krijohen, përpunohen dhe largohen, si dhe të lëndëve të para sekondare.

## **Neni 49**

### **Menaxhues i lartë me mbeturina**

(1) Personat juridik të cilët menaxhojnë me mbeturina dhe ata që kryej veprimtari dhe aktivitetet të nenit 65, nenit 71, nenit 72 dhe nenit 73 të këtij ligji, emërojnë së paku një - menaxhues të lartë të mbeturinave.

(2) Menaxhues i lartë i mbeturinave mund të jetë person fizik i cili posedon certifikatë për menaxhues të lartë të mbeturinave, dhe ka dhënë provimin profesional për menaxhues të lartë të mbeturinave.

(3) Provimi profesional për menaxhues të lartë mund të japë peroni fizik i cili:

- të ketë të mbaruar së paku shkallën e VI të arsimit të lartë ose arsim të lartë me së paku VII/1, gjegjësisht diplomë me së paku 180 kredi sipas sistemit elektronik i transferit të kredive (SETK) ose studimet postdiplomike, nga fusha e shkencave teknike,
- të mos ti jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa gjatë pasoja e ndalesës
- të ketë së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit në menaxhimin e mbeturinave ose me mjedisin jetësor të ndërlidhura me punët dhe detyrat e ndërlidhura me menaxhimin praktik të mbeturinave.

(4) Menaxhuesi i lartë me mbeturina gjatë kryerjes së punës së tij detyrimisht duhet të jetë i pranishëm në terren dhe është përgjegjës për menaxhimin e instalimeve gjatë kohës së orarit të punës.

(5) Menaxhuesi i lartë i mbeturinave është i obliguar të kryejë aktivitetet në vijim:

- kujdeset për aspektin teknik të punës dhe kryerjes së veprimtarisë ;
- organizim dhe menaxhim të sistemit/impianitit rajonal;
- kujdeset për sigurinë dhe funksionimit të papengueshëm të sistemit/impianitit rajonal;
- implementim të ekspertizës teknike/ kuptimi i pajisjeve teknike dhe mjetet operative;
- kryen mbikëqyrje teknike të llojit dhe sasisë së mbeturinave të cilat menaxhohen në sistemin/impianitit rajonal;
- përgatit program operativ për monitorimin dhe kontrollon e punës së sistemit/instalimit rajonal a është në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullativat e miratuara ;
- është përgjegjës për përgatitjen e programit për aftësim profesional dhe arsimor të të punësuarve në sistemin/impianitit rajonal dhe
- është përgjegjës për përpilimin dhe miratimin e planeve dhe programe për shmangien dhe zvogëlimin e pasojave të fatkeqësive dhe ndodhive.

(6) Personi juridik sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të angazhon person fizik të huaj për menaxhues të lartë të mbeturinave nëse ai i plotëson kushtet për menaxhues të lartë të mbeturinave dhe posedon kualifikime përkatëse nga vendi i të cilit është shtetas në pajtim me ligjin.

## Neni 50

### Detyrimi për mbajtjen e evidencës dhe njoftimi

(1) Subjektet të cilat menaxhojnë mbeturinat në pajtim me dispozitat e këtij neni janë të obliguar të mbajnë evidencë për:

- 1) llojin, sasinë dhe origjinën e mbeturinave të cilat i menaxhon;
- 2) llojin dhe sasinë e mbeturinave të përkohshme të ruajtura ;
- 3) llojin dhe sasinë e mbeturinave që i është dhënë mbledhësit dhe transportuesit të mbeturinave;
- 4) llojin dhe sasinë e mbeturinave që është përdorur ose përpunuar;
- 5) llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat i janë dhënë personit tjetër juridik të cilët bëjnë përpunimin e mbeturinave ;
- 6) të dhëna për zbatim të operacioneve për përpunim sipas nenit 39 dhe 40 të këtij ligji;
- 7) llojin dhe sasinë e mbeturinave i cili është dedikuar për largim në pajtim me nenin 43 dhe nenin 44 të këtij ligji;
- 8) llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat përpunohen ose largohen jashtë shtetit;
- 9) të dhënat për destinacionin fillestar dhe përfundimtar të transportimit të mbeturinave;
- 10) llojin dhe sasinë e mbeturinave i cili është regjistruar si lëndë e parë sekondare, gjegjësisht mbeturina të cilat kanë ndërprerë të jenë mbeturina në pajtim me nenin 18 dhe nenin 19 të këtij ligji dhe

11) të dhëna të tjera për menaxhimin e mbeturinave.

(2) Personat juridik dhe fizik sipas nenit 27 të këtij ligji obligohen të mbajnë evidencë për:

- 1) llojin, sasinë dhe origjinën e mbeturinave që e krijojnë;
- 2) llojin dhe sasinë e mbeturinave të përkohshme të ruajtura ;
- 3) llojin dhe sasinë e mbeturinave që i është dhënë mbledhësit dhe transportuesit të mbeturinave;
- 4) llojin dhe sasinë e mbeturinave që është përdorur ose përpunuar nga vetë krijuesi;
- 5) llojin dhe sasinë e mbeturinave që u është dhënë personave të tjerë juridikë të cilët bëjnë përpunimin e mbeturinave, nëse përpunimi nuk është kryer nga vetë krijuesi i mbeturinave
- 6) llojin dhe sasinë e mbeturinave që është larguar;
- 7) llojin dhe sasinë e mbeturinave i cili është eksportuar për përpunim ose largim jashtë vendit.

8) llojin dhe sasinë e mbeturinave i cili është regjistruar si lëndë e parë sekondare, gjegjësisht mbeturina të cilat kanë ndërprerë të jenë mbeturina në pajtim me nenin 18 dhe nenin 19 të këtij ligji dhe

9) të dhëna të tjera për menaxhimin e mbeturinave.

(3) Evidenca sipas paragrafit (1) të këtij neni, personat e udhëheqin në ditarët e tyre në përditshmëri.

(4) Subjektet sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni janë të obliguar për transport të mbeturinave gjatë dorëzimit të mbeturinave për transport ti jep formular identifikues dhe transportues të mbeturinës.

(5) Gjatë eksportit, importit ose transitit të mbeturinave, subjektet të cilat transportojnë mbeturina janë të obliguar kopje të formularëve të nenit 96, paragrafi (7) dhe (8) të këtij neni gjatë hyrjes, daljes ose transitit të mbeturinave nga/nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ti dorëzojë deri tek organi kompetent për kryerjen e punëve doganore.

(6) Subjektet sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni janë të obliguar formularët sipas paragrafit (4) dhe (5) të këtij neni t'i ruajnë si pjesë përbërëse e evidencës së plotë të menaxhimit të mbeturinave.

(7) Subjektet sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni janë të obliguar, njëherë në vit të dhënat e evidencës të llojit të raportit konsoliduar të shënuar në formular t'i dorëzon tek organi profesional më së voni deri më 31 janar të vitit aktual për vitin paraprak.

(8) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni të cilët kryejnë veprimtari për mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale janë të obliguara të dhënat e evidencës të këtij neni t'i dorëzojnë te njësia organizative të nenit 35 të këtij ligji, më së voni deri më 31 janar të vitit aktual për vitin paraprak.

(9) Njësitë organizative të nenit 35 të këtij ligji janë të obliguar të dhënat sipas paragrafit (7) të këtij neni, në lloj të raportit të konsoliduar të shënuar në formular 'ti dorëzojë tek organi profesional më së voni deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraprak.

(10) Personat sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni janë të obliguar të dhënat e evidencës t'i ruajnë së paku pesë vjet, përveç operatorëve të sistemit rajonal për menaxhimin e mbeturinave të cilët kanë obligim të dhënat e evidencës t'i ruajnë pesë vjet pas mbarimit të afatit të përcaktuar për punë të sistemit rajonal, si dhe derisa zgjat faza e kujdesit të mëtutjeshëm të mbylljes.

(11) Ministri e përshkruan formën dhe përmbajtjen e formularit për udhëheqje të evidencës së paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, formën, përmbajtjen, si dhe mënyrën e udhëheqjes së ditarit sipas paragrafit (3) të këtij neni, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e menaxhimit me formularët sipas paragrafit (4) të këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit sipas paragrafit (7) dhe (9) të këtij neni.

## **VI. RREGULLA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE TË RREZIKSHME**

### **Neni 51**

#### **Rregullat për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme**

(1) Menaxhimi me mbeturina të rrezikshme bëhet ndaras nga llojet tjera të mbeturinave.

(2) Ndalohet derdhja dhe hedhja e mbeturinave të rrezikshme në tokë, në ujë në kontejnerët për mbledhje të llojit të tjetër të mbeturinave, sistem për mbledhje dhe përçimin e ujërave të zeza urbane, si dhe ruajtjen dhe largimin në vende të cilat nuk janë të përcaktuar për këtë dedikim.

(3) Ministri i përshkruan vetitë e mbeturinave të rrezikshme dhe rregullat e përafërta për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

### **Neni 52**

#### **Ndalesa për përzjerje të mbeturinave të rrezikshme**

(1) Ndalohet përzjerja e mbeturinave të rrezikshme me lloje të tjera të mbeturina të rrezikshme, si dhe përzjerja e mbeturinave të rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave, substancave ose materie.

(2) Si përjashtim sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi profesional, me kërkesë me shkrim nga krijuesi ose poseduesi i mbeturinës së rrezikshme, mund të japë pëlqimin për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme me të cilën miraton përzjerjen e mbeturinave të rrezikshme, si dhe përzjerje të mbeturinave të rrezikshme me llojet e tjera të mbeturinave, me substanca ose me materie, nëse përcakton se:

- aktiviteti i përzjerjes kryet nga subjektit i cili në pajtim me nenin 64 të këtij ligji ka marrë leje për kryerjen e veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme
- me këtë do të përmirësohet siguria e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme dhe se përzjerja nuk e rrezikon mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut dhe
- operacionet e përzjerjes së mbeturina kryhen sipas teknikave më të mira në dispozicion.

### **Neni 53**

#### **Menaxhimin e mbeturinave të përziera**

(1) Në raste kur mbeturinat e rrezikshme është përzjerje me llojet e tjera të mbeturinave, substancave dhe materieve, detyrimisht të njoftohet organi profesional.

(2) Në raste të paragrafit (1) të këtij neni, patjetër të vepohet së pari drejt ndarjes së mbeturinës, nëse procedura e ndarjes është teknikisht e mundshëm dhe ekonomikisht e papagueshme dhe e zvogëlon rrezikun ndaj mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut dhe kur është e domosdoshme plotësimi i rregullave për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 37 të këtij neni.

(3) Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme dhe nisja e procedurës së paragrafit (1) të këtij neni, kryet në bazë të pëlqimit të marrë me shkrim për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme të cilën e jep organi profesional pas dorëzimit të kërkesës deri tek organi profesional.

(4) Në kërkesën për dhënie të pëlqimit të paragrafit (3) të këtij neni, kërkuesi është i obliguar të dorëzojë edhe raport për vlerësimin e kryer të karakteristikave të mbeturinave në pajtim me nenin 16 të këtij ligji.

(5) Në kërkesën sipas paragrafit (3) të këtij neni veçanërisht shënohet lloji i mbeturinës, shkaku i përzjerjes së mbeturinës së rrezikshme dhe menaxhim të mëtutjeshëm me mbeturinat e rrezikshme.

(6) Ministri e përshkruan formën dhe përmbajtjen e kërkesës për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme të paragrafit (3) të këtij neni, dokumentet e nevojshme, si dhe formën dhe përmbajtjen në pajtim me menaxhimin të mbeturinave të rrezikshme të paragrafit (3) të këtij neni.

#### **Neni 54**

##### **Paketimi dhe etiketimi i detyrueshëm i mbeturinave të rrezikshme**

(1) Mbeturinat e rrezikshme të dedikuara për transportim, përpunim, ruajtje dhe largim do të paketohen dhe etiketohen në mënyrë e cila mundëson mbrojtje të tërësishme të mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut.

(2) Paketimi i mbeturinave të rrezikshme do të kryet në kontejnerët speciale të dizajnuara në pajtim me llojin e mbeturinës, në të cilën patjetër duhet të shënojë “Mbeturinë e rrezikshme” të jetë e shënuar në pajtim me shkallën e rrezikshmërisë së mbeturinës, të ketë edhe shënime për masat e sigurisë, si dhe shënime të cilat do të sigurohet menaxhim i sigurisë i mbeturinave të rrezikshme.

(3) Ndalohet transportimi i mbeturinave të rrezikshme të cilat nuk janë paketuar dhe etiketuar në pajtim me këtë ligj.

(4) Ministri e përshkruan mënyrën e paketimit dhe etiketimit të mbeturinave të rrezikshme.

#### **Neni 55**

##### **Menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme të amvisërisë**

(1) Nenet 51, 52, 53 dhe 54 të këtij ligji, nuk kanë të bëjnë me përzjerje të mbeturinave të rrezikshme të krijuara nga amvisëritë.

(2) Mbeturinat e rrezikshme të amvisërisë mblidhen veçmas nga mbeturinat tjera të krijuara nga amvisëritë në vende për mbledhje ku janë të vendosura kontejnerët të cilat shërbejnë për mbledhjen e mbeturinave të rrezikshme ose në qendrat e mbledhjes.

(3) Personat fizik janë të detyruar ta selektojnë mbeturinë e rrezikshme nga mbeturinat e tjera të amvisërisë dhe ta vënë në vendin më të afërt për mbledhje ose në qendrat për mbledhje.

(4) Ofruesi i shërbimit është i obliguar ta mbledh dhe ta transporton mbeturinë e rrezikshme nga amvisëritë në vendet mbledhëse ose në qendrat për mbledhje dhe ta dorëzon deri te operatori i qendrës rajonale.

(5) Operatorët e qendrave rajonale për menaxhimin e mbeturinave janë të detyruar të selekcionojnë dhe ta dorëzojnë mbeturinë e mbledhur të rrezikshme nga amvisëritë personave juridik të cilët posedojnë leje përkatëse për kryerjen e veprimtarisë së menaxhimit të mbeturinave.

#### **Neni 56**

##### **Menaxhimi me mbeturina mjekësore**

(1) Me mbeturina mjekësore menaxhohet në pajtim me dispozitat për mbeturina të rrezikshme të këtij ligji dhe rregullativat e fushës së menaxhimit të mbeturinave.

(2) Mbeturinat mjekësore nga objektet në të cilat realizohet mbrojtja shëndetësore dhe veterinarisë i përfshinë llojet e mbeturinave infektuese, kimike, mbeturina nga barnat, si dhe citometjet, sendet e mprehta dhe lloj tjetër të mbeturinave të rrezikshme.

(3) Mbeturinat nga barnat të cilat kanë origjinë nga amvisëritë nuk guxojnë të largohen së bashku me mbeturinat komunale, por dorëzohen pa pagesë në barnatoret të cilat veprojnë në pajtim me rregullativat për barna dhe mjete mjekësore.

(4) Personi ose institucioni shëndetësor i cili krijon ose posedon mbeturina sipas paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni përpilon program për menaxhimin me mbeturina dhe të njëjtën e dorëzon për miratim në organi profesional.

(5) Personi ose institucioni veterinar i cili krijon ose posedon mbeturina sipas paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni përpilon program për menaxhimin me mbeturina dhe të njëjtën e dorëzon për miratim në organi profesional.

(6) Ministri në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët të fushës së shëndetësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët të fushës së veterinarisë i përshkruajnë mënyrën e menaxhimit të mbeturinave mjekësore, si dhe mënyrën e paketimit dhe etiketimit të mbeturinave mjekësore.

## **Neni 57**

### **Menaxhimi me dioksid titaniumi**

(1) Ndalohet largimi i mbeturinave të dioksid titaniumit dhe mbeturinave të krijuara nga prodhimi i dioksid titaniumit, si dhe përpunimet e saj në hapësirat ujore.

(2) Personat juridik dhe fizik të cilët krijojnë, prodhojnë ose përpunojnë dioksid titaniumit janë të obliguar deri tek organi profesional të dorëzojnë të dhëna për mbeturinat e dioksid titaniumit, i cili është i dedikuar për largim.

(3) Të dhënat sipas paragrafit (2) të këtij neni kanë të bëjnë me :

- 1) vetitë fizike, kimike, biokimike dhe biologjike të mbeturinave;
- 2) gjendja fizike e mbeturinave;
- 3) toksiciteti, qëndrueshmëria fizike, kimike dhe biologjike e mbeturinave;
- 4) akumulimi dhe biotransformimi në organizmat e gjallë ose sedimentet;
- 5) prirjen e mbeturinave ndaj transformimeve fizike, kimike dhe biokimike dhe sjellja e tyre në kontakt me një medium të caktuar ose substanca të tjera organike dhe inorganike;
- 6) mënyra e paketimit dhe metodat që do të mbrojnë shpërndarjen e mbeturinave dhe
- 7) masat e kujdesit për mbrojtjen e mjedisit, jetës dhe shëndetit të njeriut.

(4) Krijuesit, poseduesit dhe përpunuesit e dioksid titaniumit dhe të mbeturinave të dioksid titaniumit janë të obliguar të kryejnë monitorim të tokës, ujit dhe ajrit në vende ku bëhet përpunimi, ruajtja dhe largimi i mbeturinave të dioksid titaniumit, si dhe për zonën përreth e cila mendohet se është jo e ndotur.

(5) Personat juridikë dhe fizikë të cilët prodhojnë dioksid titaniumit janë të obliguar në raportin e dorëzuar te organi profesional t'i cekin informacionet shtese për përmbajtjen e sulfurit dhe klorit në mbeturinë, për secilin ton të prodhimit të dioksid titaniumit.

(6) Nëse në bazë të të dhënave të marra nga monitorimi përcaktohet se vetitë e rrezikshme dhe efektet e largimit të mbeturinave të dioksid titaniumit mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme dhe afatgjata në mjedis jetësor, jetë dhe shëndetin e njeriut, Ministri në pajtueshmëri me ministrin i cili udhëheq me organi e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të fushës së ekonomisë mund ndalojë prodhimin dhe përpunimin e dioksid titaniumit, si dhe largimin e mbeturinave të dioksid titaniumit.

(7) Personat juridik dhe fizik të cilët prodhojnë dhe përpunojnë dioksid titaniumit janë të detyruar të kryejnë analizat plotësuese të mbeturinës së dioksid titaniumit dhe efektet e saj mbi tokën, ujin, ajrin, si dhe kushtet e monitorimit të deponisë në stacionet për mbeturina të dioksid titaniumit.

(8) Ministri e përshkruan mënyrën e menaxhimit të mbeturinave të dioksid titaniumit, mënyrën e kryerjes së monitorimit sipas paragrafit (4) të këtij neni si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrë e dorëzimit të të dhënave të paragrafit (2) të këtij neni.

## **Neni 58**

### **Rregullat për menaxhimin e mbeturinave të azbestit dhe mbeturinave të produkteve që përmbajnë azbest**

(1) Personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturina të azbesti dhe me mbeturina të produkteve të cilat përmbajnë azbest janë të obliguar të veprojnë në mënyrë të kujdesshme dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme mbrojtëse me të cilat parandalohet lëshimi i grimcave, fijeve dhe pluhurit të azbestit në ajër, si dhe parandalimin e derdhjes së lëngjeve të cilat përmbajnë fije të azbestit .

(2) Mbeturinat të cilat përmbajnë pse lëshojnë grimca, fije ose pluhur të azbestit mund të ruhen dhe të largohen në vendet të parashikuar veçanërisht për këtë dedikim, si dhe të ndahet veçmas nga llojet e tjera të mbeturinave, i seleksionuar dhe i paketuar mirë në mënyrë të përshkruar në paragrafi (3) të këtij ligji dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Ministri e përshkruan mënyrën e menaxhimit të mbeturinave me azbest dhe me mbeturina të produkteve të cilat përmbajnë azbest.

### **Neni 59 Menaxhimi me PCB**

(1) Ndalohet:

- 1) prodhimi, importi dhe qarkullimi i PCB;
- 2) përdorim dhe përpunim i përsëritshëm të mbeturinave PCB dhe
- 3) mbushja dhe plotësimi i përsëritshëm të pajisjeve me PCB.

(2) Lloji i pajisjeve të cilat mund të përmbajnë PCB trajtohen sikur të përmbajnë PCB vetëm nëse nuk ekzistojnë arsye dhe të dhëna të cilën tregojnë të kundërtën.

(3) Personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar të kryejnë regjistrim të pajisjeve të paragrafit (2) të këtij neni të cilën e posedojnë ose e udhëheqin në evidencë për të njëjtën, rregullisht ta azhurojë dhe plotësojë në pajtim me dispozitat e këtij ligjit dhe me rregullativat e tjera .

(4) Personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar me këtë ligj dhe me rregullativat tjera të përpilojnë plan për dekontaminimin dhe/ose largimin e pajisjeve të regjistruar me PCB përmbajtje në të, si dhe skema për mbledhje dhe largim të mëtutjeshëm të pajisjeve të cilat nuk janë lëndë e regjistrimit.

(5) Personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar të etiketojnë pajisjen e cila përmban ose ka përmbajtur PCB e cila është lëndë e regjistrimit, si dhe ta etiketon hapësirë ose lokacionin ku është vendosur pajisje e tillë në pajtim me këtë ligj dhe rregullativat e tjera.

(6) Ministri e përshkruan mënyrën dhe kushtet për menaxhim me PCB, mënyrën dhe kushtet të cilat duhet ti plotësojë objektet dhe instalimet për largimin dhe dekontaminimin e PCB, PCB e përdorura dhe mënyra e etiketimit të pajisjeve të cilat përmbajnë PCB si dhe mënyra e etiketimit të hapësirave dhe lokacioneve në të cilat është vendosur pajisje e tillë.

## **VII. MENAXHIMI I MBETURINAVE TË PARREZIKSHME**

### **Neni 60**

#### **Mënyra e realizimit të shërbimit publik nga ana e Komunave dhe Qytetit të Shkupit**

(1) Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave komunale, sigurimi i seleksionimit të mbeturinave rrjedhëse të veçanta, mbledhja e mbeturinave të lëna, si dhe përdorimi dhe mirëmbajtja e kontejnerëve për selektim dhe mbledhje të mbeturinave komunale, vendet mbledhëse dhe qendrat mbledhëse, si dhe organizimi i sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit, dhe nga lagjet e izoluar në nenin 6, paragrafin (6) të këtij ligji, paraqesin shërbime publike me rëndësi lokale të cilat zbatohen në pajtim me parimin e shërbimit universal .

(2) Në propozim të kryetarit të komunës dhe qytetit të Shkupit, Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të themelojnë ndërmarrje publike për mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale.

(3) Dy ose më shumë komuna, si dhe komunat dhe Qyteti i Shkupit së bashku mund të themelojnë ndërmarrje publike për kryerjen e veprimtarisë të paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave komunale, për një ose më shumë komuna, kryetari i komunës dhe i Qytetit të Shkupit mund t'ia besojnë personit juridik me lidhje të kontratës sipas procedurës së parashikuar me Ligjin e Koncesionit dhe Partneritetit Privato-Publik.

(5) Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave komunale të seleksionuara e cila paraqet rrjedhje e veçantë e mbeturinave kryhet në pajtim me rregullativat e fushës për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit.

(6) Ndërmarrjet publike të paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni dhe personat juridik të paragrafit (4) të këtij neni (në tekstin e mëtutjeshëm: ofruesit e shërbimit) patjetër të posedojnë leje për menaxhimin e mbeturinave, të dhënë në pajtim me nenin 64 të këtij ligji.



## **Neni 61**

### **Sigurimi i zbatimit të parimit universal të shërbimit në nivel lokal**

(1) Këshilli i Komunës ose i Qytetit të Shkupit, në propozim të kryetarit të komunës ose të Qytetit të Shkupit në bazë të rregullave të përgjithshme të miratuara në pajtim me nenet 37 dhe 51 të këtij ligji, në mënyrë të detajuar do i përshkruaj kushtet, mënyrat dhe skemat e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në kornizë të sistemit integrues për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës gjegjësisht Qytetit të Shkupit dhe do i përfshinë edhe lagjet e izoluar të nenit 6, paragrafit (1), pika 6) të këtij ligji.

(2) Me rregullativat sipas paragrafit (1) të këtij neni do të përshkruhet:

- 1) territori ku do të kryhet shërbimi universal ;

- 2) mënyra dhe frekuenca e mbledhjes së mbeturinave komuna në vendbanime të caktuara të rajonit ku kryhet shërbimi;

- 3) llojet e masave stimuluese;

- 4) kërkesat teknike dhe të tjera të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e vendeve mbledhëse dhe qendrave mbledhëse të shërbimit për mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale, si dhe seleksionimi i rrjedhave të veçanta të mbeturinave dhe

- 5) çështje tjera të cilat janë me rëndësi për zbatim të sistemit integrues për menaxhimin e mbeturinave.

(3) Kryetari i Komunës ose i Qytetit të Shkupit është i detyruar përkaj shpalljes në fletë zyrtare të komunës dhe të Qytetit të Shkupit, i informon edhe në mënyrë tjetër shfrytëzuesit e shërbimit për aktet e miratuara sipas paragrafit (1) të këtij neni.

## **Neni 62**

### **Mbledhja dhe seleksionimi i mbeturinave komunale**

(1) Ofruesi i shërbimit në bashkëpunim me vepruesit e mbeturinave rrjedhëse të veçanta në kornizë të sistemit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesve, janë të detyruar në vendet e përcaktuara nga kryetari i Komunës ose i Qytetit të Shkupit (vendet mbledhëse) të vendosin kontejner për mbledhje dhe seleksionim të mbeturinave me të cilat do të mundësohet seleksionimi i mbeturinave para mbledhjes së tyre, e veçanërisht mbledhjen e caktuar të mbeturinave të rrezikshme të krijuara nga amvisëritë.

(2) Ofruesit e shërbimeve janë të detyruar në vendet e përcaktuara nga kryetari i Komunës ose Qytetit të Shkupit ti organizojnë qendrat mbledhëse sipas nenit 6, paragrafi (1), pika 32 të këtij ligji .

(3) Gjatë përcaktimit të numrit dhe lokacionet e qendrave mbledhëse merret parasysh numri i banorëve në atë vendbanim, me çka sigurohet të paktën një qendër mbledhëse për 15.000 banorë .

(4) Kryetari i Komunës ose i Qytetit të Shkupit kujdeset për plotësimin e detyrimit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

## **Neni 63**

## **Rregulla për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe i llojeve të mbeturinave të tjera të parrezikshme**

(1) Subjektet të cilat krijojnë ose kanë mbeturinë komerciale janë të detyruar të kryejnë selektim të mbeturinave në vendin e krijimit të tyre në kontejnerë të veçantë të cilat janë të ndryshëm nga ato që janë të dedikuara për amvisëritë.

(2) Krijuesit e mbeturinave komerciale sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të detyruar të lidhin kontratë të veçantë për mbledhje dhe transportim të mbeturinave me ofruesin e shërbimit ose me personi juridik i cili ka leje për menaxhimin e mbeturinave si pjesë vepruesve me mbeturina rrjedhëse të veçanta në kornizë të sistemit për zgjerim të përgjegjësisë së prodhuesit.

(3) Amvisëritë janë të detyruara të kryen selektimin e mbeturinave sipas llojit dhe karakteristikave të tyre në vendin e krijimit të tyre dhe t'i hedhin ato në kontejnerët e veçantë të siguruar nga ofruesi i shërbimit dhe vepruesit me mbeturina rrjedhëse të veçanta në kornizë të sistemit për zgjerim të përgjegjësisë së prodhuesit.

(4) Personat juridik të cilët në kryerjen e veprimtarisë së tyre gjatë vitit kalendarik krijojnë ose kanë mbeturina më shumë se sasia e përcaktuar në nenin 27 të këtij ligji, mund të lidhin kontratë për mbledhje dhe transportim të mbeturinave të parrezikshme, me personat juridik të cilët kanë leje për kryerjen e veprimtarisë të menaxhimit të mbeturinave.

(5) Ministri i përshkruan rregullat e veçanta për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe llojet e mbeturinave të tjera të parrezikshme.

## **VIII. LEJA PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE**

### **Neni 64**

#### **Veprimtaritë për të cilat është e nevojshme marrja e lejes për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Subjektet të cilat menaxhojnë me mbeturina janë të detyruar të posedojnë leje për menaxhimin e mbeturinave nëse:

- 1) mbledhin dhe transportojnë mbeturina;
- 2) ruan mbeturina dhe
- 3) përpunon ose riciklon mbeturina në stacionet stacionare ose mobile.

(2) Leja sipas paragrafit (1) të këtij neni e jep organi profesional në bazë të kërkesës në formular të veçantë të parashtruar nga ana e personit që menaxhon me mbeturina.

(3) Kërkesa sipas paragrafit (2) të këtij neni në veçanti përmban:  
-titullin dhe adresën e kërkuarit;

-llojin e veprimtarisë të menaxhimit të mbeturinave për të cilën kërkohet leja ;

-llojet dhe sasi të mbeturinave me të cilat do të menaxhojë ;

-dëshmi se lokacioni në të cilën do të kryhet veprimtaria është në pajtim me rregullativat për planifikim hapësinor dhe mjedisit jetësor;

-dëshmi për plotësimin e kushteve teknike minimale për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me rregullativat sipas paragrafit (12) të këtij neni ;

-mënyra e kryerjes së veprimtarisë ;

-përshkrimi i masave të sigurisë dhe masave paraprake të marra gjatë kryerjes së veprimtarisë;

-mënyra e kryerjes së monitorimit dhe mbikëqyrjes mbi realizimin e veprimtarisë ;

-mënyra e kujdesit pas mbylljes, në fakt pas ndërprerjes së kryerjes së veprimtarisë dhe

-garanci financiare gjegjësisht sigurimi në dobi të organit të mjedisit jetësor.

(4) Subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të kryejë një ose më shumë veprimtari për menaxhim të mbeturinave sipas paragrafit (1) të këtij neni vetëm nëse i plotëson kushtet e shënuara për secilën veprimtari veçmas .

(5) Nëse subjekti plotëson kushtet për kryerjen e veprimtarisë, organi profesional do të jep leje për menaxhimin e mbeturinave në të cilën në veçanti shënohen:

- kërkesat teknike minimale në raport me pajisjet, kuadrin dhe hapësirën e nevojshme për kryerje të veprimtarisë;

- llojet dhe sasi të mbeturinave të cilat do t'i menaxhojë;

- mënyra e kryerjes së veprimtarisë;

- masat preventive dhe të sigurisë që duhet të ndërmerren me qëllim që ndikimi mbi mjedisin jetësor të jetë në përputhje me rregullativat për mjedis jetësor dhe ruajtje të shëndetit të njeriut;

- shumën e përcaktuar dhe llojin e garancisë, përkatësisht sigurimin me të cilën do të sigurohet kompensim të dëmit mbi mjedisin jetësor nga kryerja e veprimtarisë;

- shumën e përcaktuar dhe llojin e garancisë me të cilën sigurohet kujdesi pas mbylljes, pra pas ndërprerjes së kryerjes së veprimtarisë dhe

- kushte të tjera që dalin nga vlerësimi i kryer i ndikimit në mjedis në përputhje me rregulloret mjedisore.

(6) Subjekti sipas paragrafit (1) i cili kryen veprimtaritë e pikave 2) dhe 3) të këtij neni është i obliguar të vendosë video mbikëqyrje të vendit të pranimit të mbeturinave, si dhe në vendet e tjera të lokacionit ose objektit nëpërmjet të cilës do të mund të vërejë pranimin, menaxhimin, përdorimin, ruajtjen dhe porositjen e mbeturinave.

(7) Të dhënat nga videombikëqyrja sipas paragrafit (6) të këtij neni, subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar t'i ruajë së paku tri vjet.

(8) Mënyra, procedura dhe kushtet për marrjen e lejes për menaxhimin e mbeturinave me rrjedhje të veçantë të mbeturinave në regjimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit rregullohet me rregullivat të cilat i rregullojnë rrjedhat e veçanta të mbeturinave.

(9) Leje për menaxhimin e mbeturinave për veprimtarinë sipas paragrafit (1) të këtij neni jepet për periudhë dhjetëvjeçare (duke përfshirë edhe ndryshimet e lejes në periudhën e përmendur).

(10) Gjashtë muaj para kalimit të afatit të lejes sipas paragrafit (9) të këtij neni, subjekti i cili posedon leje, dorëzon kërkesë për ripërtirjen e lejes .

(11) Gjatë ripërtërimit ose transferimit të lejes nga një subjekt në një subjekt tjetër zbatohen dispozitat të cilat vlejné për dhënien e lejes në pajtim me dispozitat e këtij ligji .

(12) Ministri në mënyrë të përafërt i përshkruan kërkesat që duhet të plotësohen nga ana e subjektit për marrjen e lejes për menaxhimin e mbeturinave për çdo veprimtari të paragrafit (1) të këtij neni për secilën veprimtari veçmas.

(13) Ministri e përshkruan formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës, si dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(14) Ministri e përshkruan formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për kryerjen të veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(15) Ministri i përshkruan mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shumës së garancisë financiare dhe lartësinë dhe llojin e sigurimit në bazë të llojit dhe sasisë së mbeturinave të cilat menaxhon subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe llojin e menaxhimit të mbeturinave, kohëzgjatja, si dhe mënyra e pagesës së garancisë financiare gjegjësisht sigurimit në pajtim me nenet (3) dhe (5) të këtij neni.

## **Neni 65**

### **Veprimtaria për menaxhimin e mbeturinave për instalimet për të cilat është e nevojshme leje integruese ekologjike**

(1) Subjekti i cili kryen veprimtari për menaxhimin e mbeturinave për të cilën është e nevojshme marrja e A- lejes integruese ekologjike në pajtim me rregullativat e mjedisit jetësor, leje e nenit 64 jepet si pjesë e procedurës për dhënie të lejes integruese ekologjike dhe e njëjta është pjesë e lejes integruese ekologjike.

(2) Në raste të paragrafit (1) të këtij neni, organi i cili e jep A- lejen integruese ekologjike është i obliguar të vërteton nëse subjekti i cili menaxhon me mbeturina i plotëson kushtet e nenit

64 të këtij ligji të përshkruara për dhënien e lejes për kryerje të veprimtarisë të menaxhimit të mbeturinave.

(3) Subjekti i cili kryen veprimtarinë për menaxhimin e mbeturinave për të cilën është e nevojshme marrja e B- lejes integruese ekologjike, organi profesional e jep lejen në pajtim me nenin 64 të këtij ligji, ndërsa kërkesat e shënuara në të do të shënohen edhe si kushte në B- lejen integruese ekologjike.

(4) Organi i cili e jep B- lejen integruese ekologjike është i obliguar ta informon organi profesional se kushtet e lejes të nenit 64 të këtij ligji janë të futura në B- lejen integruese ekologjike e cila jepet në pajtim me rregullativat e mjedisit jetësor.

## **Neni 66**

### **Leje për ndërtim të impianteve për kryerje të veprimtarisë së menaxhimit të mbeturinave**

(1) Kërkesa për marrjen e lejes për ndërtim të impianteve për kryerjen e veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave e cila ka të bëjë me ruajtjen, trajtimin, përpunimin dhe largimin e mbeturinave, investitori e dorëzon tek organi kompetent për dhënie e lejes, në pajtim me rregullativat për ndërtim.

(2) Leja për ndërtim të impianteve për kryerje të veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave e cila ka të bëjë me ruajtjen, trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave nuk do ti jepet nëse investitori nuk ka marrë miratimit të studimit të përgatitur të fizibilitetit dhe nuk ka marrë aktvendim për miratim të studimit për vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor nga organi profesional, gjegjësisht miratim të elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me Ligjin e Mjedisit Jetësor

(3) Për ndërtim të impianteve për largim të mbeturinave sipas nenit 69 të këtij ligji para fillimit të zbatimit të procedurës për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor në pajtim me rregullativat e mjedisit jetësor, themeluesi sipas nenit 71, 72 dhe 73 të këtij ligji, detyrimisht përgatit studim fizibilitetit të cilën e dorëzon deri te organi profesional për miratim.

(4) Studimi sipas paragrafit (3) të këtij ligji, detyrimisht përmban të dhënat për:  
- përcaktimin se vallë ndërtimi i impianteve për largim të mbeturinave është në pajtim me dokumentet strategjike dhe të planit nga fusha e menaxhimit të mbeturinave të përshkruara në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe rregullativat për planifikim hapësinor;  
- arsyetim ekologjik dhe ekonomik të ndërtimit të instalimeve dhe qëndrueshmëria e të njëjtave.

(5) Leje për ndërtim të impianteve për kryerjen e veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave e cila ka të bëjë me largimin e mbeturinave nuk do ti jepet nëse investitori nuk ka marrë miratimin të studimit të përgatitur të fizibilitetit dhe nuk ka marrë aktvendim për miratim të studimit për vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor nga organi profesional, gjegjësisht miratim të elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **Neni 67**

### **Procedura për dhënien e lejes për kryerje të veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Organi profesional është i detyruar në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës të nenit 64 , paragrafi (3) të këtij ligji ta njoftojë kërkuar nëse vërteton se mangësi në të njëjtën, si dhe nëse i nevojiten të dhëna plotësuese të përcakton afat, i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se tetë ditë, në të cilin afat kërkuar është i obliguar ti eliminon mangësitë ose të dorëzojë të dhënat e kërkuara .

(2) Nëse kërkuar i nevojitet më shumë kohë se afati i përcaktuar në paragrafin (1) të këtij ligji, për këtë do e njofton organi profesional në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të njoftimit sipas paragrafit (1) të këtij neni .

(3) Organi profesional është i detyruar, para dhënies së lejes për kryerjen e veprimtarisë së menaxhimit të mbeturinave sipas nenit 64, paragrafi (1), pikat (2) dhe (3) të këtij ligji, përkatësisht personi zyrtar i cili udhëheq procedurën për dhënien e lejes në organin profesional, të kryer inspektim në vend për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave dhe të përgatit procesverbal për inspektimin e kryer.

(4) Organi profesional është i obliguar ta japë lejen për kryerje të veprimtarisë për menaxhimin e mbeturinave, gjegjësisht ta refuzon kërkesën për dhënie të lejes për menaxhimin e mbeturinave në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës së kompletuar, duke mos e llogaritur kohën e cila është pritur për marrjen e të dhënave plotësuese gjegjësisht të eliminimit të mangësive sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Nëse organi profesional përcakton se mënyra e kryerjes së veprimtarisë është e papranueshme nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor, pra nëse kryerja e veprimtarisë është në kundërshtim me rregulloret dhe standardet për mjedisin jetësor, si dhe dokumentet dhe projektet strategjike dhe të planifikimit nga fusha e mjedisit jetësor, do të miratojë aktvendim me të cilën do të refuzohet kërkesa për dhënien e lejes për menaxhimin e mbeturinave.

(6) Nëse vjen deri te ndryshimi i kushteve të përcaktuara në leje, subjekti i cili ka leje është i obliguar të dorëzojë kërkesë për ndryshimin e lejes.

(7) Kërkesa për ndryshim të lejes parashtrohet në afat prej dy muaj, nga momenti i ndodhjes së ndryshimeve të paragrafit (6) të këtij neni.

(8) Në procedurën për ndryshim të lejes zbatohen dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me procedurën për dhënie të lejes.

### **Neni 68**

#### **Përrjashtime kur nuk jepet leja**

(1) Në përrjashtim të nenit 64 të këtij ligji, nuk është e nevojshme leje për kryerjen e veprimtarisë të menaxhimit të mbeturinave për veprimtaritë në vijim: :

- ndërrmjetësimi i mbeturinave (ndërrmjetësuesit);
- menaxhimi me lëndë të para sekondare dhe
- përrpunimi i mbeturinave të krijuara në procesin e vet të prodhimit dhe të cilat mund të përrpunohen në të njëjtin proces prodhimi.

(2) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni për kryerjen e veprimtarive sipas paragrafit (1) alineja 1 të këtij neni, janë të detyruar të dorëzojnë njoftim për regjistrim tek organi profesional.

(3) Pas pranimit të njoftimit sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi profesional në afat prej 15 ditësh jep certifikatë për regjistrim dhe e fut personin në regjistrin e nenit 100 të këtij ligji.

## **IX. DEPONITË**

### **Neni 69**

#### **Klasat e deponive**

Sipas llojit të mbeturinave që largohen, deponitë klasifikohen:

- 1) deponi për mbeturina të parrezikshme;
- 2) deponi për mbeturina interne dhe
- 3) deponi për mbeturina të rrezikshme.

### **Neni 70**

#### **Kushtet të cilat duhet ti plotësojë deponia**

(1) Deponia e nenit 69 të këtij ligji mund të ndërtohet dhe lëshohet në përrdorim vetëm nëse nuk shkakton ndikime të rëndësishme negative mbi mjedisin jetësor, si dhe nuk e rrezikon shëndetin e njeriut.

(2) Përr shkak të parandalimit dhe zvogëlimi të ndikimeve të dëmshme të mbeturinave që largohen në deponi mbi mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut, ministri në mënyrë të përrafërt i përrshkruan kriteret të cilat duhet t'i plotësojë deponia, e veçanërisht në lidhje me:

- 1) vend pozitën, gjegjësisht lokacionin e deponisë ;
- 2) kontrollin e ujërave që hyjnë në deponi;
- 3) kontrollin e rrjedhjeve;
- 4) mbrojtjen të tokës dhe ujit nga ndotja;
- 5) kontrollin e gazit që krijohet nga mbeturina e larguar në deponi (gazi i deponisë);
- 6) zvogëlimi i ndikimeve që dalin nga deponia, nëpërrmjet kontrollit të emisioneve të pluhurit, krijimit të aomës dhe zhurmës, kontroll të trafikut kontrolli i asgjësimi të materialeve të dalin nga mbeturinat, si dhe kontroll të zjarreve të shfaqura ose krijimit të aerosolëve;

- 7) stabiliteti i mbeturinës në deponi dhe
- 8) sigurimi fizik i deponisë dhe etiketimi.

## **Neni 71**

### **Themelimi i deponive për mbeturina të parrezikshme**

(1) Deponia për mbeturina të parrezikshme mund të themelohet si:

- deponi rajonale për mbeturina të parrezikshme dhe
- deponi për mbeturina të parrezikshme industriale.

(2) Deponia për mbeturina të parrezikshme sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të themelohet nga:

- personi juridik vendor ose të huaj në pajtim me Ligjin për koncesion dhe partneritet privato-publik, dhe
- dy ose më shumë komuna ose Qytetit i Shkupit të cilat kanë themeluar ndërmarrje publike për shkak të themelimit të deponive rajonale për mbeturina të parrezikshme.

(3) Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit në propozim të kryetarit të Komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut, si dhe për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të miratojnë vendim për themelimin e deponisë rajonale për mbeturina të parrezikshme me sistem rajonal për menaxhimin e mbeturinave ia lënë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të themelon ndërmarrje publike për shkak të themelimit të deponisë rajonale për mbeturina të parrezikshme në raste sipas paragrafit (3) të këtij neni kur komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk do të vendosin sistem rajonal për menaxhimin e mbeturinave në afatin e përcaktuar në nenin 31, paragrafi (7) të këtij ligji.

(5) Në raste të paragrafit (4) të këtij neni, themelimi i deponisë rajonale për mbeturina të parrezikshme, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'ia besojë personit juridik vendor ose të huaj në pajtim me Ligjin e Koncesionit dhe Partneritetit Privato-Publik.

(6) Deponia rajonale për mbeturina të parrezikshme sipas paragrafit (1), nënparagrafi 1 të këtij neni themelohet për shkak të arritjes së menaxhimit rajonal të mbeturinave në pajtim me nenin 31 të këtij ligji dhe në pajtim me Planin rajonal për menaxhimin e mbeturinave.

(7) Deponitë sipas paragrafit (1) nënparagrafi 2 të këtij neni mund të themelohet nga personi juridik krijues i mbeturinës industriale të parrezikshme i cili posedon A-leje për integrim ekologjik, vetëm për largimin e mbeturinës që krijohet nga instalimet e tija

(8) Në deponitë sipas paragrafit (7) të këtij neni nuk guxon të pranohet dhe largohet mbeturinë nga personi juridik tjetër krijues i ndonjë llojit tjetër të mbeturinës së parrezikshme.

(9) Në përjashtim me paragrafin (8) të këtij neni, personi juridik sipas paragrafit (7) të këtij neni mund të kryejë largim të mbeturinave të cilat janë krijuar nga një institucion tjetër në bazë të pëlqimit të dhënë të cilën e jep organi profesional mbi bazë të parimeve të nenit 8 dhe 11 të këtij ligji, me kërkesë të paraqitur nga themeluesi i deponisë sipas paragrafit (7) të këtij neni.

(10) Organi profesional në pajtim me paragrafin (9) të këtij neni e jep ose e refuzon kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për largim të mbeturinave që krijohet nga ndonjë institucion tjetër.

(11) Kërkesa sipas paragrafit (9) të këtij neni detyrimisht duhet të përmbajë të dhëna për llojin, sasinë dhe origjinë e mbeturinës së dedikuar për largim, si dhe kapacitetet teknike të deponisë sipas paragrafit (1) nënparagrafi 2 të këtij neni.

(12) Në shtojcë të kërkesës të paragrafit (1) detyrimisht dorëzohet edhe kontratë për ndërmarrjen e mbeturinave nga personi juridik i cili e ka krijuar mbeturinë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## **Neni 72**

### **Deponi për mbeturina interne**

(1) Komuna ose Qyteti i Shkupit mund të themelojnë ndërmarrje publike për shkak të themelimit të deponisë për mbeturina interne.

(2) Themeluesi i deponisë interne mund të jetë person juridik vendor ose i huaj.

(3) Kërkesa për themelim të deponisë për mbeturina interne të paragrafit (1) të këtij neni mund të parashtrohet ndërmarrja publike ose personi juridik sipas paragrafit (2) të këtij neni në pajtim me nenin 74 të këtij ligji.

### **Neni 73**

#### **Deponi për mbeturinat të rrezikshme**

(1) Deponi për mbeturina të rrezikshme mund të themelon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Në raste sipas paragrafit (1) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të themelon ndërmarrje publike për menaxhim me deponi për mbeturina të rrezikshme.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelimin dhe menaxhimin e deponisë për mbeturina të rrezikshme mund t'ia besojë personit juridik vendor dhe të huaj në pajtim me Ligjin për koncesion dhe partneritet privato-publik.

(4) Kërkesa për themelim të deponisë sipas paragrafit (1) të këtij neni parashtrohet nga ndërmarrja publike sipas paragrafit (2) të këtij neni ose nga personi fizik sipas paragrafit (3) të këtij ligji në pajtim me nenin 74 të këtij ligji.

(5) Deponitë për mbeturina të rrezikshme mund të themelohet nga personi juridik krijues i mbeturinës të rrezikshme i cili në bazë të rregullativave të mjedisit jetësor posedon A-leje për integrim ekologjik në pajtim me nenin 74 të këtij ligji

(6) Kërkesë për themelimin e deponisë për mbeturina të rrezikshme sipas paragrafit (5) të këtij neni dorëzohet deri te organi profesional vetëm për shkak të largimit të mbeturinave të krijuara nga instalimet.

(7) Në deponitë sipas paragrafit (5) të këtij neni nuk guxon të pranohet dhe largohet mbeturinë e rrezikshme ose lloj tjetër i krijuar nga një person tjetër juridik.

(8) Në përjashtim me paragrafin (7) të këtij neni, themeluesi i deponisë sipas paragrafit (5) të këtij neni mund të lejon largimin e mbeturinës së krijuar nga ndonjë instalim tjetër, në bazë të pëlqimit për largim të mbeturinave të rrezikshme industriale të dhënë nga organi profesional, në bazë të parimeve të nenit 8 dhe 11 të këtij ligji, me kërkesë të paraqitur nga themeluesi i deponisë sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(9) Organi profesional në pajtime paragrafin (8) të këtij neni e jep ose e refuzon kërkesen sipas paragrafit (6) në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesë

(10) Kërkesa sipas paragrafit (6) të këtij neni detyrimisht duhet të përmbajë të dhëna për llojin, sasinë dhe origjinë e mbeturinës së dedikuar për largim, si dhe kapacitetet teknike të deponisë.

(11) Në shtojcë të kërkesë të paragrafit (6) detyrimisht dorëzohet edhe kontratë për ndërmarrjen e mbeturinave nga personi juridik i cili e ka krijuar mbeturinën.

### **Neni 74**

#### **Kërkesa për marrjen e lejes për deponi**

(1) Kërkesa për marrjen e lejes për deponi sipas nenit 75 të këtij ligji veçanërisht duhet të përmbajë:

1) titullin e themeluesit të deponisë dhe ekstratin për regjistrim të personit juridik nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ;

2) përfshirjen e rajonit që do të shërbejë deponia numrin e banorëve për të cilët do të sigurohet largimi i mbeturinave, për deponitë të nenit 71, paragrafi (1), pika 1 të këtij ligji.

3) llojin dhe sasinë e mbeturinave me të cilat do të veprojnë në deponi dhe i ky të jetë në përshtatshmëri me klasën dhe kapacitetin e deponisë;

4) teknologjinë që e zbaton në menaxhimin me mbeturina;

5) lokacionin e deponisë, si dhe lokacionet e stacioneve ose objekteve tjera dhe instalimet për menaxhimin e mbeturinave të cilat janë pjesë përbërëse e deponisë rajonale, nëse janë parashikuar për deponitë në nenin 71, paragrafi (1), alineja 1 të këtij ligji;

6) prezantimin e mjeteve financiare të nevojshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e deponisë, me theksim të burimit financues;

7) përshkrimin e mënyrës së menaxhimit të deponisë, si dhe infrastrukturën shoqëruese;

8) aktvendim për miratim të studimit për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor me të cilën kërkohet ndërtim i deponisë, gjegjësisht aktvendim për miratim të elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor, të miratuar në pajtim me Ligjin e Mjedisit Jetësor;

9) pasqyrë të demonstrimit të aftësisë teknike për kryerjen e veprimtarisë;

10) pasqyrë të kapaciteteve organizative dhe menaxhuese që mundësojnë menaxhim të ndërgjegjshëm të deponisë;

11) pasqyrë të kapacitetit përkatës të deponisë me periudhë kohore për të cilën kërkohet leja;

12) llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat duhet të largohen në deponi;

13) të dhëna të tjera që mund të përdoren për të përcaktuar nevojën e themelimit të deponisë.

(2) Kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni deri te organi profesional dorëzohet me shkrim ose në formë elektronike sipas formularit të cilën përmbajtjen dhe formën e përshkruan ministri.

(3) Në kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni bashkëngjiten edhe dokumentet në vijim:

1) programi për punë, monitorim dhe kontroll të punës të deponisë dhe vallë a është në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullativat e miratuara në bazë të këtij ligji;

2) kuadri i kualifikuar përkatës në pajtim me kërkesat e lejes për mbeturina duke përfshirë së paku tre të punësuar me përgatitje profesionale të lartë nga fusha e shkencave teknike nga të cilët minimum një person të posedon vërtetim për menaxhues me mbeturina dhe minimum një person të posedon certifikatë për menaxhua si lartë me mbeturina dispozitat e këtij ligji;

3) programet për aftësimin e vazhdueshëm teknik dhe profesional të personave të punësuar në deponi;

4) planet dhe programet për të shmangur dhe zvogëluar pasojat e aksidenteve;

5) shumën e garancisë bankare me të cilat mund të mbulohen realizimi i detyrimeve të deponisë gjatë kohës së punës, mbylljes dhe kujdesit të mëtutjeshëm pas mbylljes së deponisë ;

6) projekti i deponisë i cili është në pajtueshmëri me planet për menaxhimin e mbeturinave, të miratuar në pajtim me këtë ligj dhe

(4) Në rastet kur themeluesi i deponisë është ndërmarrje publike, statutit të ndërmarrjes publike i bashkëngjitet kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Organi profesional mund, si kusht për dhënien e lejes për deponi për mbeturina jo të rrezikshme të nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafi 1, të kërkojë nga themeluesi të zgjerojë fushën e propozuar të zonës nga ku do të mbledhë mbeturina, në fakt aty të përfshijë edhe një komunë tjetër, si dhe ta zgjerojë veprimtarinë për menaxhimin e mbeturinave, nëse në këtë mënyrë kontribuohet në menaxhim më ekonomik dhe më të mirë të mbeturinave, në pajtim me Planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Planin rajonal për menaxhimin e mbeturinave.

(6) Ministri e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për dhënien e lejes për deponi sipas paragrafit (2) të këtij neni.

## **Neni 75**

### **Leja për deponi**

(1) Që të mund të ndërtohet deponia dhe të fillojë me punë, themeluesi i deponisë duhet të posedojë leje për deponi.

(2) Organi profesional në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës sipas nenit 74 të këtij ligji jep leje ose miraton vendim për refuzim të kërkesës për dhënien e lejes.

(3) Leja sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti duhet të përmbajë:

- titullin e themeluesit;
- titullin e operatorit – menaxhuesit të deponisë nëse është person tjetër nga ai që themelon;
- vëllimin – rajonin që përfshinë deponia (për deponitë të nenit 71, paragrafit 1, pika 1 të këtij ligji);
- llojin dhe sasinë e mbeturinave që do të dërgohen në deponi;
- llojet e teknologjive që do t'i përdor në deponi;
- lartësinë dhe llojin e garancisë për punën e deponisë;
- kapacitetet e nevojshme organizative dhe menaxhuese të deponisë;
- personeli ekipor dhe trajnimi e të punësuarve;



- pajisjet teknike dhe mjetet e funksionimit të deponisë;
- detyrime për kujdesie pas mbylljes si në nenin 85 të këtij ligji;
- afati i vlefshmërisë së lejes dhe
- mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes mbi lejet dhe marrja e tyre.

(4) Leja sipas paragrafit (3) jepet me kohëzgjatje prej dhjetë vitesh, ndërsa kërkesa për ripërtëritjen e lejes parashtrohet së paku gjashtë muaj para kalimit të afatit. Në ripërtëritjen dhe në transferim të lejes për deponi zbatohen dispozitat e këtij neni të cilat kanë të bëjnë me dhënien e lejes.

(5) Që të mund të fillojë punën deponia, themeluesi duhet të sigurojë leje integruar ekologjike në pajtim me rregullativat për mjedisin jetësor.

(6) Kur për deponin është e nevojshme të jepet A-leje integruar ekologjike në pajtim me rregullativat e mjedisit jetësor, leja sipas paragrafit (1) të këtij neni, jepet në procedurë për dhënien e lejes integruar ekologjike si pjesë përbërëse e saj.

(7) Kur për deponinë është e nevojshme të jepet B-leje integruar ekologjike, kërkuesi tek organi profesional detyrimisht dorëzon kërkesë për dhënien e lejes sipas paragrafit (1) të këtij neni në pajtim me dispozitat e këtij neni.

(8) Organi kompetent për dhënie e B- lejes integruar ekologjike, detyrimet e lejes për deponi në paragrafin (3) të këtij neni detyrimisht duhet të shënohen në B- lejen integruar ekologjike dhe për këtë e informon organi profesional .

(9) Para se deponia të fillojë me deponiminë e mbeturinave, organi profesional patjetër të bëjë këqyrje të deponisë dhe të sigurohet se është në pajtim me kushtet relevante të lejes për deponi.

(10) Kundër këtij aktvendimit sipas paragrafit (2) të këtij neni, kërkuesi mund të parashtrojë ankesë në pajtim me rregullativat për procedurë të përgjithshme administrative.

(11) Ministri i përcakton kushtet në raport me mjetet dhe pajisjet teknike për kryerjen e veprimtarisë për deponim të mbeturinave, kushtet dhe mënyra e trajnimit dhe programet e trajnimit për të punësuarit.

(12) Ministri e përcakton formën dhe përmbajtjen e lejes sipas paragrafit (2) të këtij neni.

## **Neni 76**

### **Garancia financiare**

(1) Kur themeluesi i deponisë nuk është në gjendje t'i mbulojë shpenzimet e punës, mirëmbajtjes, përcjelljes dhe kontrollin e deponisë në fazën operative dhe në fazën e mbylljes dhe kujdesin pas mbylljes, shpenzimet do i mbulojë me:

- garanci financiare e përcaktuar në kontratën e lidhur në procedurë në pajtim me Ligjin e Koncesimit dhe Partneritetit Privato-Publik ose
- garanci financiare të bashkëngjitur në pajtim me nenin 74, paragrafi (3), pika 5 të këtij ligji.

(2) Afati për të cilën lidhet kontratë sipas paragrafit (1), nënparagrafi 1 të këtij neni në vetvete e përfshin edhe kohën e nevojshme për ndërtim, punën dhe kujdeset të deponisë pas mbylljes së saj.

(3) Nëse kontratë sipas paragrafit (1), nënparagrafi 1, të këtij neni prishet para kalimit të afatit nga cilado palë qoftë, mjetet për mbulim të shpenzimeve në pajtim me kontratën sigurohen nga garancia financiare.

## **Neni 77**

### **Shpenzimet e themeluesit të deponisë**

(1) Organi i mjedisit jetësor në propozim të organit profesional ndërmerr masa përkatëse për sigurim të të gjitha shpenzimet të cilat janë të përfshira në formimin dhe në punën e një deponie, duke i përfshirë edhe shpenzimet e garancisë financiare, si dhe përqindjet e shpenzimeve për mbyllje dhe kujdesit të mëtutjeshëm të lokacionit pas mbylljes së saj, për periudhën më së paku 30 vjet, gjegjësisht tre vjet në rast të deponive interne.

(2) Shpenzimet sipas paragrafit (1) të këtij neni i siguron themeluesi i deponisë, ndërsa i miraton organi profesional, me qëllim që të sigurohet se detyrimet, duke përfshirë edhe dispozitat për kujdesje pas mbylljes, të cilat dalin nga leja janë të plotësuara.

(3) Ky garancion financiar ka të bëjë për periudhë kohore e nevojshme për mirëmbajtjen dhe kujdesjen e lokacionit në pajtim me nenin 85 të këtij ligji .

(4) Për deponitë me mbeturina të rrezikshme dhe të parrezikshme, në përlogaritjen e shpenzimeve për mbylljes dhe kujdes detyrimisht përfshihen edhe shpenzimet e nevojshme për:

- monitorim të mjedisit jetësor;
- mbulim të deponisë;
- mirëmbajtje të deponisë;
- menaxhim të rrjedhave të deponisë,
- menaxhim me gazin e deponisë;
- menaxhim me hapësirat ujore;
- sigurinë (për shembull, portë dhe gardh) dhe
- përpilim të raportit për lokacionin (nëse nuk është përfshirë monitorimi)

(5) Për deponitë e mbeturinave interne, në përlogaritjen e shpenzimeve për mbyllje dhe kujdes, përfshihen edhe shpenzimet për mbyllje dhe kompensim për:

- mbulim të deponisë;
- monitorim të mjedisit jetësor;
- menxhim me hapësirat ujore;
- siguria nga personat e paautorizuar dhe
- përpilim të raportit për lokacionin (nëse nuk është përfshirë monitorimi)

(6) Garancia financiare duhet të jetë e mjaftueshme për mbulimin e të gjithave detyrimeve të lejës, të siguruara gjatë kohëzgjatjes së lejës, duke përfshirë edhe kujdesin pas mbylljes së deponisë.

(7) Garancia financiare përbëhet ekskluzivisht nga një sasi të caktuar të mjeteve në para.

(8) Lartësia e garancisë financiare mund të sigurohet si paushall ose në mënyrë shkallore në varësi të shumës për ton të mbeturinave të deponuara dhe të paguhet në llogari të hapur adekuate për këtë dedikim të organit të administratës shtetërore e cila është kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor.

(9) Lartësinë e garancisë financiare e propozon parashtruesi i kërkesës për marrje të lejës sipas nenit 74 të këtij ligji, me qëllim të sigurohet dëshmi se janë plotësuar kushtet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(10) Mjetet e garancisë financiare me vendim nga organi i administratës shtetërore e cila është kompetent për punë të fushës së mjedisit jetësor, mund ti kthehen themeluesit pas skadimit të kohëzgjatjes së lejës, por jo para mbarimit të periudhës për kujdes të deponisë pas mbylljes së saj.

## **Neni 78**

### **Mbeturina e cila nuk është e pranueshme në deponitë**

Në deponitë e mbeturinave ndalohet të deponohet:

1) mbeturina të lëngshme;

2) mbeturina të cilat në kushte të deponimit është:

- „korrozive“ - nëse përbëhet nga substancat dhe preparate të cilat mund të shkatërrojnë indet e gjalla gjatë kontaktit;

- „eksplozive“ - nëse përbëhet nga substanca dhe preparate që mund të shpërthejnë nën veprimin e një flake ose që janë më të ndjeshëm ndaj goditjeve të temperaturës ose fërkimeve nga dinitrobenzeni;

- „i ndezshëm“ - nëse përbëhet nga substanca të lëngshme dhe preparate me një pikë flakërimi të barabartë ose më të madhe se 21 °C dhe më të vogël ose të barabartë me 55 °C;

- „oksidues“ - nëse përbëhet nga substanca dhe preparate që shfaqin reaksione të larta ekzotermike kur janë në kontakt me substanca të tjera, veçanërisht me substanca të ndezshme, dhe

- “ndezshmëria e lartë”, nëse përbëhen nga:

(a) substancat dhe preparatet e lëngshme me pikë ndezje nën 21 °C (duke përfshirë edhe lëngjet ekstreme);

(b) substancat dhe preparatet të cilat mund të nxehen dhe përfundimisht të ndizen në kontakt me ajrin në temperaturën e dhomës pa aplikimin e energjisë

(c) substancat dhe preparatet e ngurta të cilat lehtë mund të ndizen në kontakt të shkurtë me burim ndezës dhe vazhdojnë të ndizen ose të konsumohen edhe pas largimi të burimit ndezës;

(ç) substancat dhe preparatet e gazit të cilat janë të ndezshme në ajër gjatë presionit normal; ose

(d) substancat dhe preparatet të cilat në kontakt me ujin ose me ajrin e lëngshëm, krijojnë gaze ndezëse në sasi të rrezikshme.

3) mbeturina mjekësore dhe klinike, të cilat rrjedhin nga institucionet mjekësore dhe veterinarë, i cili është infektues, gjegjësisht përbëhet nga substanca të cilat përmbajnë mikroorganizma ose toksinat e tyre dije ose besohet se shkaktojnë sëmundje te njerëzit ose te ndonjë organizëm tjetër i gjallë;

4) mbeturina e krijuar si rezultat i hulumtimit shkencor, i cili është i ri dhe nuk mund të identifikohet, ndërsa vetitë e saj mund ta ndotin mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut;

5) goma të plota të përdorura, përveç gomave të përdorura për material makinerik në inxhinieri dhe goma të copëtuara të përdorura, me përjashtim të gomave të biçikletave dhe gomave të aeroplanëve;

6) mbeturinë e cila është e përzier me substancë tjetër, me qëllim të plotësimit të kriterëve për pranim të mbeturinave në deponi dhe

7) mbeturinat që përmbajnë një përqindje të lartë të përbërësve të biodegradueshëm (të tilla si letra, mbeturinat e kopshtit, etj.)

## **Neni 79**

### **Largimi i mbeturinave të cilat nuk janë të pranueshme në deponi**

(1) Operacionet për largimin e mbeturinave duhet të zbatohen në mënyrë përkatëse, në bazë të llojit dhe karakteristikave të mbeturinave që largohen me qëllim që të sigurohet mbrojtje të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

(2) Largimi i mbeturinave që nuk është e pranueshme në deponitë do të kryhet me zbatimin përkatës të operacioneve të shënuara në nenin 44 të këtij ligji .

(3) Largimi i mbeturinave që nuk janë të pranueshme në deponi në pajtim me nenin 78 të këtij ligji, mund të kryhet si përjashtim, vetëm në raste të caktuara kur nuk ka ndonjë mundësi tjetër për menaxhim të duhur të mbeturinave dhe pas pëlqimit të lëshuar nga organi profesional.

(4) Pëlqimi sipas paragrafit (3) lëshohet pas kërkesës së dorëzuar me shkrim me arsyetim të nevojës për largim të mbeturinës sipas nenit 78 të këtij ligji nga ana e operatorit të deponisë.

(5) Ministri përshkruan sasinë e përbërësve të biodegradueshëm në mbeturinat që mund të deponohen.

## **Neni 80**

### **Pranimi i mbeturinave në klasa të ndryshme në deponitë**

(1) Ndalohet largimi i mbeturinave në klasa jopërkatëse në deponi, si dhe largimi i mbeturinave i cili nuk është i shtruar trajtimit.

(2) Është e ndaluar të hollohet një përzierje të mbeturinave në mënyrë që të përmbushë kriteret për mbeturina që do të pranohen në deponi.

(3) Deponitë për mbeturina interne do të përdoren për deponimin e mbeturinave interne .

(4) Në përjashtim, organi profesional mund të lejon mbeturinat interne të largohen në deponitë për mbeturina të parrezikshme, nëse trajtimi dhe përpunimi i tij është teknikisht i pamundshëm dhe ekonomikisht i papagueshëm .

(5) Deponitë për mbeturina të parrezikshme mund të përdoret për:

1) mbeturina komunale;

2) mbeturinë e parrezikshme nga çfarëdo lloj origjine, i cili i plotëson kriteret për pranim në deponi për mbeturinë të parrezikshme; dhe

3) stabil, mbeturinë joreaktive e rrezikshme (për shembull të ngurtësuar, mbeturinat e shndërruara në skorje), me karakteristikat e të njëjta të atyre mbeturinave të parrezikshme të përmendura në pikën 2) të këtij neni, të cilat i plotësojnë kriteret për pranim, me kusht mos të deponohen në qeli të dedikuara për mbeturina biodegraduese të parrezikshme dhe pas marrjes së pëlqimit nga organi profesional.

(6) Stabil, mbeturinë joreaktive e rrezikshme sipas paragrafit (5), pika 3) të këtij neni është mbeturinë e rrezikshme karakteristikat e të cilit nuk kanë ndikim afatgjatë dhe të dukshëm dhe të shkaktojnë ndryshim të kushteve të projektuara në deponitë ose të paraqesin rrezik për shkakimin e fatkeqësive, për shkak të ndryshimeve të shkaktuara nga:

(a) dekompozimi (zbërthimi) i vetë mbeturinave (për shembull nga biodegradimi);

(b) nën efektet afatgjata të kushteve të motit (p.sh. uji, ajri, temperatura, kushtet mekanike); ose

(c) nën ndikimin e mbeturinave tjera (duke përfshirë produkte mbeturina siç janë ekstraktet ose gazi).

(7) Mbeturina e cila në listën e llojeve të mbeturinave është shënuar si i rrezikshëm, deponohet vetëm në deponitë për mbeturina të rrezikshme .

(8) Mbeturinat e rrezikshme të cilat pas trajtimit fizik dhe kimik nuk reagojnë me llojet e tjera të mbeturinave mund të deponohen me pëlqim të veçantë nga organi profesional.

(9) Ministri do i përshkruaj kriteret për pranim të mbeturinave në deponi për secilën klasë, procedura përgatitore për pranimin e mbeturinave, procedurat e përgjithshme testuese, marrja e mostrave dhe pranimi i mbeturinave.

### **Neni 81**

#### **Tarifa për deponim**

Tarifa për deponim të mbeturinave e përcakton Komisioni Rregullator për energjetik dhe shërbime ujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni Rregullator) me Rregulloren për përcaktimin e tarifave të shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale.

### **Neni 82**

#### **Taksa për deponim të mbeturinave**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në propozim të ministrit i cili udhëheqë me organin e administratës shtetërore kompetent për punët të fushës së financimit mund të shënojë taksa për deponim të mbeturinave me qëllim të arritjes së objektivës së hierarkisë së mbeturinave.

(2) Taksa për deponim përcaktohet në ton të mbeturinave dhe e njëjta mund të jetë e ndryshme për lloje të ndryshme të deponive në pajtim me nenin 69 të këtij ligji.

(3) Lartësia e taksës për deponim mund të revidohet në nivel vjetor, dhe e njëjta shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" më së voni deri në muajin nëntor të vitit aktual për vitin e ardhshëm .

(4) Taksa sipas paragrafit (1) të këtij neni, themeluesi i deponisë do ta paguajë në llogari të veçantë hyrëse të organit të mjedisit jetësor, ndërsa mjetet do të përdoren për financimin e aktiviteteve për menaxhimin e mbeturinave të cilat në pajtim me hierarkinë e mbeturinave të nenit 14 të këtij ligji, gjendet në pozicion më të lartë se largimi i mbeturinave.

### **Neni 83**

#### **Detyrimi për ndjekje dhe për njoftim të organeve kompetente**

(1) Themeluesi i deponisë, është i obliguar t'i zbatojë planet e neneve 23, 24 dhe 25 të këtij ligji, si dhe të bën monitorim dhe kontroll të ndikimit të deponisë në mjedisin jetësor.

(2) Themeluesi është i obliguar me shkrim ta njofton organi profesional për të gjitha ndikimet e rëndësishme negative në mjedisin jetësor, të përcaktuar me zbatimin e procedurave të kontrollës dhe ndjekjes.

(3) Kontroll të procedurave dhe metodave analitike të përdorura nga themeluesi i deponisë gjatë kryerjes së analizës së vetive fiziko-kimike të mbeturinave kryhet nga personat juridikë të akredituar në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(4) Ministri e përshkruan mënyrën dhe procedurën e punës, monitorimit dhe kontrollit të deponisë gjatë kohës së punës, si dhe monitorimi dhe kontrolli i deponisë në fazën e mbylljes dhe kujdesi i mëtejshëm i deponisë edhe pas mbylljes.

## **Neni 84**

### **Ndërprerja e punës së deponisë**

(1) Deponia ose pjesë e saj ndalon të punuarit:

1) me aktvendim nga organi profesional, mbi bazë të kërkesës së dorëzuar për mbyllje të deponisë nga ana e themeluesit dhe

2) me aktvendim nga organi profesional, kur është vërtetuar se puna e mëtejshme e deponisë ose pjesë të saj paraqet rrezik për mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(2) Aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti i përmban aktivitetet dhe masat të cilat themeluesi i deponisë duhet ti ndërmerr dhe afatin kohor për ndërprerje të punës.

(3) Organi profesional në bazë të kërkesës sipas paragrafit (1), pika 1) e këtij neni mund ta refuzon kërkesën për mbyllje të deponisë nëse vërteton se nuk janë plotësuar kushtet për mbyllje të deponisë ose pjesë së saj të shënuara në leje, gjegjësisht paraqet rrezik për mjedin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut.

(4) Kërkesa sipas paragrafit (1), pika 1) të këtij neni përmban arsyetim pse themeluesi i deponisë kërkon mbyllje të deponisë.

(5) Organi profesional mund të mos pranohet në tërësi ose pjesërisht mbyllje të deponisë, ose të shfuqizojë në tërësi ose pjesë të lejes për themelimin dhe veprim të deponisë, derisa mendon se deponia ose pjesë relevante e saj mund të shkaktojë rrezik ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

## **Neni 85**

### **Mbyllja dhe kujdesi pasi që deponia të ndalon punën e saj**

(1) Organi profesional me aktvendim e konstaton mbylljen e deponisë kur janë plotësuar kushtet dhe afatet për mbyllje të shënuara në lejen e deponisë .

(2) Deponia ose pjesë të saj llogaritet se kanë ndaluar punën, vetëm atëherë kur organi profesional ka kryer këqyrjen (kontrollin) e fundit në vend ngjarje, i ka vlerësuar të gjitha raportet e dorëzuara nga ana e themeluesit dhe i ka dorëzuar aktvendim për ndërprerje të punës së deponisë ose pjesë të saj .

(3) Pas ndërprerjes me punë të deponisë ose pjesë të saj, themeluesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e saj, monitorimit dhe kontrollin në fazën e mëtejme të kujdesit të deponisë, në pajtim me afatin e përcaktuar në lejen për deponinë.

(4) Themeluesi i deponisë është i obliguar ta monitorojë dhe analizojë sasinë dhe gjendjen e gazit që lirohet në deponi dhe rrjedhave të deponisë, gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe ta monitorojë përmbushjen e kushteve dhe mënyrave të mbylljes së deponisë në pajtim me paragrafi (6) të këtij neni dhe lejes së deponisë.

(5) Themeluesi i deponisë është i detyruar ta njoftojë organi profesional për të gjitha ndikimet e rëndësishme negative mbi mjedisin jetësor, të zbuluara me procedurën e kontrollës dhe monitorimit.

(6) Organi profesional është i detyruar, për shkak të ikjes së mundësisë që deponia të paraqet rrezik potencial për mjedisin jetësor, të kryen vlerësim të gjendjes aktuale të deponisë në aspekt teknik dhe administrativ, si dhe shkalla e mbushjes së deponisë, dhe ti japë udhëzime themeluesit për ndërmarrjen e masave konkrete, për të cilat themeluesi e njofton organi profesional.

(7) Organi kompetent do ta kthejë garancinë financiare themeluesit të deponisë, në pagesa të njëpasnjëshme ashtu siç është e kontraktuar në kushtet e lejes, me qëllim të mundësojë procedura e kujdesjes pas mbylljes së deponisë të zbatohet kohëzgjatje të periudhës për kujdes pas mbylljes.

(8) Ministri e përshkruan mënyrën dhe kushtet e kujdesit të deponisë pasi që ata do ndalojnë punën e tyre.

## **Neni 86**

### **Mosplotësimi i detyrimeve nga operatori i sistemit rajonal**

(1) Në raste kur personi juridikë i cili operon me sistemin rajonal nuk i plotëson kushtet e objektivave të përcaktuara në planin rajonal të nenit 24 të këtij ligji në periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, dhe, me këtë çrregullohen objektivat e menaxhimit të mbeturinave të përcaktuar me

Plani për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe nuk i plotëson detyrimet e përcaktuara ligjore në lejen e nenit 75, në periudhë më të gjatë se tre muaj, ministri miraton aktvendim për vendosje nën administrim të përkohshëm detyrues (sekuestro) mbi sistemin rajonal. (2) Aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni veçanërisht përmban:

1) arsyet pse operatori i sistemit rajonal vendoset nën administrim të përkohshëm detyrues;

2) personi juridik i cili do kryen administrimin e përkohshëm detyrues;

3) afati në të cilën do të kryhet administrimi i përkohshëm detyrues dhe

4) kushtet e administrimit të përkohshëm detyrues de mënyra e punës.

(3) Administrimin e përkohshëm detyrues sipas paragrafit (1) të këtij neni mund ta kryejë personi juridik i autorizuar i organit të mjedisit jetësor.

(4) Personi sipas paragrafit (3) të këtij neni përgjigjet për aktet dhe veprimtaritë e ndërmarra për kohëzgjatjen e administrimit të përkohshëm detyrues.

(5) Kundër aktvendimit të paragrafit (1) të këtij neni personi juridik i cili operon me sistemin rajonal, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit të paragrafit (1) të këtij ligji, ka të drejtë të dorëzon ankesë në pajtim me rregullativat për procedurë të përgjithshme administrative.

(6) Ankesa nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.

(7) Pas skadimit të afatit të përcaktuar me aktvendim sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi për mjedis jetësor miraton aktvendim me të cilën shfuqizohet aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(8) Personi juridik sipas paragrafit (3) i cili minimum duhet ti plotësojë kushtet në vijim:

- ti posedon kapacitetet e nevojshme organizative dhe menaxhuese për kryerjen e veprimtarisë për largim të mbeturinave;
- të ketë të punësuar së paku një menaxhues të lartë;
- të posedon ekip kuadro dhe të punësuar të trajnuar
- pajisja teknike dhe mjete për punë në deponi.

(9) Ministri në mënyrë të përafërt i përshkruan kërkesat sipas paragrafit (9) të këtij neni të cilat duhet të plotësohen nga personi juridik sipas paragrafit (3) të këtij neni, si dhe mënyra e përzgjedhjes së personit juridik i cili do të kryejë administrim detyrues.

(10) Organi i mjedisit jetësor i shënon në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe aktvendimin sipas paragrafit (7) të këtij neni.

## **X. DJEGIA E MBETURINAVE**

### **Neni 87**

#### **Rregullat për djegie të mbeturinave**

(1) Largimi i mbeturinave nëpërmjet djegie kryet me instalimet posaçërisht të dizajnuara, në varësi të llojit të mbeturinave.

(2) Instalimet e djegies, duke përfshirë të gjitha pajisjet ndihmëse përgatitore dhe aparatura shërbyese, pajisjet dhe aparatet të cilat janë në funksionim të pajisjes dhe aparatit për djegie, duhet të dizajnohen dhe të punojnë në mënyrë të tillë që të parandalojnë tejkalimet vlerave kufitare të ndotësve të lëshuar në ajër, toka dhe uji, lëshimi i zhurmës dhe aromës, si dhe të sigurohet mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

(3) Nëse instalimi i djegies nuk funksionon në përputhje me kushtet e specifikuar në leje, përfshirë vlerat kufitare të emisioneve në ajër, ujë dhe tokë, organi i mjedisit jetësor/organi profesional mund t'ia merr lejen për punë të stacionit dhe t'ia ndalojë kryerjen e veprimtarisë .

(4) Ministri përshkruan vlerat kufitare për emisionet e substancave të caktuara në ajër gjatë djegies së mbeturinave, vlerat kufitare për emisionet gjatë hedhjes së mbeturinave ujore nga pastrimi i gazrave, teknikat, metodat dhe dinamikat për matjen dhe monitorimin e emisioneve të substancave në ajër dhe ujë të krijuara gjatë djegies së mbeturinave, si dhe mënyrën dhe afatet kohore për arritjen e vlerave kufitare të emisioneve të substancave në ajër dhe në ujë.

## **Neni 88**

### **Përzgjedhja e lokacionit për ndërtim të impianteve për djegie**

Gjatë përzgjedhjes së lokacionit për ndërtim të impianteve për djegie, veçanërisht mbahet llogari për:

- 1) karakteristikat klimatike të rajonit;
- 2) karakteristikat gjeologjike, hidrologjike, hidrogjeologjike, topografike, sizmologjike dhe pedologjike të tokës;
- 3) rrjedha e erërave rreth rajonit ku do të ndërtohet stacioni dhe
- 4) afërsia me vendet e banimit, pra rajoni mbrojtës.

## **Neni 89**

### **Lejet për punë të impianteve për djegie të mbeturinave**

(1) Personat të cilët menaxhojnë me instalime për djegie të mbeturinave (në tekstin e mëtutjeshëm: operatori i impianteve) janë të obliguar të posedojnë leje të integruar ekologjike për punë të stacionit, të dhënë në pajtim me Ligjin e Mjedisit Jetësor.

(2) Gjatë dhënies së lejes së integruar ekologjike organi i mjedisit jetësor/organi profesional detyrimisht përcakton nëse:

- 1) janë plotësuar kërkesat minimale teknike në lidhje me pajisjet, kuadrin dhe hapësirën e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë;
- 2) lloji dhe sasia e mbeturinave të cilat duhet të shkatërrohet në instalimin për djegie e përputhet me klasën dhe kapacitetin e impiantit për djegie;
- 3) lartësia dhe lloji i garancisë me të cilën sigurohet kompensim të dëmit mbi mjedisin jetësor nga kryerja e veprimtarisë;
- 4) lartësia dhe lloji i garancisë me të cilën sigurohet kujdesi pas mbylljes, gjegjësisht ndërprerjes me kryerjen e veprimtarisë dhe
- 5) është përpiluar program për punë, monitorim dhe kontroll të punës së instalimit për djegie në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor
- 6) djegia ose djegia e kombinuar me ripërtëritjen e energjisë e cila ripërtërije e tillë e energjisë të bëhet me nivel të lartë të efikasitetit energjetik.

(3) Ministri në mënyrë të përafërt i përshkruan kushtet dhe mënyrën e punës së impianteve për djegie të mbeturinave, si dhe kërkesat teknike minimale të pajisjeve për djegie të mbeturinave.

## **Neni 90**

### **Porositje dhe pranim të mbeturinave për djegie**

(1) Para djegies së mbeturinave, operatori i instalimit është i detyruar të krahasojë mbeturinat që i pranon me të dhënat e shënuara në formularin e identifikimit, me marrjen e mostrës për shkak të përcaktimit të:

- 1) llojit dhe sasisë së mbeturinave që do t'i nënshtrohen djegies;
- 2) karakteristikat e mbeturinave;
- 3) përshtatshmëria e mbeturinave për djegie;
- 4) mbeturina me të cilat nuk duhet të përzihen, përkatësisht përcaktimi nëse mbeturinat janë të përziera me mbeturina të tjera dhe
- 5) saktësinë e të dhënave nga formulari i identifikimit, me marrjen e mostrave nga mbeturinat.

(2) Operatori i instalimit është i detyruar të refuzojë djegien e mbeturinave, nëse lloji i mbeturinave nuk korrespondon me kushtet e lejes së integruar mjedisor.

(3) Operatori i instalimit është i detyruar të ruajë mostrat nga testimet e kryera sipas paragrafit (1) të këtij neni të paktën një muaj pas djegies së mbeturinave.

## **Neni 91**

## **Veprimi me mbetjet e djegies**

(1) Pas djegies së mbeturinave, operatori i instalimit është i detyruar:

1. të minimizojë sasinë dhe dëmshmërinë e mbetjeve që dalin nga funksionimi i impianteve të djegies së mbeturinave;
2. të përcaktojë karakteristikat e mbeturinave të marra për djegie, duke i përfshirë edhe fraksionet e metaleve të rënda;
3. të mbledhë hirin e fituar si rezultat i djegies në kontejnerë të mbyllura dhe
4. të sigurojë transportin e sigurt të mbeturina të marra për djegie, e cila nuk mund të përpunohet deri në vendin e tij të largimit.

(2) Kur është e përshtatshme dhe teknikisht e realizueshme, mbetjet e djegies duhet të riciklohen direkt në ose jashtë instalimit në përputhje me ligjin ose rregulloret e tjera.

## **XI. IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI I MBETURINAVE PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

### **Neni 92**

Lëvizja ndërkuftare e mbeturinave

lëvizja ndërkuftare e mbeturinave përfshinë importin e mbeturinave me origjinë nga një vend i huaj në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, eksport të mbeturinave nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut në një vend tjetër të huaj dhe transit të mbeturinave nëpërmjet territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 93**

#### **Importi i mbeturinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

(1) Ndalohet importi i mbeturinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ruajtje për shkak të largimit dhe për largim.

(2) Ndalohet importi i mbeturinave nga stacionet e menaxhimit të mbeturinave, stacionet për përpunimin e ujit të mbetur dhe për përgatitjen e ujit për pirje dhe ujit për përdorim industrial në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfshirë në listën të llojeve të mbeturinave në nenin 15, paragrafi (2) të këtij ligji, me përjashtim të mbeturinave nga thërrmimet e mbeturinave që përmbajnë metale (mbeturinat nga hekuri dhe çeliku dhe mbeturinat nga metalet me ngjyra) dhe mbeturinat nga përpunimi mekanik i mbeturinave të letrës dhe kartonit, plastikës, gomës, qelqit.

(3) Lejohet import i mbeturinave në pajtim me nenin 96 të këtij ligji i cili nuk paraqet rrezik për ndotjen e mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut:

- 1) përsëri të përdoret për të njëjtin dedikim;
- 2) të përpunohet ose të riciklohet.

### **Neni 94**

#### **Eksporti dhe transiti i mbeturinave**

(1) Lejohet eksportimi i mbeturinave në pajtim me nenin 96 të këtij ligji, të cilat mund të përpunohen dhe asgjësohen pa ndonjë rrezik për mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve në vendin e importit.

(2) Lejohet transitimi i mbeturinave nëpër Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 96 të këtij ligji pa ndonjë rrezik për mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të vendit të importit.



## **Neni 95**

### **Importi, eksporti dhe transiti i mbeturinave të rrezikshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Importi, eksporti dhe transiti i mbeturinave të rrezikshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryer në pajtim me Konventën e Bazelit për kontroll të transferimit ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme dhe ruajtja e tyre.

## **Neni 96**

### **Lejet dhe pëlqimet për eksport, import dhe transit të mbeturinave**

(1) Eksporti, importi dhe transiti i dërgesave me mbeturina në pajtim me llojin dhe regjimin e kontrollit të mbeturinave kryet në bazë të procedurave të informacioneve të përgjithshme dhe dhënia e pëlqimit ose në bazë të njoftimit paraprak me shkrim dhe dhënia e lejes, të cilat i jep organi profesional.

(2) Lënda e procedurës me njoftim paraprak me shkrim dhe dhënia e lejes së paragrafit (1) të këtij neni janë dërgesat me lloje në vijim të mbeturinave:

- të gjitha llojet e mbeturinave, nëse dërgesat e mbeturinat janë të dedikuar për largimin e saj (për eksport dhe transit të mbeturinave),
- llojet e mbeturinave të cilat janë të dedikuar për përpunim, ndërsa janë të përcaktuara në listën e verdhë, si dhe dërgesa e mbeturinave të përziera komunale të mbledhura nga amvisëritë ose prodhuesit tjerë, të dedikuar për instalime të përpunimit ose shkatërrimit.

(3) Lënda e procedurës së informacioneve të përgjithshme dhe dhënia e pëlqimit të parafit (1) të këtij neni janë dërgesat e mbeturinave me sasi mbi 25 kilogram i cili është i dedikuar për përpunim edhe atë:

1. për llojet e mbeturinave të cilat janë të përcaktuara në listën e gjelbër;
2. për përzierje të dy ose më shumë lloje të mbeturinave të listës së gjelbër, nëse përbërja e kësaj përzierje lejon përpunimin e saj në mënyrë të përshtatshme për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe
3. për dërgesat e mbeturinave në sasi deri 25 kilogram të dedikuar vetëm për analiza laboratorike për vlerësimin e karakteristikave fizike dhe kimike të mbeturinave ose me qëllim të përcaktimit të përshtatshmërisë së përpunimit të saj ose largimit.

(4) Importi i mbeturinave mund të aprovohet vetëm personit juridik që importon mbeturina për shkak të përpunim ose riciklim dhe për këtë ka leje për menaxhim të mbeturinave në pajtim me nenin 64, paragrafi (1), pika 3), të këtij ligji, ose ka lidhur një marrëveshje për përpunim ose riciklimin e mbeturinave me një person i cili posedon një leje për menaxhim të mbeturinave në pajtim me nenin 64, paragrafi (1), pika 3), të këtij ligji, ose ka leje për integrim ekologjik të dhënë në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor kur mbeturina përdoret për përpunim dhe riciklim në pajtim me lejen për integrim ekologjik.

(5) Leja sipas paragrafit (2) të këtij neni jepet me kërkesë paraprake për import, gjegjësisht eksport ose transit të mbeturinave deri te organi profesional, e cila duhet në veçanti të përmban:

- 1) emrin, mbiemrin dhe selinë e personit juridik i cili kërkon import, eksport ose transit të mbeturinave;
- 2) arsye të kërkesës për eksport ose import të mbeturinave;
- 3) të dhënat e origjinës së mbeturinës e cila importohet ose eksportohet;
- 4) të dhënat e sasisë dhe llojit të mbeturinës që është lëndë e lejes në pajtim me Listën për llojet e mbeturinave;
- 5) të dhënat e numrit tarifor të mbeturinës, mënyra e transportimit dhe mënyra e paketimit të mbeturinës dhe
- 6) informacione për hyrje, dalje dhe skema e rrugës së transferimit të mbeturinës.

(6) Në kërkesën sipas paragrafit (5) të këtij neni kërkuar është i obliguar të bashkëngjij:

- 1) kontratë në mes palëve të cilat marrin pjesë në eksport, import ose transit të mbeturinave (importuesi, eksportuesi ose personi i cili kërkon transit të mbeturinave);

2) dëshmi se posedon leje për menaxhimin e mbeturinaveve, gjegjësisht posedon leje për integrim ekologjik të dhënë në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor (vetëm gjatë importit)

3) marrëveshja ndërmjet importuesit dhe përpunuesit, nëse ato janë të ndryshme dhe

4) dëshmi për garancinë bankare ose e sigurimit të duhur në shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të transportit, përpunimit ose largimit, duke përfshirë edhe operacionet e nevojshme të përkohshme për ruajtje në kohëzgjatje prej 90 ditësh.

(7) Për dërgesat e mbeturinave sipas paragrafit (2) të këtij neni për të cilat kryhet një procedurë e njoftimit me shkrim, kërkuesi është i detyruar në formular të veçantë të dorëzojë njoftim paraprakë me shkrim deri te organi profesional nëpërmjet organit të mjedisit jetësor, si dhe deri te organi kompetent në vendin e dërgimit gjegjësisht pranimit, si dhe deri te vendet në cilat dërgesa e mbeturinave do të kalojë.

(8) Për dërgesën e mbeturinave sipas paragrafit (3) të këtij neni për të cilat zhvillohet një procedurë e informacionit të përgjithshëm dhe dhënia e pëlqimit, kërkuesi është i detyruar në formular të veçantë të dorëzon informacione të përgjithshme deri te organi profesional. Formulari duhet të shoqërojë dërgesën gjatë transportit të mbeturinave për të cilën bëhet fjalë.

(9) Organi profesional ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë për dërgesën e mbeturinave në lidhje me ndikimin e mbeturinave në mjedis jetësor, mënyrën dhe vendin e krijimit, deponimit dhe përpunimit të tyre ose qëllimin e mbeturinave, nëse vlerëson se të dhënat e deklaruara në njoftimin me shkrim dhe informacionin e përgjithshëm të dhënë, si dhe në kërkesën për leje, nuk janë të mjaftueshme për të miratuar eksportin, importin ose tranzitimin.

(10) Në raste e përcaktuara në paragrafin (4) të këtij neni, organi profesional mund të lejon përpunimin ose riciklimin e mbeturinave në instalimet në periudhë dhe sasi për të cilën vlen leja e integruar ekologjike gjegjësisht leja për menaxhimin e mbeturinave .

(11) Ministri e përshkruan mënyrë e lejes për eksport, import dhe transit; llojet e mbeturinave të paragrafit (1) të këtij neni në pajtim me regjimin e kontrollit të mbeturinave – lista e verdh dhe e gjelbër, forma dhe përmbajtja e formularëve të paragrafit (7) dhe (8) të këtij neni dhe mënyra e menaxhimit me të njëjtat, mënyra e përcaktimit dhe mënyra e aktivizimit dhe përlllogaritjes së garancisë bankare, gjegjësisht sigurim përkatëse, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së lejes të paragrafit (10) të këtij neni, si dhe mënyrën e mbikëqyrjes së eksportit, importit dhe transitit të mbeturinave.

(12) Ministri e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të lejes për eksport dhe import të mbeturinave.

(13) Në procedurat për njoftim me shkrim dhe procedurat për informacione të përgjithshme kur do të marrë vërtetim për pranim të njoftimit nga ana e organit kompetent të shtetit të tretë për pranim të dërgesës së mbeturinave për eksport ose transit në/nëpërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut, organi profesional është i detyruar në afat prej 30 ditësh të japë pëlqim ose ankesë me shkrimi në lidhje me dërgesën e mbeturinave edhe atë si:

1. pëlqim i pakushtëzuar;
2. pëlqim i kushtëzuar ose
3. ankesë ndaj pëlqimit.

(14) Organi profesional në rast të transitit të dërgesave të mbeturinave mund të japë pëlqim për dërgesën, nëse nuk merre pëlqim të kushtëzuar ose ankesë nga ana e organit kompetent për transit të shtetit tjetër, në afat prej 30 ditsh kur e ka dorëzuar vërtetimin për pranim të njoftimit.

(15) Pëlqimet, gjegjësisht ankesat sipas paragrafit (13) të këtij neni vërtetohen me vënien e vulës, nënshkrimit dhe datës së plotësimit përkatës në vendet përkatëse të formularit të paragrafit (7), në fakt të paragrafit (8) të këtij neni.

(16) Organi profesional është i detyruar të japë leje për import, gjegjësisht eksport brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(17) Kundër këtij aktvendimi me të cilën refuzohet leje e eksportit ose importit, kërkuesi ka të drejtë të parashtojë ankesë në pajtim me rregullativat për procedurë të përgjithshme administrative.

(18) Organi profesional jo më vonë se 31 janar të vitit aktual përgatit Raport vjetor për llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat janë importuar, eksportuar dh transituara nga/nëpër Republikën e Maqedonisë së Veriut vitin e kaluar.

(19) Raporti sipas paragrafit (18) të këtij neni organi profesional e shpallë në opinion nëpërmjet ueb faqes së tij.

(20) Provat sipas paragrafit (6) pika 2) të këtij neni, personi zyrtar i autorizuar i organit profesional i cili udhëheq procedurë për dhënie e lejeve e merr nga evidenca zyrtare e organit.

### **Neni 97**

#### **Dispozitat e përbashkëta për import, eksport dhe transit të mbeturinave**

Nëse leja, gjegjësisht pajtueshmëria e eksportit, importit dhe transitit të mbeturinave përdoret në kundërshtim me dedikimin për të cilën është dhënë, gjegjësisht nëse zbulohen shkelje dhe keqpërdorime të rëndësishme të saj, organi profesional e asgjëson lejen, pra pëlqimin, në dëm të personit juridik të cilit i është dhënë leja, pa të drejtë të kompensimit për dëmin e ndodhur, si dhe humbjes materiale dhe jomateriale.

## **XII SISTEMI INFORMATIV**

### **Neni 98**

#### **Organizimi i sistemit informativ**

(1) Organi i mjedisit jetësor organizon sistem informativ për menaxhimin me mbeturina, si pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm informativ maqedonas për mjedisin jetësor (në tekstin e mëtutjeshëm: qendra informative), nëpërmjet vendosje së rrjetit për marrjen e informacioneve për menaxhimin e mbeturinave nga ministria, organizatat, institucione shkencore –hulumtuese, personat juridikë dhe fizikë të cilët i menaxhojnë mbeturinat dhe subjektet e tjera.

(2) Njësitë organizative për menaxhim rajonal me mbeturina të nenit 35 të këtij ligji janë të obliguar të organizojnë sistem informativ në nivel rajonal, me të cilën do të sigurohen dhe prezantohen të dhënat për gjendjen e përgjithshme në lidhje me menaxhimin me mbeturinat e parrezikshme, në bazë të të dhënave të marra nga komunat të cilët e përbëjnë rajonin.

(3) Njësitë organizative për menaxhim rajonal të mbeturinave të paragrafit (2) të këtij neni janë të obliguar të dhënat e marra ti përpunojnë dhe ti dorëzojnë deri te organi profesional në së voni deri 31 mars për vitin e kaluar.

(4) Organi profesional është i detyruar ti kompletton të dhënat e menaxhimit mbeturina, dhe të përpunuar ti dorëzon deri te organi i mjedisit jetësor.

(5) Organi i mjedisit jetësor organizon funksionimin e sistemit informativ, në atë mënyrë me çka do të sigurohet mbledhje e informacioneve të shpejta , sakta dhe në kohë në lidhje me menaxhimin me mbeturina dhe është i obliguar t'i selektojë, klasifikojë, përpunojë, azhurojë dhe ti ruan në bazën e të dhënave.

(6) Organi i mjedisit jetësor organizon sistemin informativ, në atë mënyrë që do të sigurojë:

1) qasje në çdo kohë deri te informacione për palët në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtje të mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

2) sqarim të të dhënave, raporteve, masave dhe aktiviteteve të organit të mjedisit jetësor në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në menaxhimin e mbeturinave dhe

3) transparencës së të dhënave nga fusha e menaxhimit të mbeturinave.

### **Neni 99**

#### **Përmbajtja e sistemit informativ**

(1) Sistemi informativ për menaxhimin e mbeturinave përmban:

1) të dhënat për llojin dhe sasinë e mbeturinave nga Regjistri i mbeturinave sipas nenit 100 të këtij ligji dhe kadastrën e krijuesve të mbeturinave të nenit 101 të këtij ligji dhe

2) të dhënat nga organizatat shkencore dhe profesionale dhe nga personat juridik të cilët e përcjellin gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe të dhënat e institucioneve ndërkombëtare të cilat e monitorojnë menaxhimin e mbeturinave.

(2) Në bazë të të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni organi i mjedisit jetësor përgatit raport për gjendje e menaxhimit të mbeturinave si pjesë e raportit për gjendjen e mjedisit jetësor në pajtim me Ligjin e Mjedisit Jetësor.

## **Neni 100**

### **Regjistri i mbeturinave**

- (1) Organi profesional vendos dhe mban regjistër për mbeturina.
- (2) Regjistri sipas paragrafit (1) të këtij neni i përmban të dhënat e:
  - subjektit i cili krijon, mbledh, transporton, përpunon, ruan dhe largon mbeturina,
  - lëndë të para sekondare dhe procese të prodhimit nga të cilat krijohen secila nga lëndë e para sekondare, si dhe të dhënat për menaxhimin me mbeturina,
  - lejet e dhëna për menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë edhe leje për import, eksport dhe transit të mbeturinave të dhëna në pajtim me dispozitat e këtij ligji,
- (3) Të dhënat sipas paragrafit (2) të këtij neni përmbajnë:
  - 1) të dhënat e subjektit i cili menaxhon me mbeturina (titulli, adresa dhe selia);
  - 2) llojin dhe sasinë e mbeturinave që e menaxhojnë;
  - 3) informacione për lejet/pajtueshmërive të subjekteve të cilët menaxhojnë me mbeturina
  - 4) dhe të dhënat të tjera të nevojshme.
- (4) Forma dhe përmbajtja, si dhe mënyra e udhëheqjes, ruajtje dhe mirëmbajtjes së regjistrit të mbeturinave e përshkruan ministri.
- (5) Pjesë e regjistrit të mbeturinave janë edhe regjistrat të cilat udhëhiqen në pajtim të rregullativave për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuese për menaxhimin e mbeturinave rrjedhëse të veçanta dhe rregullativat për mbeturina rrjedhëse të veçanta.

## **Neni 101**

### **Kadastra e krijuesve të mbeturinave**

- (1) Kadastra e krijuesve të mbeturinave është pjesë e kadastrës së mjedisit jetësor të cilën e vendos dhe e udhëheq organi i mjedisit jetës.
- (2) Në kadastrën e krijuesve të mbeturinave regjistrohen krijuesit e mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme të nenit 15 të këtij ligji, lloji dhe sasia e mbeturinave të krijuara, si dhe mënyra e ruajtjes, përpunimit, trajtimit dhe largimit do të regjistrohen në Kadastrën e krijuesve të mbeturinave.
- (3) Njësitë organizative mbajnë kadashtë për territorin e rajonit, në të cilën ruhen të dhënat e krijuesve të mbeturinave të parrezikshme.
- (4) Mënyra dhe procedura e ruajtjes, mirëmbajtjes së të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni në Kadastrën e krijuesve të mbeturinave e përshkruan ministri.
- (5) Të dhënat e kadastrës sipas paragrafit (1) këtij neni paraqet pjesë përbërëse e sistemit informativ për mjedisin jetësor

## **Neni 102**

### **Detyrimi për shpallje të të dhënave**

- (1) Organi i mjedisit jetësor gjeëgësisht organi profesional, njësia organizative për menaxhim rajonal me mbeturina, kryetari i komunës dhe Qytetit të Shkupit dhe prodhuesit e rregullativave për mbeturina rrjedhëse të veçanta, e informojnë publikun për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave, për përparimin e arritur, aktivitet e ardhshme për përmirësimin e gjendjes të menaxhimit të mbeturinave, si dhe për të dhënat krahasimore për gjendjes e tanishme me të kaluarën në menaxhimin e mbeturinave.
- (2) Të dhënat sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi sipas paragrafit (1) të këtij neni i shpall në ueb faqen e tij.

## **Neni 103**

### **Qasja te informacionet për menaxhimin e mbeturinave**

Organi i mjedisit jetësor dhe organi profesional janë të detyruar të gjitha subjekteve të interesuar t'ju mundësojnë qasje deri te informacionet në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **XIII FINANCIMI**

### **Neni 104**

#### **Burimet e financimit**

(1) Zbatimi i dokumenteve strategjike, të planit dhe programeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për menaxhimin e mbeturinave financohet me fonde të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kredite, donacione, mjete të subjekteve të cilët menaxhojnë me mbeturina, kompensime dhe burime të fondeve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Zbatimin e planeve rajonale të komunave dhe Qytetit të Shkupit për menaxhimin e mbeturinave financohet nga fondet e siguruara nga buxhetet e njësive organizative për menaxhimin e mbeturinave, nga komunat dhe Qyteti i Shkupit, kredite, donacione, kompensime, gjopa të shqiptuara për kundërvajtje të kryer në territorin e komunave dhe Qytetin e Shkupit dhe burime të fondeve tjera të parashikuara me ligj .

(3) Mjete për ndërtim dhe punë të objekteve të ruajtjes, përpunimit dhe largimit të mbeturinave sigurohen nga buxhetet e Komunave dhe Qytetit të Shkupit, nga subjektet të cilët menaxhojnë me mbeturina,, nga kredite, donacione dhe burime të fondeve tjera të përcaktuara me ligj

(4) Menaxhimi me rrjedha të veçanta të mbeturinave do të financohet nga kompensimet të përshkuara në pajtim me rregullativat për rrjedha të veçanta të mbeturinave dhe rregullativat për themelim dhe punë të kolektivit, gjegjësisht realizuesit vetjak si pjesë e regjimit për përgjegjësi të zgjeruar.

### **Neni 105**

#### **Tarifa për përcaktimin e çmimit të shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale**

(1) Për kryerjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale, ofruesi i shërbimit ka të drejtë të paguan çmim për shërbimin e ofruar për menaxhimin e mbeturinave komunale.

(2) Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave komunale sipas paragrafit (1) të këtij neni përfshin:

- shërbim për mbledhje, transportimin dhe seleksionimin e mbeturinave komunale dhe
- shërbim për trajtimin e mbeturinave komunale.

(3) Lartësia e çmimit të shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale nga lartësia e tarifës së shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale është e përcaktuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(4) Lartësia e tarifës për menaxhimin e mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: tarifa e mbeturinave) varet nga shpenzimet e ofruesit të shërbimit për ta siguruar shërbimin, duke i përfshirë edhe shpenzimet për shërbimin e përkrahjes, ndërsa e cila llogaritet në përputhje me Rregulloren për përcaktimin e tarifës për shërbim për menaxhim të mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja për tarifën e mbeturinave).

(5) Në përlllogaritjen e tarifës së mbeturinave sipas paragrafit (3) të këtij neni përfshin shpenzimet e bëra për shërbimin dhe shërbimet e përkrahjes të cilat bazohen kryesisht në:

- shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje,
- shpenzimet për investimet kapitale.

(6) Tarifa e mbeturinave përcaktohet në bazë të sasisë dhe llojit të mbeturinave dhe mund të përcaktohet në bazë të njësisë së matjes dhe atë në denarë për metër kub, denarë për metër katror për hapësirat e banimit gjegjësisht oborret, denarë për kilogram në përputhje me Rregulloren për tarifën e mbeturinave.

(7) Tarifa e mbeturinave përcaktohet për secilin rajon veçmas në një mënyrë të përcaktuar në pajtim me paragrafin (7) të këtij neni dhe të dhënat nga plani sipas nenit 23 të këtij ligji.

(8) Llojet dhe mënyra e llogaritjes së tarifës së mbeturinave, struktura e tarifave për secilin shërbim të mbeturinave në veçanti, llojet e shpenzimeve të cilat merren parasysh në përlllogaritjen e tarifës për mbeturina dhe të ardhurat e nevojshme për mbulimin e këtyre shpenzimeve, si dhe karakteristikat e tyre dhe mënyra e paraqitjes së tyre për secilin rajon veçmas, përcaktohen me Rregulloren për tarifën e mbeturinave të miratuar nga Komisioni Rregullator.

(9) Në Rregulloren e tarifave të mbeturinave, përcaktohet edhe mënyra e përlllogaritjes dhe struktura e çmimit të shërbimit e cila paguhet nga shfrytëzuesi i fundit.

(10) Në Rregulloren e tarifave të mbeturinave, përcaktohet edhe lista e treguesve kryesorë të suksesshmërisë, objektivat që duhet t'i përmbush ofruesi i shërbimit në lidhje me ofrimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale, standardet në lidhje me sigurimin e shërbimit, si dhe mënyrën, procedurën, formën dhe përmbajtjen e formularëve të raporteve për njoftim të Komisionit Rregullator nga ofruesit e shërbimeve për përmbushjen e objektivave dhe standardeve të përcaktuara në lidhje me sigurimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

(11) Ofruesi i shërbimit i cili kryen mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale është i detyruar nga shfrytëzuesi i fundit ta paguan çmimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale sipas paragrafit (2) të këtij neni, sipas tarifës për mbeturina lartësia e të cilës është përlllogaritur në pajtim me Rregulloren për tarifën e mbeturinave e cila është miratuar nga Komisioni Rregullator dhe të përcaktuar me aktvendim për përcaktimin e tarifave për shërbimet e mbeturinave ose aktvendim të tarifave rregullatore për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: tarifa rregullatore).

(12) Ofruesi i shërbimit i cili bën mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave sipas paragrafit (9) të këtij neni, është i detyruar që pjesë të mjeteve që i merr nga shfrytëzuesi i fundit, ndërsa janë të dedikuara për largimin e mbeturinave komunale t'ia paguan ofruesit të shërbimit i obliguar për largimin e mbeturinave.

(13) Ofruesi i shërbimit që bën mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave nuk guxon të paguan çmim për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale nga shfrytëzuesi i fundit në tarifën e të cilës nuk është miratuar nga ana e Komisionit Rregullator dhe nuk është aprovuar me aktvendim për përcaktimin e tarifës për mbeturina.

## **Neni 106**

### **Financimi i Komisionit Rregullator**

(1) Puna e Komisionit Rregullator për përcaktimin e tarifës së mbeturinave do të financohet nga pagesat e :

1. kompensim vjetor të veçantë që do e paguan ofruesi i shërbimeve e përcaktuar si përqindje të ardhurave vjetore të ofruesit të shërbimeve e realizuar nëpërmjet dhënies së shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe

2. kompensime nga procedurat për përcaktimin e tarifës së mbeturinave, gjegjësisht tarifës rregullatore për mbeturina.

(2) Përqindja e të ardhurave vjetore të ofruesve të shërbimeve sipas paragrafit (1) pika 1 e këtij neni përcaktohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim, ku përqindja nuk mund të jetë më e lartë se 0,1%.

(3) Ofruesi i shërbimit është i detyruar të paguajë kompensimin sipas paragrafit (2) të këtij neni në llogarinë e Komisionit Rregullator në dy pjesë të barabarta, pjesa e parë jo më vonë se 30 prill të vitit aktual bazuar në të ardhurat realizuara në gjashtë muajt e fundit të vitit të kaluar, dhe pjesa e dytë jo më vonë se 30 shtator në vitin aktual bazuar në të ardhurat e realizuara në gjashtë muajt e parë të vitit aktual.

(4) Kompensimi nga procedura për përcaktimin e tarifave për mbeturina përcaktohet për secilin ofrues të shërbimeve veç e veç, bazuar në llojin e shërbimeve për të cilat kërkohet përcaktimi i tarifës së mbeturinave, pra për të cilat janë përcaktuar tarifa rregullatore për mbeturina dhe e cila nuk mund të jetë më pak se 5,000 denarë, as më shumë se 50,000 denarë, pra më pak se 60,000 denarë, dhe jo më shumë se 300,000 denarë në rastet të nenin 110 të këtij ligji kur përcaktohet tarifa rregullatore për mbeturinat.

## **Neni 107**

### **Procedura për përcaktimin e tarifës për mbeturina**

(1) Tarifa e mbeturina përcaktohet nga ana e Komisionit Rregullator për secilin ofertues veçmas të shërbimit në bazë të dorëzimit të Planit për tarifën e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: Plani për tarifën e mbeturinave) në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj dhe Rregulloren për tarifën e mbeturinave.

(2) Gjatë përcaktimit të tarifës sipas paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni Rregullator do të marrë në parasysh prapësinë e dispozicionit të amvisërive në pajtim me neni 6, pika 58 të këtij ligji në rajonin në të cilën ofertuesi e siguron shërbimin.

(3) Komisioni Rregullator, më së paku çdo tre vjet, në periudhën e zbatimit të investimeve intensive në infrastrukturën për dhënie të shërbimit, do të miraton rekomandime për pragun e dispozicionit në nivel të hyrave të amvisërive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa në çdo shtatë vjet në periodë kur ekzistojnë investime më të vogla, ndërsa ekzistojnë më shumë objekte infrastrukturore operative për ofrimin e shërbimit.

(4) Ofertuesi i shërbimit, me qëllim të përcaktimit të tarifës për mbeturina që e jep shfrytëzuesi i fundit, ndërsa për shkak të arritjes së objektivave të këtij ligji është i obliguar të përgatit kërkesë për përcaktimin e tarifës për mbeturina me propozim tarifa dhe të njëjtën ta dorëzojë deri te Komisioni Rregullator.

(5) Në kërkesën sipas paragrafit (4) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve dorëzon edhe:

- projektplan për tarifën e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: Projektplan për tarifën e mbeturinave), dhe

- të dhënat dhe raportet nga plani i biznesit të cilat janë të detyrueshme për përcaktimin e tarifës së shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: Planin e biznesit për tarifën e mbeturinave).

(6) Kërkesa sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe dokumentacioni të këtij neni është i detyruar të dorëzojë deri te Komisioni Rregullator më së voni në afat prej nëntë muaj para skadimit të vlefshmërisë së aktvendimit për përcaktim të tarifës për mbeturina.

(7) Përgatitja e kërkesës së paragrafit (4) të këtij neni, llojet e dokumentacioneve të cilat bashkëngjiten në kërkesën dhe në projekt – Planin për tarifën e mbeturinave, si dhe dorëzimi i të dhënave sipas paragrafit (5) nënparagrafi 2 të këtij neni kryet në pajtim me Rregulloren për tarifën e mbeturinave.

(8) Projektplanin për tarifën e mbeturinave përgatitet për periudhë prej tre deri gjashtë vjet .

(9) Dorëzimi i kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni së bashku me projektplanin për tarifën e mbeturinave si dhe përputhja e të dhënave të tjera kryet në formë të shkruar dhe në formë elektronike.

(10) Për shkak të përgatitjes së projekt – Planit për tarifën e mbeturinave ofruesi i shërbimeve është i detyruar të bëjë një vlerësim real të infrastrukturës ekzistuese që ai përdor për ofrimin e shërbimeve dhe të paraqesë detyrimisht të dhënat e vlerësimit si bazë për përlogaritjen e shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale dhe për investimet në të ardhmen.

(11) Ofruesi i shërbimit është i detyruar , në projektplanin për tarifën e mbeturinave, të bashkëngjit të dhëna të indikatorëve kryesor për suksesshmërinë me propozim qëllime të cilat planifikon të plotëson ofertuesi i shërbimit, ndërsa në lidhje me sigurimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale me realizimin e Planit për tarifën e mbeturinave.

(12) Ofruesi i shërbimit është i detyruar, për përgatitjen e kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe parashtrësat ndaj kërkesës, të përdorë të dhëna të sakta dhe të besueshme që janë në përputhje me kontabilitetin dhe dokumentacionin tjetër të ofruesit të shërbimit.

(13) Forma dhe përmbajtja e kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet nga Komisioni Rregullator pas miratimit të Rregullores për tarifën e mbeturinave.

## **Neni 108**

### **Përcaktimi i tarifës për mbeturina**

(1) Komisioni Rregullator e përshkruan mënyrë dhe procedurën për përcaktimin e tarifës për mbeturina, si dhe për të dhënat të tjera të cilat janë të nevojshme për ofruesin e shërbimit.

(2) Komisioni Rregullator me aktin sipas paragrafit (1) të këtij neni i përcakton edhe kriteret e vlerësimit të kërkesës dhe parashtrësive për përcaktimin e tarifës për mbeturina, mënyra e përgatitjes së dokumenteve të nevojshme për përcaktimin e tarifës, duke i marrë parasysh kapacitetin e ofruesit të shërbimit, afatet e veprimit, procedura e negociatave, si dhe procedura dhe kushtet kur Komisioni Rregullator është e detyruar të miraton Tarifë rregullatore për mbeturinat.

(3) Komisioni Rregullator është e obliguar të miraton udhëzim të veçantë për përgatitjen e kërkesës për përcaktim të tarifës për përcaktimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave komunale, parashtrësat dhe kriteret e vlerësimit.

(4) Komisioni Rregullator e përcakton tarifën e mbeturinave me aktvendim për përcaktimin e tarifës për përcaktimin e çmimit për menaxhimin e mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: Aktvendimi për tarifën e mbeturinave) të cilën e miraton në seancë.

(5) Komisioni Rregullator e përcakton tarifën për mbeturina në bazë të vlerësimit të:

1. shpenzimeve për sigurimin e shërbimeve dhe shërbime për mbështetje ;

2. lartësisë së tarifës së propozuar për shërbime dhe çmimi i shërbimit që do të arrihet me tarifën e propozuar dhe dispozicioni i saj financiar për amvisëri të rajonit të cilës i ofrohet shërbimi dhe përqindja e amvisërive për të cilat do të tejkalohet pragu i dispozicionit financiar;

3. investimeve kapitale të planifikuara për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve ;

4. efikasitetit të shërbimit të krahasuar me indikatorët e suksesit dhe

5. arritjes së vlerave objektive të indikatorëve kyç për përcjellje të suksesit.

(6) Në seancën në të cilën miratohet aktvendimi për përcaktimin e tarifës për shërbime, Komisioni Rregullator është e detyruar ti shqyrtojë edhe vërejtjet e arritura nga ana e ofruesit të shërbimit, në fakt të themeluesit të ofruesit të shërbimit .

(7) Nëse vlerëson se vërejtjet e arritura janë të një natyre të tillë që ato mund të ndikojnë ndjeshëm në përcaktimin e sasisë së tarifave të mbeturinave, Komisioni Rregullator mund të fillojë procedurë negociimi në mënyrë që të harmonizojë sasinë e tarifave të mbeturinave brenda 15 ditëve nga data e pranimit të vërejtjeve

(8) Procedura për negociata sipas paragrafit (7) zë këtij neni duhet të mbarojnë në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të tyre.

(9) Në rast se negociatat nuk kanë sukses, Komisioni Rregullator do të miraton aktvendim për fillimin e procedurës për përcaktimin e Tarifës rregulatore për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave komunale (në tekstin e mëtutjeshëm: tarifa rregulatore për mbeturina) në pajtim me nenin 110 të këtij ligji.

(10) Aktvendimi për tarifë për mbeturina të paragrafit (4) të këtij neni në veçanti përmban

:

- lartësinë e tarifës për shërbimet që i siguron ofertuesi i shërbimit;

- vëllimi minimal dhe maksimal i shprehur si përqindje e vlerës së përcaktuar në kornizë të së cilës është e lejuar që ofruesi i shërbimit të miraton vendim për përcaktimin e lartësisë së tarifës së shërbimit;

- kushtet të cilat duhet ti plotësojë ofruesi i shërbimit me thirrje të pranimit të Planit për tarifën e shërbimit për mbeturina dhe

- afati i vlefshmërisë së tarifave për shërbimet.

(11) Në raste kur nuk është arritur pajtueshmëri me ofruesin e shërbimit për lartësinë e tarifës së shërbimeve për mbeturina, Komisioni Rregullator në seancë miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për përcaktimin e tarifës për shërbimet e mbeturinave e cila përmban:

- bazat e refuzimit të kërkesës;

- ndryshimet të cilat janë të nevojshme ti bën ofruesi i shërbimit që përsëri të parashtrohet kërkesë dhe

- vlerësimi i ndikativ për tarifën të cilat Komisioni Rregullator i llogarit si përkatëse .

(12) Komisioni Rregullator është i detyruar aktvendimet sipas paragrafit (10) dhe (11) të këtij neni t'i publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e tij dhe ato t'i dorëzojë tek ofertuesi i shërbimit dhe te themeluesi i ofertuesit të shërbimit pa prolongim.

(13) Ofruesi i shërbimit është i detyruar, pa prolongim dhe jo më vonë se 15 ditë nga dita e publikimit të aktvendimit sipas paragrafit (12) të këtij neni, ta dorëzojë deri tek organi drejtues i ofruesit të shërbimit për shkak të miratimit të vendimit për përcaktimin e tarifës për mbeturina.

(14) Organi drejtues i ofruesit të shërbimit është i detyruar të miraton vendimin sipas paragrafit (13) të këtij neni brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit dhe të njëjtën ta dorëzon deri te kryetari i komunës ose të qytetit të Shkupit i cili është themelues i ofertuesit, për shkak të dhënies së pajtueshmërisë së vendimit në afat prej tetë ditësh nga miratimi i tij.



(15) Kryetari i komunës ose kryetari i Qytetit të Shkupit është i detyruar të fillojë procedurën për dhënien e pajtueshmërisë për vendimin për përcaktimin e tarifës së mbeturinave brenda një periudhe jo më të gjatë se 60 ditë.

(16) Në rastet sipas paragrafit (14) të këtij neni, kur aktvendimi ka të bëjë me tarifat e mbeturinave të cilën ofruesi i shërbimit është person juridik i cili nuk është themeluar nga komuna ose nga Qyteti i Shkupit ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, organi drejtues i ofruesi të shërbimit është i obliguar në afat jo më të gjatë se 60 ditë të miraton vendim për përcaktimin e tarifës për mbeturina

(17) Nëse nuk është dhënë pajtueshmëri të vendimit për përcaktim të tarifës për mbeturina në afat prej 150 ditësh nga dita e shpalljes së aktvendimit për përcaktimin e tarifës për mbeturina në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Komisioni Rregullator do të miratojë aktvendim për nisjen e procedurës për miratim të tarifës rregullatore për mbeturina.

(18) Aktvendimet sipas paragrafit (10), (11) dhe (17) të këtij neni janë përfundimtare dhe kundër tyre nuk lejohet ankesë.

(19) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (10), (11) dhe (17) të këtij neni, ofruesi i shërbimeve dhe kryetari i komunës ose kryetari i Qytetit të Shkupit, gjegjësisht organi drejtues i personit juridik ka të drejtë të iniciojë kontekst para gjykatës kompetente.

## **Neni 109**

### **Zbatim i tarifës për mbeturina**

(1) Organi drejtues i ofruesit të shërbimit është i detyruar që brenda një periudhe jo më të gjatë se 45 ditë nga dita e miratimit të pëlqimit sipas nenit 108, paragrafi (15) të këtij ligji dhe vendimi sipas nenit 108, paragrafi (16) ) të këtij ligji, të fillojë ta zbatojë tarifën e miratuar për mbeturina nga ana e Këshillit të Komunës, gjegjësisht nga Qyteti i Shkupit, gjegjësisht nga ana e organit drejtues i personit juridik.

(2) Në rastet kur Këshilli i Komunës, përkatësisht Qyteti i Shkupit, si dhe organi drejtues i personit juridik nuk sjellin pëlqimin për vendimin për përcaktimin e tarifës së mbeturinave, organi drejtues i ofruesit të shërbimit është i detyruar të fillojë zbatimin e vendimit për përcaktimin e shumës së Tarifës rregullatore për mbeturina të nenit 110, paragrafi (6) të këtij ligji brenda një periudhe jo më të gjatë se 45 ditë nga dita e miratimit të të njëjtës.

(3) Organi drejtues i ofruesit të shërbimit është i detyruar të harmonizojë vendimet e tij me aktvendimet e miratuara nga Komisioni Rregullator që janë të rëndësishme për zbatimin e tarifës së përcaktuar të mbeturinave.

(4) Ofruesi i shërbimit është i detyruar të respektojë kushtet në të cilat përcaktohet tarifa për mbeturina komunale, si dhe të përmbushë objektivat që lidhen me indikatorët kryesorë të suksesshmërisë në lidhje me ofrimin e shërbimit.

(5) Ofruesi i shërbimit është i detyruar një herë në vjet deri te Komisioni Rregullator të dorëzojë raport për zbatimin tarifës për mbeturina, më së voni deri një m muaj pas përfundimit të vitit kalendarik, të cilit i referohet raporti.

(6) Forma dhe përmbajtja e raporteve vjetore sipas paragrafit (3) të këtij neni përcaktohen nga Komisioni Rregullator.

## **Neni 110**

### **Përcaktimi i tarifës rregullatore për mbeturina**

(1) Në raste kur ofruesi i shërbimeve nuk dorëzon kërkesë për përcaktimin e tarifës për mbeturina, si dhe në raste kur vepron sipas kërkesës së Komisionit Rregullator për dorëzimin e të dhënave shtesë ndaj kërkesës, Komisioni rregullator është i obliguar në afat jo më të gjatë se 180 ditë nga dita e miratimit të aktvendimit të fillon me procedurën për përcaktimin e tarifës rregullatore për mbeturinë, gjegjësisht në afat jo më të gjatë se 180 ditë nga dita e skadimit të afatit për dorëzim të kërkesave, të përgatiti Plan rregullator për tarifën e mbeturinave për ofruesit e shërbimeve në bazë të së cilës do të mund të sjellë aktvendim për përcaktimin e tarifës rregullatore për mbeturinë.

(2) Plani për tarifë të mbeturinave, Komisioni rregullator e përgatit në mënyrë vetjake ose me angazhimin e shtëpisë së autorizuar revizione nga fusha e ekonomisë.

(3) Ofruesit e shërbimeve janë të obliguar, që Komisionit për rregullator ose e shtëpisë së autorizuar revizione sipas paragrafit (2) të këtij neni t'ju japin të dhëna të dhënat dhe informacionet në dispozicion të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e Planit për tarifë të mbeturinave.

(4) Komisioni rregullator mund në procedurë për përgatitje të planit për tarifë të mbeturinave, të kërkon kryerjen e mbikëqyrjes së revizionit ose të kërkon ekspertizë për përcaktimin e shpenzimeve për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave për ofruesit e shërbimeve.

(5) Shpenzimet për revizionin mbikëqyrës ose ekspertizës janë në barrë të ofruesit të shërbimeve.

(6) Komisioni Rregullator, brenda një periudhe jo më të gjatë se 90 ditë nga dita e përgatitjes së Planit për tarifën e mbeturinave, miraton aktvendim për përcaktimin e tarifës rregullatore për mbeturina për ofertuesit e shërbimeve në bazë të vlerësimit të të dhënave të mbledhura dhe në pajtim me paragrafin (2) dhe (3) të këtij neni për të cilat zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e nenit 108, paragrafi (2) të këtij ligji.

(7) Për shkak të miratimit të aktvendimit për përcaktim të tarifës rregullatore për mbeturinë, Komisioni rregullator mund të fillojë procedurë për negociata me ofertuesit e shërbimeve.

(8) Aktvendimi për tarifën rregullatore të mbeturinave duhet të përmbajë në veçanti:

- lartësinë e tarifës së mbeturinave e shprehur në një sasi fikse,
- kushtet që duhet të plotësojë ofruesi i shërbimit dhe
- periudha e vlefshmërisë së tarifave.

(9) Komisioni Rregullator është e obliguar që aktvendimit sipas paragrafit (6) të këtij neni ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e saj dhe të njëjtën ta dorëzon deri te ofertuesi dhe deri te themeluesi i ofertuesit, pa prolongim.

(10) Organi menaxhues i ofruesit të shërbimit është i detyruar të fillojë zbatimin e tarifës rregullatore të mbeturinave brenda një periudhe jo më të gjatë se 45 ditë nga dita e miratimit të aktvendimit të përmendur në paragrafin (6) të këtij neni.

(11) Aktvendimi sipas paragrafit (6) të këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesë. Ofertuesi dhe kryetari i komunës dhe kryetari i qytetit të Shkupit, përkatësisht organi menaxhues i personit juridik, kanë të drejtë të iniciojnë kontekst administrativ para gjykatës kompetente kundër këtij aktvendimit.

(12) Organi menaxhues i ofruesit të shërbimit është i detyruar të harmonizojë vendimet e tij që janë të rëndësishme për zbatimin e tarifës së përcaktuar të mbeturinave, me aktvendim sipas paragrafit (6) të këtij neni.

## **Neni 111**

### **Përcaktimi i tarifës rregullatore për mbeturina në raste të tjera**

(1) Në raste e nenit 108, paragrafët (11) dhe (17) të këtij ligji, Komisioni Rregullator është e obliguar, në afat jo më të gjatë se 120 nga dita e miratimit të aktvendimit për fillimin e procedurës për përcaktim të tarifës rregullatore për mbeturina, të miraton aktvendim për përcaktimin e tarifës rregullatore për mbeturina

(2) Aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni Rregullator e miraton në bazë të të dhënave që disponon si dhe të dhënave të tjera të cila në mënyrë plotësuese janë dorëzuar ose marrë nga ofertuesit e shërbimeve dhe zbatim përkatës të dispozitave të nenit 108, paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij ligji duhet të përmbajë në veçanti:

- lartësinë e tarifës së mbeturinave e shprehur në një sasi fikse, dhe
- kushtet që duhet t'i zbatojë ofruesi i shërbimit

## **Neni 112**

### **Ndryshimi i planit të tarifës për mbeturinat**

(1) Aktvendimi për përcaktimin e tarifës së mbeturinave është i detyrueshëm dhe i obligueshëm për ofruesin e shërbimit për periudhën të cilës i referohet.

(2) Si përjashtim sipas paragrafit (1) të këtij neni, dhe në rastet e përmendura në paragrafin (3) të këtij neni, ofruesi i shërbimit, me kërkesë, mund të fillojë një procedurë për ndryshimin e

aktvendimit për përcaktimin e tarifave të mbeturinave para skadimit të periudhës së cilës i referohet aktvendimi për përcaktimin e tarifës për mbeturina.

(3) Procedura për ndryshim të tarifës për mbeturina mund të iniciohet nëse:

- ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në rrethanat që ekzistojnë në kohën e miratimit të aktvendimit për përcaktimin e tarifave për mbeturina, gjë që çon në nevojën e harmonizimit dhe rregullimit të tarifave,

- interes më të lartë publik dhe raste emergjence dhe/ose

- ka ndodhur ndryshim të rëndësishëm në kriteret e vlerësimit të nenin 108, paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Kërkesa sipas paragrafit (2) të këtij neni dorëzohet deri te Komisioni Rregullator në formë të shkruar dhe elektronike të përcaktuar nga Komisioni Rregullator.

(5) Komisioni Rregullator vendos me aktvendim ndaj kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(6) Për miratimin e aktvendimit sipas paragrafit (5) të këtij neni, zbatohet në mënyrë të përshtatshme procedura për përcaktimin e tarifave të mbeturinave e nenit 108 të këtij ligji.

### **Neni 113**

#### **Financimi i programeve për menaxhimin e mbeturinave komunale, planeve rajonale për menaxhimin e mbeturinave dhe njësive organizative për menaxhim rajonal të mbeturinave**

(1) Ofruesi të shërbimeve të nenit 60 të këtij ligji, i paguajnë komunës ose Qytetit të Shkupit kompensim për menaxhimin e mbeturinave komunale në lartësi prej 2% nga çmimi që paguajnë për realizim të shërbimeve.

(2) Kompensimi sipas paragrafit (1) të këtij neni paguhet gjatë pagesës së çmimit për shërbime të realizuara dhe do të shfaqet veçmas në llogarinë për shërbimin e kryer.

(3) Mjetet nga kompensimet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të ardhura të buxhetit të komunave, dhe Qytetit të Shkupit dhe i paguhen një llogari përkatëse në kornizë të llogarisë së kasafortës, më së voni deri 15 ditë të muajit aktual për muajin paraprakë, ndërsa përdoren për financim të realizimit të objektivave për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara në plane rajonale për menaxhimin e mbeturinave, si dhe për shkak financimit të njësive organizative për menaxhim rajonal të mbeturinave.

(4) Komunitat dhe Qyteti i Shkupit do të paguajnë 50% të tarifës nga ky nen te Qendrat për zhvillimin e rajonit planifikues për menaxhimin rajonal të mbeturinave jo më vonë se dita e fundit e muaj aktual.

### **Neni 114**

#### **Mjetet nga pagesa e gjobave të shqiptuara**

(1) Mjetet nga pagesat e gjobave të shqiptuara nga inspektorët të autorizuar komunal dhe të Qytetit të Shkupit dhe Komunave të Qytetit të Shkupit janë të ardhura të komunës, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

(2) Mjetet nga pagesat e gjobave të shqiptuara nga punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për punët e fushës së punëve të brendshme janë të ardhura të komunës, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

## **XIV. MBIKËQYRJA DHE ORGANET KOMPETENTE**

### **Neni 115**

#### **Organet kompetente**

(1) Mbiqëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji dhe të rregullativave të miratuara në bazë të këtij ligji do të kryejë organi i mjedisit jetësor.

(2) Mbiqëqyrje të inspektoratit mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullativave të miratuar në bazë të këtij ligji do të kryejë Inspektoratit shtetëror i mjedisit jetësor .

(3) Për punët e kompetencave të komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit të përcaktuara me këtë ligj mbiqëqyrje të inspektoratit mbi zbatimin e këtij ligji do të kryejnë

inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor në komunë, komunitat e Qytetit të Shkupit dhe inspektorat e autorizuar të mjedisit jetësor të Qytetit të Shkupit .

(4) Mbikëqyrje të inspektoratit mbi zbatimin e këtij ligji në pjesën e krijimit, seleksionimit dhe paketimit të mbeturinave mjekësore do të kryejë inspektori shtetëror sanitar dhe shëndetësorë në bashkëpunim me inspektorin shtetëror për mjedis jetësor.

(5) Mbikëqyrje të inspektoratit mbi zbatimin e këtij ligji në pjesë e menaxhimit të mbeturinave të parrezikshme kryen inspektori shtetëror komunal.

(6) Mbikëqyrës mbi zbatimin e rregullativave të miratuara nga Komisioni Rregullator është Komisioni Rregullator.

(7) Mbikëqyrje mbi zbatimin e detyrimeve nga ana e subjekteve të cilët transportojnë mbeturina në lidhje me detyrimin për posedimin e formularëve transportues dhe identifikues dhe formularët të nenit 96, paragrafi (7) dhe (8) të këtij ligji, kryen organi doganor dhe organi kompetent i administratës shtetërore për kryerjen e punëve të fushë së punëve të brendshme.

## **Neni 116**

### **Fushëveprimi i inspektorit shtetëror i mjedisit jetësor**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes brenda fushëveprimit të tij, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor (në tekstin e mëtuftjeshëm: inspektor i mjedisit jetësor) bën këqyrje dhe kontroll:

1) nëse personi juridik i akredituar për vlerësimin e karakteristikave të mbeturinave vepron në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji;

2) nëse personi juridik i akredituar posedon akreditim përkatës në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

3) nëse krijuesi i mbeturinave e përdor mbeturinat si lëndë e parë sekondare në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

4) nëse krijuesi/ mbajtësi i mbeturinave që kanë pushuar të jetë mbeturina vepron në pajtim me nenin 19 të këtij ligji;

5) nëse subjekti i mbikëqyrjes ka përpiluar program për menaxhim të mbeturinave dhe a ka vepruar në pajtim me nenin 27, paragrafi (1) të këtij ligji;

6) nëse subjekti i mbikëqyrjes sipas nenit 27 të këtij ligji ka dorëzuar raport vjetor për zbatimin e programeve të tij tek organi kompetent në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;

7) nëse masat dhe aktivitetet e subjektit të mbikëqyrjes i cili menaxhon mbeturinat janë në përputhje me dokumentet strategjike, të planifikimit dhe të programit, të përmendura në nenin 30 të këtij ligji;

8) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me mbeturina, menaxhimin e mbeturinave e bën në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;

9) nëse subjektet që menaxhojnë me mbeturina, e blejnë mbeturinat në pajtim me dispozitat e këtij ligji (neni 37, paragrafi (5) të këtij ligji);

10) nëse subjektet që përpunojnë mbeturinat i kryejnë ato në pajtim me nenin 39 të këtij ligji;

11) nëse subjektet që kryejnë përpunimin e mbeturinave e kryejnë përpunimin duke përdorur operacionet e përmendura në nenin 40 të këtij ligji;

12) nëse mbeturinat ruhen në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;

13) nëse përgatitja për ripërdorim, ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave kryhet në përputhje me masat dhe aktivitetet e specifikuar në dokumentet strategjike të këtij ligji (neni 42 të këtij ligji);

14) nëse largimi i mbeturinave është kryer në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;

15) nëse largimi i mbeturinave kryhet me operacionet e përmendura në nenin 44 të këtij ligji;

16) nëse mbeturinat në stacionet e transferimit trajtohen në pajtim me nenin 46 të këtij ligji;

17) nëse subjekti që menaxhon me mbeturina ka emëruar menaxhues për mbeturinat dhe i njëjti a posedon certifikatë për menaxhues të mbeturinave në pajtim me nenin 47 dhe 47 të këtij ligji;

18) nëse subjekti që menaxhon me mbeturina ka emëruar menaxhues të lartë për mbeturina dhe i i njëjti a posedon certifikatë për menaxhues të lartë të mbeturinave në pajtim me nenin 47 dhe 47 të këtij ligji;

19) nëse subjekti i mbikëqyrjes që menaxhon me mbeturina mban evidencë në pajtim me nenin 50 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;

20) nëse subjekti i mbikëqyrjes, personave të obliguar për transport të mbeturinave ju jep formularë transportues dhe identifikues në pajtim me nenin 50, paragrafi (4) të këtij ligji;

21) nëse subjekti i mbikëqyrjes vepron në pajtim me nenin 50, paragrafi (5) të këtij ligji;

22) Nëse subjekti i mbikëqyrjes formularët e nenit 50, paragrafit (4) dhe (5) të këtij ligji i ruan si pjesë përbërëse e evidencës së plotë të menaxhimit të mbeturinave (neni 50, paragrafi (6) të këtij ligji;

23) Nëse subjekti i mbikëqyrjes të dhënat e evidencës të llojit të raportit konsolidues i dorëzon deri te organet kompetente në pajtim me nenin 50, paragrafin (7) dhe (8) të këtij ligji;

24) Nëse subjekti i mbikëqyrjes të dhënat e evidencës i ruan në pajtim me nenin 50, paragrafi (10) të këtij ligji;

25) Nëse subjekti i mbikëqyrjes krijon/posedon mbeturinë të rrezikshme dhe menaxhon me mbeturinë të rrezikshme në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;

26) nëse krijuesi/poseduesi i mbeturinave të rrezikshme i përziën ato me lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme ose me mbeturinat jo të rrezikshme në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji;

27) nëse krijuesi/poseduesi i mbeturinave të rrezikshme që i përziën mbeturinat e rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave, substancave dhe materieve e ka informuar organin profesional në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;

28) nëse krijuesi/poseduesi e paketon dhe shënon mbeturinat e rrezikshme në përputhje me nenin 54 të këtij ligji;

29) nëse ofruesi i shërbimit, përkatësisht operatori i qendrës rajonale të menaxhimit të mbeturinave mbledh dhe transporton mbeturina të rrezikshme nga amvisëritë në pajtim me nenin 55, paragrafi (4) të këtij ligji;

30) nëse operatori i qendrës rajonale të menaxhimit të mbeturinave vepron me mbeturinat e rrezikshme të mbledhura nga amvisëritë në pajtim me nenin 55, paragrafi (5) të këtij ligji;

31) nëse mbeturinat mjekësore i menaxhon në pajtim me nenin 56 të këtij ligji;

32) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me mbeturina të dioksidit të titanit në pajtim me nenin 57 të këtij ligji;

33) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me mbeturina të azbestit dhe mbeturinat nga produktet që përmbajnë azbest në pajtim me nenin 58 të këtij ligji;

34) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me PCB në pajtim me nenin 59 të këtij ligji;

35) nëse subjekti mbikëqyrës që menaxhon me mbeturina ka leje për kryerjen e aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave të përmendura në nenin 64 të këtij ligji;

36) nëse subjekti mbikëqyrës që posedon leje të përmendur në nenin 64 i plotëson kushtet e përshkruara në lejen e menaxhimit të mbeturinave;

37) nëse investitori ka dorëzuar n studim të fizibilitetit në pajtim me nenin 66, paragrafi (3) të këtij ligji;

38) nëse subjekti i mbikëqyrjes ka dorëzuar kërkesë për ndryshimin e lejes për menaxhimin e mbeturinave për shkak të kushteve të ndryshuara dhe në afat për parashikuar në pajtim me nenin 67 paragrafi (6) dhe (7) të këtij ligji;

39) nëse subjekti i mbikëqyrjes që kryen aktivitete në fakt veprimtari sipas nenit 68, paragrafi (1), alineja 1 të këtij ligji ka dorëzuar njoftim për regjistrim në pajtim me nenin 68, paragrafin (2) të këtij ligji;

40) nëse subjekti i mbikëqyrjes largon mbeturina në pajtim me nenin 71 të këtij ligji;

41) nëse subjekti i mbikëqyrjes largon mbeturina në kundërshtim me nenin 73 të këtij ligji;

42) nëse themeluesi i deponisë posedon leje përkatëse për deponi në pajtim me nenin 75 të këtij ligji;

43) nëse subjekti i mbikëqyrjes i cili posedon leje për deponi i plotëson kushtet e shënuara në leje (neni 75 të këtij ligji) ;

- 44) nëse subjekti i mbikëqyrjes në deponi për mbeturina hedh mbeturina në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji;
- 45) nëse subjekti i mbikëqyrjes heq mbeturinat që nuk janë të pranueshme në deponi në pajtim me nenin 79 të këtij ligji;
- 46) nëse subjekti i mbikëqyrjes mban llogari për sasinë e përbërësve të biodegradueshëm në mbeturina që ai mund të deponojë në pajtim me nenin 79, paragrafi (5) të këtij ligji;
- 47) nëse subjekti i mbikëqyrjes kryen hedhjen e mbeturinave në klasat e përshtatshme të deponive, si dhe heqja e mbeturinave a kryet në pajtim me nenin 80 të këtij ligji;
- 48) nuk e paguan tarifën e hedhjes së mbeturinave të përcaktuara në pajtim me nenin 82 të këtij ligji;
- 49) nëse themeluesi i deponisë i cili posedon leje për depini kryen monitorim dhe kontroll të punës së deponisë dhe ndikimi i saj në mjedisin jetësor në pajtim me nenin 83 të këtij ligji;
- 50) nëse themeluesi i deponisë në raport të ndërprerjes së punës në deponi vepron në pajtim me nenin 84 të këtij ligji;
- 51) nëse themeluesi i deponues, edhe pas ndërprerjes së punës në deponi gjegjësisht mbylljes së tij e mirëmban dhe kujdeset për deponinë në pajtim me kushtet e lejes dhe në pajtim me nenin 85 të këtij ligji;
- 52) nëse instalimet e djegies punojnë në pajtim me rregullat për djegie dhe kushtet e lejes në pajtim me neneve 87 dhe 88 të këtij ligji;
- 53) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me impiantit të djegies posedon dhe punon në pajtim me lejen përkatëse për djegie të mbeturinave (neni 89 të këtij ligji);
- 54) nëse operatori i instalimit për djegie gjatë pranimit të mbeturinave vepron në pajtim me nenin 90 të këtij ligji;
- 55) nëse operatori i instalimit të djegies vepron me mbetjet e djegies në pajtim me nenin 91 të këtij ligji;
- 56) nëse subjekti i mbikëqyrjes importon mbeturina në kundërshtim me nenin 93 të këtij ligji;
- 57) nëse eksporti, importi dhe transiti i mbeturinave kryhet në mënyrë dhe procedurë të përshkruar në pajtim me nenin 96 të këtij ligji;
- 58) të kryej kontroll dhe këqyrje vallë leja, gjegjësisht pajtueshmëria për eksport, import dhe transit të mbeturinave përdoret në kundërshtim me qëllimin për të cilin është lëshuar (neni 97 të këtij ligji);
- 59) nëse subjektet mbikëqyrëse që menaxhojnë me mbeturinat ndërmarrin masa dhe aktivitete në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe
- 60) kryen edhe veprimtari të tjera brenda kompetencës së tij të përcaktuar me këtë ligj.

## **Neni 117**

### **Miratimi i aktvendimeve të inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor**

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektoratit, inspektori i mjedisit jetësor me aktvendim:
- 1) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse vlerësimi i karakteristikave të mbeturinave kryhet në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji;
  - 2) do të ndalojë ose kufizojë punën e personit juridik të akredituar nëse nuk ka akreditim adekuat në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;
  - 3) do të ndalojë përdorimin e lëndës së parë sekondare në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji;
  - 4) do të ndalojë përdorimin e mbeturinave që kanë pushuar të jenë mbeturina në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji;
  - 5) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të përpilojë program për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;
  - 6) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dorëzojë raport vjetor për zbatimin e programeve të përmendura në nenin 29 të këtij ligji;
  - 7) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndërmarrë masa dhe aktivitete në përputhje me dokumentet strategjike, planifikuese dhe programore sipas nenit 30 të këtij ligji;

- 8) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndërmarrë veprimtari dhe të kujdeset për mbeturinat në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;
- 9) do të sekuestrojë mbeturinat e gjetura te subjekti i mbikëqyrjes në kundërshtim me nenin 37, paragrafi (5) të këtij ligji;
- 10) do të ndalojë ose kufizojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse përpunimi i mbeturinave kryhet në kundërshtim me nenet 39 dhe 40 të këtij ligji;
- 11) do të ndalojë ose kufizojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse deponimi i mbeturinave bëhet në kundërshtim me nenin 41 të këtij ligji;
- 12) do të ndalojë ose kufizojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse përcakton se vendi ku do të kryhet ruajtja, riciklimi, trajtimi ose përpunimi i mbeturinave nuk i plotëson kushtet e këtij ligji;
- 13) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse ajo kryen largimin e mbeturinave në kundërshtim me nenet 43 dhe 44 të këtij ligji;
- 14) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të veprojë në pajtim me nenin 46 të këtij ligji;
- 15) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes që të angazhojë menaxhues për mbeturina, gjegjësisht menaxhues të lartë për mbeturina në pajtim me nenet 47, 48 dhe 49 të këtij ligji;
- 16) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes, menaxhuesin e mbeturinave ose menaxhuesin e lartë të mbeturinave i cili nuk ka vërtetim gjegjësisht certifikatë për provim profesional të dhënë, të sigurojë një vërtetim, gjegjësisht certifikatë në pajtim me nenet 47, 48 dhe 49 të këtij ligji;
- 17) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes, të dhënat nga evidenca për mbeturinat të udhëheq, ruan dhe vepron në pajtim me nenin 50, paragrafin (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 18) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse nuk vepron në pajtim me nenin 50 paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji;
- 19) do të obligojë subjektin e mbikëqyrjes që formularët e nenit 50 paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji t'i dorëzon deri te organi kompetent;
- 20) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes me formularët të nenit 50, paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji, të vepron në pajtim me nenin 50, paragrafi (6) të këtij ligji;
- 21) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dhënat e evidencës të llojit të raportit konsoliduar ti dorëzon deri te organi kompetent (neni 50, paragrafi (7) dhe (8) të këtij ligji);
- 22) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes me të dhënat nga evidenca të veprojë në pajtim me nenin 50, paragrafi (10) të këtij ligji;
- 23) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme kryhet në kundërshtim me nenin 51 të këtij ligji;
- 24) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse mbeturinat e rrezikshme janë të përziera me lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji;
- 25) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse përzien mbeturinat e rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave, substancave dhe materie pa njoftuar organin profesional dhe vepron në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji;
- 26) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse mbeturinat e rrezikshme për transport, përpunim, ruajtje dhe asgjësim nuk janë të paketuara dhe të shënuara në pajtim me nenin 54 të këtij ligji;
- 27) do të obligojë ofruesin e shërbimit, përkatësisht operatorin e qendrës rajonale për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme të mbledhura nga amvisëritë që të veprojnë në pajtim me nenin 55, paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji;
- 28) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse me mbeturinat mjekësore vepron në kundërshtim me nenin 56 të këtij ligji;
- 29) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse mbeturinat nga dioksidi i titanit menaxhohen në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji;
- 30) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse mbeturinat e azbestit dhe mbeturinat nga produktet që përmbajnë asbest menaxhohen në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji;
- 31) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse me PCB menaxhon në kundërshtim me nenin 59 të këtij ligji;

- 32) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes i cili menaxhon me mbeturina të siguron leje adekuate për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;
- 33) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse nuk i plotëson kushtet e shënuara në leje;
- 34) do të detyrojë investitorin të dorëzojë studim të fizibilitetit në pajtim me nenin 66, paragrafi (3) të këtij ligji;
- 35) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dorëzojë kërkesë për ndryshimin e lejes për menaxhimin e mbeturinaveve në pajtim me nenin 67, paragrafi (6) dhe (7) të këtij ligji;
- 36) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dorëzojë kërkesë për regjistrim në pajtim me nenin 68 të këtij ligji;
- 37) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse nuk ka lidhur marrëveshje me subjektet që posedojnë leje adekuate për menaxhimin e mbeturinave;
- 38) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse vepron në kundërshtim me nenin 71 të këtij ligji;
- 39) do të kufizojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse vepron në kundërshtim me nenin 73 të këtij ligji;
- 40) do të ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse bën deponimin e mbeturina pa pasur leje adekuate për deponim (neni 75 të këtij ligji);
- 41) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes i cili nuk i plotëson kushtet e shënuara në lejen e deponisë (neni 75 të këtij ligji);
- 42) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse në deponitë për mbeturina hedh mbeturina në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji;
- 43) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të përmbushë kërkesat në lidhje me mbeturinat e biodegradueshme në përputhje me nenin 79, paragrafi (5) të këtij ligji;
- 44) do të kufizojë ose të ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse kryen hedhjen e mbeturinave të papranueshme në deponi në pajtim me nenin 79 të këtij ligji;
- 45) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse largimin e mbeturinave e kryen në klasa të papërshtatshme të deponive, si dhe largimi i mbeturinave bëhet në kundërshtim me nenin 80 të këtij ligji;
- 46) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të paguajë tarifën e deponimit të nenit 82 të këtij ligji;
- 47) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të bëjë monitorim dhe kontroll të funksionimit të deponisë në pajtim me nenin 83 të këtij ligji;
- 48) do të detyrojë themeluesin e deponisë të veprojë në pajtim me nenin 84 të këtij ligji;
- 49) do të detyrojë themeluesin e deponisë pas ndërprerje së saj me punë gjegjësisht mbylljes të kujdeset dhe ta mirëmban në pajtim me kushtet në leje dhe në nenin 85 të këtij ligji;
- 50) do të ndalojë funksionimin e impiantit të djegies nëse vepron në kundërshtim me neneve 87 dhe 88 të këtij ligji;
- 51) do të ndalojë funksionimin e impiantit të djegies nëse vepron në kundërshtim me lejen dhe dispozitat e nenin 89 të këtij ligji;
- 52) do të ndalojë funksionimin e impiantit të djegies nëse ai kryen veprimtari pa leje të adekuate (neni 89 të këtij ligji);
- 53) do të ndalojë funksionimin e impiantit të djegies, nëse pas marrjes së mbeturinave, vepron në kundërshtim me nenin 90 të këtij ligji;
- 54) do të ndalojë funksionimin e impiantit të djegies nëse me mbetjet e djegies vepron në kundërshtim me nenin 91 të këtij ligji;
- 55) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse importi i mbeturinave kryhet në kundërshtim me nenin 93 të këtij ligji;
- 56) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse kryen import, eksport ose transit të mbeturinave në kundërshtim me nenin 96 të këtij ligji;
- 57) do sekuestrojnë mbeturinat me të cilat është kryer importi, eksporti ose transiti i mbeturinave për të cilat nuk është dhënë leja ose pëlqim në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
- 58) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndër marrë masa dhe aktivitete për eliminimin e mangësive të konstatuara në pajtim me dispozitat e këtij ligji;



59) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjekti të mbikëqyrjes, nëse nuk vepron me mbeturinat në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

60) të ndalojë përkohësisht ose përgjithmonë të gjitha veprimet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose rregullativat e miratuara në bazë të këtij ligji ose dispozitat të tjera strategjike në menaxhimin e mbeturinave në përputhje me dokumentet strategjike dhe të planifikimit për menaxhimin e mbeturinave, si dhe të urdhërojë kthimi në gjendjen e mëparshme.

(2) Nëse gjatë kryerje së mbikëqyrjes së inspektorit nga inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor vërteton se subjekti i mbikëqyrjes i cili menaxhon me mbeturina nuk i përmbahet ligjit dhe rregullativat tjera, rregullativave, standardeve dhe rekomandimeve teknike dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do të përcakton parregullsi dhe çrregullime, ashtu në që aktvendim do ta përcakton afatin në të cilën duhet të eliminohet ato parregullsi.

(3) Nëse subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk vepron në pajtim me aktvendimin e inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor dhe nuk i eliminojnë shkaqet e gjendjes së gjetur të përcaktuar me aktvendim, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor do të inicioj kundërvajtje para organit kompetent për kundërvajtje si dhe do të nis procedura për marrjen e lejes, pëlqimet dhe autorizime.

(4) Në raste kur do të vërtetohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejt të jetës dhe shëndetit të njeriut, inspektori do të jep urdhër me gojë për largim urgjent dhe të paprolonguar të mangësive të përcaktuar të cilat në procesverbal do i konstatojnë në bashkëpunim me Inspektorin shtetëror sanitar dhe shëndetësor, si dhe do e njoftojnë Inspektorin shtetëror sanitar dhe shëndetësor, si dhe inspektorët kompetent të organeve shtetërore për parregullsitë e konstatuara dhe do të kërkon intervenim të tyre

(5) Nëse parregullsitë dhe çrregullimet e konstatuara të paragrafit (4) të këtij neni, paraqesin rrezik për ndotje të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut, inspektori menjëherë do e ndalojë punën e instalimit, objektit, aparaturave, stacionit, si dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarisë.

(6) Në rastet sipas paragrafit (4) të këtij neni, inspektori sjellë aktvendim në afat prej 48 orësh nga dhënia e urdhrit me gojë.

(7) Për kryerje të punëve të paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i mjedisit jetësor ka të drejtë të ndërmarrë edhe masat të tjera të përcaktuar me Ligjin e Mjedisit Jetësor.

(8) Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor mund të parashtrohet ankesë në pajtim me rregullativat për mbikëqyrje të inspektoratit.

## **Neni 118**

### **Fushëveprimi i inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor i Qytetit të Shkupit (në tekstin e më tutjeshëm: inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor) bën këqyrje dhe kontroll:

1) nëse personi juridik i akredituar për vlerësimin e karakteristikave të mbeturinave vepron në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji;

2) nëse personi juridik i akredituar posedon akreditim përkatës në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

3) nëse subjekti i mbikëqyrjes përdor lëndë në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

4) nëse subjekti i mbikëqyrjes vepron në pajtim me nenin 19 të këtij ligji;

5) nëse subjekti i mbikëqyrjes sipas nenit 27 të këtij ligji ka përpiluar program për menaxhim të mbeturinave dhe a ka vepruar në pajtim me nenin 27 të këtij ligji

6) nëse subjekti i mbikëqyrjes sipas nenit 27 të këtij ligji ka dorëzuar raport vjetor për zbatimin e programeve tek organi kompetent në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;

7) nëse masat dhe aktivitetet e subjektit të mbikëqyrjes i cili menaxhon me mbeturina janë në përputhje me dokumentet strategjike, të planifikimit dhe të programit, të nenin 30 të këtij ligji;

8) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhon me mbeturina në pajtim me nenin 37 të këtij ligji

9) nëse subjektet që menaxhojnë mbeturinat, e blejnë mbeturinat në pajtim me dispozitat e këtij ligji (neni 37, paragrafi (5) të këtij ligji);

10) nëse subjekti i mbikëqyrjes lë, hedh mbeturina në lokacione të cilat nuk janë të përcaktuar për atë dedikim, si dhe djeg dhe largon mbeturina në kundërshtim me rregullativat për menaxhimin e mbeturinave (neni 37, paragrafi (6) të këtij ligji);

11) nëse pronari ose shfrytëzuesi i pronës menaxhon mbeturinat në pronën e tij në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;

12) të detyrojë pronarin, në fakt shfrytëzuesin e pronës ta largon mbeturinë i cili është mbledhur ose ruajtur në pronë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 38, paragrafi (4) të këtij ligji);

13) nëse mbeturinat ruhen në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;

14) nëse subjekti i mbikëqyrjes të cilët bëjnë përpunimin e mbeturinave, a e kryen atë përpunim në pajtim me nenin 39 të këtij ligjit dhe me përdorimin e operacioneve për përpunim sipas nenit 40 të këtij ligji;

15) nëse subjekti i mbikëqyrjes mbeturinë e largon në mënyrë të përcaktuar me nenin 43 dhe me përdorimin e operacioneve të nenit 44 të këtij ligji;

16) nëse subjekti i mbikëqyrjes ka emëruar menaxhues të mbeturinave, gjegjësisht menaxhues të lartë të mbeturinave dhe a posedon vërtetim ose certifikatë përkatëse (neni 47, 47 dhe 48 të këtij ligji);

17) nëse subjekti i mbikëqyrjes mban evidencë në pajtim me nenin 50 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;

18) nëse subjekti i mbikëqyrjes, personave të obliguar për transport të mbeturinave ju jep formularë transportues dhe identifikues në pajtim me nenin 50, paragrafi (4) të këtij ligji;

19) nëse subjekti i mbikëqyrjes vepron në pajtim me nenin 50, paragrafi (5) të këtij ligji

20) nëse subjekti i mbikëqyrjes formularët e nenit 50, paragrafit (4) dhe (5) të këtij ligji i ruan si pjesë përbërëse e evidencës së plotë të menaxhimit të mbeturinave (neni 50, paragrafi (6) të këtij ligji);

21) nëse subjekti i mbikëqyrjes të dhënat e evidencës të llojit të raportit konsolidues i dorëzon deri te organet kompetente në pajtim me nenin 50, paragrafin (7) dhe (8) të këtij ligji;

22) nëse subjekti i mbikëqyrjes të dhënat e evidencës i ruan në pajtim me nenin 50, paragrafi (10) të këtij ligji

23) nëse ofruesi i shërbimit publik vepron me mbeturinat e rrezikshme në pajtim me nenin 55 të këtij ligji;

24) nëse ofruesi i shërbimeve ka vendosur kontejnerë për mbledhje dhe seleksionim të mbeturinave (neni 62, paragrafi (1) të këtij ligji);

25) nëse ofertuesi i shërbimit ka organizuar qendra për mbledhje në pajtim me nenin 62, paragrafin (2) të këtij ligji;

26) nëse subjekti i mbikëqyrjes me mbeturinat komunale dhe komerciale vepron në pajtim me nenin 63 të këtij ligji;

27) nëse subjekti i mbikëqyrjes të cilët krijojnë mbeturina komerciale a bëjnë seleksionimin e mbeturinave në vendin e krijimit në pajtim me nenin 63, paragrafi (1) të këtij ligji;

28) nëse krijuesit e mbeturinave komerciale a posedojnë marrëveshje të veçantë për mbledhje dhe transport të mbeturinave në pajtim me nenin 63, paragrafi (2) të këtij ligji;

29) nëse subjekti i mbikëqyrjes posedon leje përkatëse për menaxhimin e mbeturinave të lëshuar në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

30) nëse subjekti i mbikëqyrjes menaxhimin me mbeturina e kryen sipas kushteve dhe lejes (neni 64 të këtij ligji);

31) nëse subjekti i mbikëqyrjes të cilët menaxhojnë me mbeturina aktivitetet dhe veprimtarit e tyre i kryen mbi bazë të aktit në të cilën kryet veprimtarit dhe aktivitete si dhe rregullativat ligjore nga fusha e menaxhimit të mbeturinave, dhe

32) si dhe përcakton gjendje tjera në kompetencë të tij në pajtim me dispozitat të këtij ligji dhe ligj tjetër.

(3) Në raste kur është vërtetuar ekzistimi i mbeturinave në pronë private në pajtim me paragrafin (1), pika 11) të këtij neni, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor është i obliguar menjëherë ta njoftojë kryetarin e komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

(4) Për veprimtaritë të paragrafit (1) pikat 10),11), 12), 24), 25), 26), 27), 28) и 32) të këtij neni, mbikëqyrje kryejnë edhe inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave në Qytetin e Shkupit.

### **Neni 119**

#### **Miratimi i aktvendimeve të inspektoratit të autorizuar të mjedisit jetësor**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrje së inspektoratit, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor me aktvendim:

1) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse vlerësimi i karakteristikave të mbeturinave kryhet në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji

2) do të ndalojë ose kufizojë punën e personit juridik të akredituar nëse nuk ka akreditim adekuat në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

3) do të ndalojë përdorimin e lëndës së parë sekondare në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji;

4) do të ndalojë përdorimin e mbeturinave që kanë pushuar të jenë mbeturina në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji;

5) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të përpilojë program për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

6) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dorëzojë raport vjetor për zbatimin e programeve të përmendura në nenin 29 të këtij ligji

7) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndërmarrë masa dhe aktivitete në përputhje me dokumentet strategjike, planifikuese dhe programore sipas nenit 30 të këtij ligji;

8) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndërmarrë veprimtari dhe të kujdeset për mbeturinat në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;

9) do të sekuestrojë mbeturinat e gjetura te subjekti i mbikëqyrjes në kundërshtim me nenin 37, paragrafi (5) të këtij ligji;

10) do të ndalojë të gjitha aktivitetet e lënies, hedhjes, lëshimit,si dhe të djegies së hedhurinave në vende që nuk janë për këtë dedikim dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 37 paragrafi (6) të këtij ligji);

11) do të ndalojë përdorimin e aparaturave dhe impianteve të cilat nuk posedojnë leje adekuate të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

12) do të detyrojë pronari gjegjësisht shfrytëzuesin të pronës të vepron në pajtim me dispozitat e nenit 38 të këtij ligji;

13) do të ndalojë ose kufizojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse me mbeturinat nuk vepron në pajtim me nenet 39 dhe 40 të këtij ligji

14) do të ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse bën ruajtjen e mbeturinave në vendet të cilat nuk janë parashikuar për këtë dedikim (neni 41 të këtij ligji);

15) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse ajo kryen largimin e mbeturinave në kundërshtim me nenet 43 dhe 44 të këtij ligji;

16) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të angazhojë menaxhues të mbeturinave, përkatësisht një menaxher të lartë të mbeturinave në pajtim me nenet 47, 48 dhe 49 të këtij ligji;

17) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes, menaxhuesin e mbeturinave ose menaxhuesin e lartë të mbeturinave i cili nuk ka vërtetim gjegjësisht certifikatë për provim profesional të dhënë, të sigurojë një vërtetim, gjegjësisht certifikatë në pajtim me nenet 47, 48 dhe 49 të këtij ligji

18) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes, nëse të dhënat nga evidenca për mbeturinat udhëhiqen, ruhen dhe veprohet me mënyrë në kundërshtim me nenin 50, paragrafin (1), (2) dhe (3) të këtij ligji

19) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes nëse vepron në kundërshtim me nenin 50 paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji;

20) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes nëse formularët e nenit 50 paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji nuk i dorëzon deri te organit kompetent

21) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes me formularët të nenit 50, paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji, të vepron në pajtim me nenin 50, paragrafi (6) të këtij ligji;

22) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të dhënat e evidencës të llojit të raportit konsoliduar ti dorëzon tek organi kompetent (neni 50, paragrafi (7) dhe (8) );

23) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes me të dhënat nga evidenca të veprave në pajtim me nenin 50, paragrafi (10) të këtij ligji;

24) do të detyrojë ofruesin e shërbimit publik me mbeturinat e rrezikshme të veprave në pajtim me nenin 55 të këtij ligji;

25) do të detyrojë ofruesin e shërbimeve të vendos kontejner për mbledhje dhe seleksionim të mbeturinave (neni 62, paragrafi (1) të këtij ligji)

26) do të detyrojë ofruesin e shërbimit të organizon qendra për mbledhje në pajtim me dispozitat e këtij ligji (neni 62, paragrafi (2) të këtij ligji);

27) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes, nëse nuk vepron me mbeturinat në pajtim me këtë ligj;

28) do të kufizojë dhe ndalojë punën e subjekti të mbikëqyrjes, nëse mbledhja dhe transportimi i mbeturinave kryet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

29) do të detyrojë krijuesin/poseduesin e mbeturinave komerciale të bëjë seleksionimin, mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komerciale në pajtim me nenin 63, paragrafi (1) të këtij ligji;

30) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes që krijojnë ose posedojnë mbeturina komerciale, nëse nuk kanë lidhur marrëveshje me ofruesin e shërbimit për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale (neni 63, paragrafi (2) të këtij ligji);

31) do të detyrojë subjektet e mbikëqyrjes të veprave në pajtim me dispozitat e nenit 63 të këtij ligji;

32) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes që menaxhon me mbeturina të sigurojë një leje të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

33) do të kufizojë ose ndalojë punën e subjektit të mbikëqyrjes i cili nuk i plotëson kushtet e përshkruara në leje;

34) do të detyrojë subjektin e mbikëqyrjes të ndërmarrë masa dhe aktivitete për eliminimin e mangësive të konstatuara në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

35) ndalon vazhdimin e veprimtarive dhe aktiviteteve që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe atje kur është e nevojshme heqja e tyre, dhe

36) të ndalojë përkohësisht ose përgjithmonë të gjitha veprimet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose rregullativat e miratuara në bazë të këtij ligji ose dispozitat të tjera strategjike në menaxhimin e mbeturinave në përputhje me dokumentet strategjike dhe të planifikimit për menaxhimin e mbeturinave, si dhe të urdhërojë kthimin në gjendjen e mëparshme.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektorit nga inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor vërteton se subjekti i mbikëqyrjes i cili menaxhon me mbeturina nuk i përmbahet ligjit dhe rregullativat e tjera, rregullativave, standardeve dhe rekomandimeve teknike dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do të përcaktojë parregullsi dhe çrregullime, ashtu që në aktvendim do ta përcaktojë afatin në të cilën duhet të eliminohet ato parregullsi.

(3) Nëse subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk vepron në pajtim me aktvendimin e inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor dhe nuk i eliminojnë shkaqet e gjendjes së gjetur të përcaktuar me aktvendim, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor do të iniciojë kundërvajtje para organit kompetent për kundërvajtje si dhe do të nis procedura për marrjen e lejes, pëlqimet dhe të autorizimit.

(4) Në raste kur do të vërtetohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejt të jetës dhe shëndetit të njeriut, inspektori do të jep urdhër me gojë për largim urgjent dhe të paprolonguar të mangësive të përcaktuara të cilat në procesverbal do të konstatojnë në bashkëpunim me Inspektorin shtetëror sanitar dhe shëndetësor, si dhe do ta njoftojë inspektorin shtetëror sanitar dhe shëndetësor, si dhe inspektorët kompetentë të organeve shtetërore për parregullsitë e konstatuara dhe do të kërkojë intervenim të tyre

(5) Nëse parregullsitë dhe çrregullimet e konstatuara të paragrafit (4) të këtij neni, paraqesin rrezik për ndotje të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut, inspektori menjëherë do ta ndalojë punën e instalimit, objektit, aparaturave, stacionit, si dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarisë.

(6) Në rastet sipas paragrafit (4) të këtij neni, inspektori sjellë aktvendim në afat prej 48 orësh nga dhënia e urdhrit me gojë.

(7) Për kryerje të punëve të paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i mjedisit jetësor ka të drejtë të ndërmarrë edhe masat të tjera të përcaktuara me Ligjin e Mjedisit Jetësor.

(8) Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor mund të parashtrohet ankesë në pajtim me rregullativat për mbikëqyrje të inspektoratit.

### **Neni 120**

#### **Fushëveprimi i inspektorit shtetëror shëndetësor dhe sanitar**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektoratit shtetëror shëndetësor dhe sanitar kryen mbikëqyrje vallë subjektet që menaxhojnë me mbeturina mjekësore e mbledhin, seleksionojnë dhe e paketojnë mbeturinë mjekësore në pajtim me dispozitat e këtij neni.

(2) Inspektoratit shtetëror shëndetësor dhe sanitar kryerjen e mbikëqyrjes së inspektoratit sipas paragrafit (1) të këtij neni, e kryen në pajtim me rregullativat për inspektim sanitar dhe shëndetësor të këtij ligji.

### **Neni 121**

#### **Fushëveprimi i inspektorit shtetëror komunal**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori komunal kryen këqyrje dhe kontroll:

1) nëse pronari ose përdoruesi i pronës administron mbeturinat në një mënyrë në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji (neni 38 të këtij ligji);

2) nëse ofruesi i shërbimit publik vepron me mbeturinat e rrezikshme në pajtim me nenin 55 të këtij ligji;

3) nëse ofruesi i shërbimit ka vendosur kontejnerë për mbledhjen dhe përzgjedhjen e mbeturinave në vendet e përcaktuara nga kryetari i komunës (neni 62, paragrafi (1) të këtij ligji);

4) nëse mbeturinat e amvisërisë mbledhen ndaras nga mbeturinat e tjera dhe në vendet e caktuara për mbledhjen e mbeturinave të rrezikshme të amvisërisë (neni 62 të këtij ligji);

5) nëse personat fizikë i lënë mbeturinat e rrezikshme veçmas nga mbeturinat e tjera amvisërisë në pajtim me nenin 63 paragrafi (3) të këtij ligji

6) nëse subjekti i mbikëqyrjes, mbeturinë komunale e lë në vend të përcaktuar për mbledhje dhe seleksionim në pajtim me nenin 62 të këtij ligji;

7) të përcaktojë nëse ofruesit e shërbimeve në pajtim me nenin 62, paragrafi (1) të këtij ligji kanë vendosur kontejnerë për mbledhjen dhe seleksionimin e mbeturinave komunale të përmendura në nenin 62, paragrafi (3) në këtë ligj dhe

8) nëse krijuesit e mbeturinave komerciale kanë lidhur një marrëveshje për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave me ofruesin e shërbimit në pajtim me nenin 63 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Inspektori shtetëror komunal kryerjen e mbikëqyrjes së inspektoratit sipas paragrafit (1) të këtij neni, e kryen në pajtim me rregullativat për veprimtari komunale dhe të këtij ligji.

### **Neni 122**

#### **Kompetencat e Komisioni Rregullator për monitorimin e zbatimit të tarifës së mbeturinave**

(1) Komisioni Rregullator është kompetent për monitorim të zbatimit të aktvendimit për përcaktim të tarifës për mbeturina dhe tarifës rregullatore për mbeturina të këtij neni.

(2) Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni Rregullator nga ofruesi i shërbimit për nevojat e mbikëqyrjes mund të kërkon të dhëna dhe informacione për zbatim të planeve dhe aktvendimit për përcaktim të tarifës për mbeturina.

(3) Komisioni Rregullator ka të drejtë në çdo kohë, me paralajmërim ose pa paralajmërim të kryen kontroll te ofruesi i shërbimit me qëllim të përcakton se vallë:

- ofruesi i shërbimit ka parashtruar kërkesë për përcaktimin e tarifës në pajtim me nenin 107, paragrafi (4) të këtij ligji;

- të dhënat që i ka dorëzuar ofruesi i shërbimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji janë të besueshme dhe të sakta dhe janë në përputhje me evidencë e kontabilitetit dhe dokumentet tjera të ofruesi të shërbimit (neni 107, paragrafi (12) të këtij neni);

- vendimi i ofruesit të shërbimit sipas nenit 108, paragrafit (14) dhe pëlqimi sipas nenit 108, paragrafi (15) të këtij ligji janë në pajtueshmëri me aktvendimin për përcaktimin e tarifës për mbeturinat nga ana e Komisionit Rregullator .

- kryetari i komunës ose Qytetit të Shkupit e ka dorëzuar vendimin sipas nenit 108, paragrafi (15) të këtij ligji te këshilli i komunës për marrjen e pëlqimit.

- ofruesi i shërbimit i ka harmonizuar vendimet e saj me vendimet e miratuara nga ana e Komisionit Rregullator (neni 109, paragrafi (3) të këtij ligji);

- ofruesi i respekton kushtet nën të cilat është përcaktuar tarifa e mbeturinave i plotëson objektivat e ndërlidhura me indikatorët kyç të suksesit në lidhje me sigurimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale (neni 109, paragrafi (4) të këtij ligji);

- në shërbim ka filluar ta zbatojë tarifën e miratuar për mbeturina (neni 109 paragrafu (1) të këtij ligji) dhe

(4) Gjatë kryerjes së inspektimit, ofruesi i shërbimit është i detyruar t'i sigurojë Komisionit Rregullator hyrjen në hapësirat e saj, si dhe ta dorëzojë në kontroll dokumentacionin e plotë të nevojshme për kryerjen e inspektimit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Për inspektimin e kryer, Komisioni Rregullator përpilon procesverbal të cilën e dorëzon deri te ofruesi i shërbimit

(6) Bazuar në procesverbalin sipas paragrafit (5) të këtij neni, Komisioni Rregullator ka të drejtë të iniciojë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para organit kompetent për kundërvajtje.

(7) Në raste kur ofruesi i shërbimit nuk paguan kompensimin e nenit 106, paragrafi (2) të këtij ligji, Komisioni Rregullator ka të drejtë të informojë ofruesin e shërbimit për detyrimin dhe pasojat ligjore dhe ta detyrojë atë brenda një periudhë e caktuar, e cila mund të zgjasë më shumë se 90 ditë për kryerjen e pagesës.

(8) Në raste kur ofruesi i shërbimit nuk vepron në pajtim me rekomandimet sipas paragrafit (5) të këtij neni, Komisioni Rregullator është e obliguar të ngrit procedurë për pagesë të plotfuqishëm të kompensimit sipas nenit 106, paragrafi (2) të këtij ligji, në pajtim me rregullativat për përmbarrim.

### **Neni 123**

#### **Mbikëqyrje mbi formularët e mbeturinave**

(1) Punëtori i organit të administratës shtetërore përgjegjës për punët në fushën e punëve të brendshme ka të drejtë dhe detyrim të ndalojë një automjet që transporton mbeturina dhe të inspektojë nëse automjeti është shënuar siç duhet në pajtim me ligjin, si dhe nëse ka dokumentet e nevojshme në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

(2) Organi doganor ka të drejtë dhe detyrim të inspektojë dhe kontrollojë nëse personat që transportojnë mbeturina posedojnë formularët e transportit dhe identifikimit dhe t'i paraqesin/raportojnë ato në përputhje me nenin 50, paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji dhe nëse mbeturinat e rrezikshme që transportohen është shënuar dhe paketuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji (neni 54, paragrafi (4) të këtij ligji).

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektoratit sipas paragrafit (1) të këtij neni, mbikëqyrja kryhet në pajtim me rregullativat për punë të brendshme dhe të këtij ligji.

(4) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektoratit sipas paragrafit (2) të këtij neni, mbikëqyrja do të kryhet në përputhje me rregullativat doganore dhe të këtij ligji.

### **Neni 124**

#### **Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera në mbikëqyrjen e inspektoratit**

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektoratit zbatohen dispozitat e rregullativës për mjedis jetësor, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është rregulluar.

## **Neni 125**

### **Përgjegjësitë e personave zyrtar**

(1) Personat zyrtar në organin e mjedisit jetësor, duke i përfshirë edhe organet në përbërje, si dhe personat zyrtar të organeve komunale, të qytetit të Shkupit janë të detyruar, si persona përgjegjës në kohë dhe në mënyrë efikase ti ndërmarrin të gjitha masat dhe procedurat e nevojshme për zbatim të këtij ligji.

(2) Nëse gjatë zbatimit të masave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, vërtetohen shkelje nga ana e personit juridik ose fizik se janë bërë me veprim ose mosveprim ose ka lënë mbikëqyrjen e detyruar mbi personin tjetër i cili ka qenë i autorizuar të vepron në emër të personit juridik, si dhe duke paraqitur të dhëna dhe dokumente të pasakta dhe të rreme, personat zyrtar janë të detyruar të iniciojnë ose të kërkojnë të fillojnë një procedurë kundërvajtëse në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Personat juridikë dhe fizikë për të cilët sigurohen të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, nëse përcaktojnë ekzistimin e shkeljes ose tejkalimit të autorizimeve nga personat zyrtar sipas paragrafit (1) të këtij neni, të kryera me veprime ose mosveprim, janë të detyruar të informojnë ministrin i cili udhëheq organin e mjedisit jetësor, përkatësisht kryetarin e komunës, e Qytetit të Shkupit dhe e komunave të Qytetit të Shkupit.

(4) Në rast të përcaktimit të shkeljeve të kompetencave të personave zyrtarëve sipas paragrafit (1) të këtij neni, ministri që udhëheq organin e mjedisit jetësor, përkatësisht kryetari i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe komunave të Qytetit të Shkupi është i detyruar të ngritë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së personit zyrtar në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

## **Neni 126**

### **Kompetenca e tjera**

(1) Inspektori i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor janë të detyruar të ngritin fletëparaqitje kundërvajtjes deri te organet kompetent për kundërvajtje për nisjen e procedurës për kundërvajtje, nëse gjatë mbikëqyrjes vërejnë bazë për të.

(2) Inspektori i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar janë të obliguar ta njoftojnë organin e mjedisit jetësor nëse gjatë mbikëqyrjes së inspektoratit ka vërtetuar se personi juridik ose fizik i cili menaxhon me mbeturina duke kryer ose mos kryer shkelje të rëndësishme të kushteve dhe detyrimeve nga leja ose akreditimi.

(3) Nëse inspektori nuk ngre fletëparaqitje për procedurë kundërvajtëse në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, do të llogaritet se ka bërë shkelje të rëndë të vendit të punës.

## **Neni 127**

### **Vërejtjet**

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrja e inspektoratit, inspektorit i mjedisit jetësor vërteton se janë bërë parregullsi të nenit 27 dhe 29 të këtij ligjit për herë të parë, është i obliguar me procesverbal ti konstatojë parregullësitë e përcaktuara dhe me aktvendim të shqipton masë vërejtje dhe të përcakton afat në të cilën subjekti i mbikëqyrjes së inspektoratit është i obliguar ti eliminon parregullsitë të përcaktuara me procesverbal në pajtim me Ligjin e Mbikëqyrjes së Inspektoratit.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrja e inspektoratit, inspektorit i autorizuar vërteton se janë bërë parregullsi të nenit 27 dhe 29 të këtij ligjit për herë të parë, është i obliguar me procesverbal ti konstatojë parregullësitë e përcaktuara dhe me aktvendim të shqipton masë vërejtje dhe të përcakton afat në të cilën subjekti i mbikëqyrjes së inspektoratit është i obliguar ti eliminon parregullsitë të përcaktuara me procesverbal në pajtim me Ligjin e Mbikëqyrjes së Inspektoratit.

(3) Inspektoratit shtetëror i mjedisit jetësor mban evidencë të veçantë për vërejtjet e shqiptuara.

(4) Forma dhe përmbajtja e evidencës së vërejtjeve të shqiptuara e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e mjedisit jetësor.

## Neni 128

### **Mbikëqyrje të punës ligjore të organeve të komunës dhe organeve për menaxhim rajonal të mbeturinave**

(1) Mbikëqyrje të punës ligjore të njësive organizative, organeve të komunës, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit bazuar në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësisë dhe pavarësisë në ushtrimin e kompetencave të tyre.

(2) Mbikëqyrja sipas paragrafit (1) të këtij neni e kryen organi i mjedisit jetësor.

(3) Gjatë kryerje së mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi i mjedisit jetësor, i kryen këto detyra::

- monitoron punën e organeve të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit në lidhje me përpilimin, miratimin dhe zbatimin e planeve, programeve dhe akteve të tjera;

- monitoron punën nëse këshillat e komunave dhe këshilli i qytetit të Shkupit, me propozimin e bordit ndërkomunal për menaxhimin me mbeturinave sipas nenit 32 të këtij ligji, miraton plan rajonal për menaxhimin e mbeturinave për rajonin sipas nenit 24 të këtij ligji;

- monitoron punën e njësisë organizative në koordinim me komunat e rajonit përkatës, dhe a vepron në pajtim me nenin 36 të këtij ligji;

- monitoron punën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës dhe Qytetit të Shkupit në përputhje me obligimet e komunës dhe Qytetit të Shkupit për menaxhimin me mbeturinat komunale dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme;

- vlerëson nëse organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit përpilojnë, miratojnë dhe zbatojnë planet dhe programet, si dhe dorëzimin e raporteve për zbatimin e tyre në përputhje me procedurat e përcaktuara me këtë ligj;

- vlerëson nëse kryetari i komunave dhe Qytetit të Shkupit monitoron dhe kujdeset në mënyrë adekuate për zbatimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese për menaxhimin me mbeturina;

- monitoron punën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit për krijimin e sistemit rajonal për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

- monitoron punën e bordit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave ai zbaton detyrimet për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

- monitoron punën e njësisë organizative ai zbaton detyrimet për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

- vlerëson nëse kryetarët e komunave dhe qyteti i Shkupit ka miratuar akte për mirëmbajtjen e pastërtisë publike dhe trajton me mbeturinat e braktisura në hapësirat publike dhe të trafikut në zonat urbane dhe në zonat jorbane në territorin e tij dhe monitoron mënyrën e zbatimit të tyre;

- vlerëson nëse kryetarët e komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë përcaktuar vendet për grumbullim dhe seleksionimin e mbeturinave komunale, si dhe monitoron mënyrën e zbatimit të tyre;

- vlerëson zbatimin e parimit të universalitetit të shërbimeve;

- vlerëson nëse komunat dhe Qyteti i Shkupit kanë miratuar rregulla për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe llojeve të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme dhe monitoron zbatimin e tyre;

- vlerëson nëse kryetarët e komunave dhe Qyteti i Shkupit kanë përcaktuar vendet për grumbullim, trajtim dhe asgjësimin e mbeturinave inerte dhe monitoron mënyrën e zbatimit të tyre;

- vlerëson nëse njësia organizative, komunat dhe Qyteti i Shkupit kanë krijuar një sistem informacioni për menaxhimin e mbeturinave jo të rrezikshme dhe nëse të dhënat nga sistemi i informacionit janë përpunuar dhe dorëzuar tek organi ekspert (profesional);

- vlerëson nëse njësia organizative dhe Qyteti i Shkupit kanë krijuar një Kadastër të krijuesve të mbeturinave dhe monitoron mënyrën e menaxhimit të tij;

- vlerëson nëse njësia organizative, komunat dhe Qyteti i Shkupit kanë publikuar të dhënat për menaxhimin me mbeturina;



- u tregon organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe propozon masat e duhura për tejkalimin e asaj situatë;
- tregon mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e njësisë organizative, organeve të komunës dhe qytetit të Shkupit, të cilat mund të parandalojnë realizimin e të drejtës së publikut për qajse deri te informata dhe pjesëmarrje në miratimin e vendimeve dhe të drejta të tjera dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër;
- jep rekomandime për zbatimin e vazhdueshëm të kompetencave të komunës dhe Qytetit të Shkupit për aktivitetet që duhet të kryhen në pajtim me këtë ligj, me kërkesë të organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit;
- monitoron miratimin në kohë të dokumenteve të planifikimit dhe akteve të tjera nga njësi organizative, komunat dhe Qyteti i Shkupit;
- paraqet iniciativa dhe propozime deri te njësitë organizative, organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit, nëse konstatojnë mos zbatimin e këtij ligji, si rezultat i një konflikti të kompetencave ndërmjet tyre;
- monitoron ligjshmërinë e aktvendimeve që kryetari i komunës i miraton në punët administrative, siç janë detyrimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë në pajtim me këtë ligj;
- ofron mendime dhe ndihmë profesionale me kërkesë të njësisë organizative, organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit në propozim të dokumenteve të planifikimit dhe aktet e tjera që dalin nga ky ligj;
- monitoron realizimin e mbikëqyrjes së mëparshme mbi aktet për të cilat në pajtim me këtë ligj është kompetente të miratojë;
- monitoron realizimin e publikut në punën e njësisë organizative, organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit në realizimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj nga aspekti i njoftimit të rregullt, në kohë, të vërtetë dhe të plotë të qytetarëve;
- monitoron nëse komuna dhe Qyteti i Shkupit dhe njësi organizative veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me financimin e tyre dhe
- informon me kohë njësinë organizative, organet e komunës dhe qytetit të Shkupit për kushtet e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë mbikëqyrjes.

## **Neni 129**

### **Marrja e kryerjes së kompetencave**

(1) Në qoftë se edhe përkundër vërejtjeve, masave dhe aktivitete e ndërmarra, njësi organizative për menaxhim rajonal me mbeturina, organet e komunës, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit nuk i sigurojnë kryerjen e punëve për të cilat ata janë kompetent në pajtim me këtë ligj, ju merren kompetencat për kryerjen e punëve.

(2) Kryerja e punëve sipas paragrafit (1) të këtij ligji, i ndërmerr organi për mjedis jetësor, më së shumti deri një vet nga dita e marrjes së tyre, në emër dhe në llogarit të njësisë organizative për menaxhim rajonal me mbeturina, komuna dhe Qyteti i Shkupit.

(3) Për ndërmarrjen e punëve të paragrafit (1) të këtij neni, njoftohet organi i administratës shtetërore kompetent për punë të fushës së vetëqeverisje lokale dhe organi i administratës shtetërore kompetent për punë të fushës së financimit.

(4) Organi i mjedisit jetësor, kryerjen e punëve të paragrafit (1) të këtij neni e kryen në emër dhe në llogarit të njësisë organizative për menaxhim rajonal me mbeturina, komunat dhe Qyteti i Shkupit.

## **XV. DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE**

### **Neni 130**

#### **Sanksionet kundërvajtëse të kategorisë së parë**

(1) Gjobë në shumën prej 9,000 deri në 10,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 18,000 deri në 20,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 53,000 deri në 59,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga

88,000 deri në 98,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje subjektit nëse:

1) nuk ka përpiluar program për menaxhimin e mbeturinave dhe nuk e ka dorëzua deri tek organi kompetent (neni 27 të këtij ligji);

2) nuk ka dorëzuar raport vjetor për realizim të programit për menaxhimin e mbeturinave (neni 29 të këtij ligji);

3) ka vepruar në kundërshtim me rregullat për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 37 të këtij ligji;

4) nuk ka emëruar menaxhues me mbeturina gjegjësisht menaxhues të lartë të mbeturinave në pajtim me nenin 48 dhe 49 të këtij ligji;

5) ka emëruar person për menaxhues me mbeturina ose menaxhues të lartë i cili nuk posedon vërtetim përkatës, gjegjësisht certifikatë (neni 48 dhe 49 të këtij ligji);

6) nuk mban evidencë përkatëse për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me nenin 50, paragrafin (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;

7) të dhënat nga evidenca të llojit të raportit të konsoliduar nuk i dorëzon deri te organet kompetente (neni 50, paragrafi (7), (8) dhe (9) të këtij ligji);

8) të dhënat nga evidenca nuk i ruan në pajtim me nenin 50, paragrafin (10) të këtij ligji;

9) ofruesit e shërbimeve nuk vendosin kontejnerë për mbledhjen dhe seleksionimin e mbeturinave dhe mbledhjen e veçantë të mbeturinave të rrezikshme nga amvisëritë (neni 62, paragrafi (1) të këtij ligji);

10) ofruesit e shërbimeve nuk organizojnë qendra grumbullimi në pajtim me nenin 62, paragrafi (2) të këtij ligji;

11) nuk bëjnë seleksionim të mbeturinave komerciale në vendin e krijimit të tyre në kontejnerë të veçantë në pajtim me nenin 63, paragrafi (1) të këtij ligji;

12) nuk lidhin marrëveshje për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave në pajtim me nenin 63, paragrafi (2) të këtij ligji dhe

13) nuk ka dorëzuar njoftim për regjistrim (neni 68, paragrafi (1), alineja 1 të këtij ligji

(2) Personi përgjegjës i personit juridik për veprimtarinë sipas paragrafit (1) të këtij neni do ti shqiptohet gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit për personin juridik të mikro tregtisë, 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, 3.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe 5.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë të denarit do ti shqiptohet personit fizik për veprimtarinë sipas paragrafit (1) të këtij ligji.

(4) Kryerësi i kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksion kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë.

(5) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksionin kundërvajtës për ndalimin e kryerjes së detyrës.

(6) Organ kompetent kundërvajtës për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni është gjykata kompetente, ndërsa organi kompetent kundërvajtës për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse sipas paragrafit (3) të këtij neni është Komisioni për kundërvajtje të formuar në pajtim me Ligjin e Mjedisit Jetësor (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni për kundërvajtje).

### **Neni 131**

#### **Kundërvajtje e kategorisë së dytë**

(1) Gjobë në shumën prej 13,000 deri në 14,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 25,000 deri në 28,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 76,000 deri në 84,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga 126,000 deri në 140,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje subjektit nëse:

1) kryen përpunim të mbeturinave në kundërshtim me nenet 39 dhe 40 të këtij ligji;

2) mbeturinat ruhen jashtë vendit të përcaktuar për atë dedikim dhe është në kundërshtim me nenin 41 të këtij ligji;

3) kryhet largimi i mbeturinave në kundërshtim me nenet 43 dhe 44 të këtij ligji;

4) me formularët transportuese dhe identifikuese nuk vepron në pajtim me nenin 50, paragrafi (4) të këtij ligji;

5) gjatë importit, eksportit dhe tranzicionit të mbeturinave, personi juridik i cili kryen transport të mbeturinave nuk ka 0 dhe (8) të këtij ligji deri te organi kompetent për kryerjen e punëve doganore (neni 50, paragrafi (5) të këtij ligji);

6) formularët e nenit 50, paragrafi (4) dhe (5) të këtij ligji nuk i ruan si pjesë përbërëse e evidencës së përgjithshme të menaxhimit të mbeturinave (neni 50, paragrafi (6) të këtij ligji dhe

7) nuk vepron në pajtim në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe mbeturina të llojeve tjera jo të rrezikshme (neni 63, paragrafi (5) të këtij ligji).

(2) Personi përgjegjës i personit juridik për veprimtarinë sipas paragrafit (1) të këtij neni do ti shqiptohet gjobë në shumë prej 700 euro në kundërvlerë të denarit për personin juridik të mikro tregtisë, 1.500 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, 4.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe 7.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj.

3) Kryerësi i kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksion kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë.

4) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksionin kundërvajtës për ndalimin e kryerjes së detyrës.

(5) Organ kompetent kundërvajtës për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga ky nen është gjykata kompetente.

## **Neni 132**

### **Kundërvajtje e kategorisë së tretë**

(1) Gjobë në shumën prej 18,000 deri në 20,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 36,000 deri në 40,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 110,000 deri në 120,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga 180,000 deri në 200,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

1) vlerësim të llojit dhe karakteristika e mbeturinave kryhet në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji;

2) kontroll të karakteristikave të mbeturinave kryen personi i cili nuk posedon akreditim për vlerësim të karakteristikave të mbeturinave (neni 17 të këtij ligji);

3) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji ;

4) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 19 të këtij ligji ;

5) nuk i respekton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme (neni 51 të këtij ligji);

6) e përzien mbeturinë e rrezikshme me llojet e tjera të mbeturinave të rrezikshme dhe/ose e përzien me lloj tjerët të mbeturinave, substancave dhe/ose materie në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji;

7) menaxhon me mbeturinat e përziera të rrezikshme në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji;

8) paketohet dhe shënohet si mbeturin e rrezikshme në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji ;

9) mbeturina e rrezikshme e amvisërisë nuk mblidhet në pajtim me nenin 55 të këtij ligji ;

10) mbeturinat mjekësore trajtohen në kundërshtim me dispozitat e nenit 56 të këtij ligji;

11) mbeturinat e dioksidit të titanit trajtohen në kundërshtim me dispozitat e nenit 57 të këtij ligji;

12) mbeturinat e azbestit dhe produktet që përmbajnë azbest trajtohen në kundërshtim me dispozitat e nenit 58 të këtij ligji);

13) me PCB-në vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 59 të këtij ligji);

1) kryen veprimtari për menaxhimin e mbeturinave pa leje përkatëse (neni 64 të këtij ligji);

15) nuk i plotëson kushtet e lejes (neni 64 të këtij ligji);

16) nuk ka dorëzuar një studim të fizibilitetit në përputhje me nenin 66, paragrafi (3) të këtij ligji;

17) nuk ka dorëzuar kërkesë për ndryshim të lejes për menaxhimin e mbeturinave për shkak të kushteve të ndryshuara dhe në afatin e parashikuar në pajtim me nenin 67, paragrafi (6) dhe (7) të këtij ligji;

18) në deponin për mbeturina industriale jo të rrezikshme hedh mbeturina në kundërshtim me nenin 71, paragrafi (8) dhe (9) të këtij ligji;

19) në deponin për mbeturina të rrezikshme hedh mbeturina në kundërshtim me nenin 72 paragrafi (7) dhe (8) të këtij ligji;

20) nuk posedon leje për deponi (neni 75 të këtij ligji);

21) nuk i plotëson kushtet në lejen për deponi në pajtim me nenin 75 të këtij ligji;

22) në deponi hedh mbeturina në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji;

23) largon mbeturina e cila nuk është e pranueshme në deponin në kundërshtim me nenin 79 të këtij ligji ;

24) pranon mbeturina që nuk korrespondojnë me klasën e deponisë (neni 80 të këtij ligji);

25) nuk paguan taksë për deponim të mbeturinave (neni 82 të këtij ligji) ;

26) nuk monitoron dhe kontrollon funksionimin e deponisë në pajtim me nenin 83 të këtij ligji;

27) deponia ka ndërprerë me punë në kundërshtim me nenin 84 të këtij ligji;

28) nuk kujdeset për deponin pas ndërprerjes së saj me punë në pajtim me nenin 85 të këtij ligji ;

29) nuk i plotëson detyrimet e nenit 86, paragrafi (1) të këtij ligji;

30) instalimi i djegies funksionon në kundërshtim me kushtet e lejes dhe nenin 87 të këtij ligji ;

31) instalimi për djegie nuk i plotëson kushtet e lejes në pajtim me nenin 89 të këtij ligji;

32) operatori i instalimit të djegies pas marrjes së mbeturinave nuk vepron në pajtim me nenin 90 të këtij ligji;

33) operatori i instalimit të djegies vepron me mbetjet e djegies në kundërshtim me nenin 91 të këtij ligji;

34) kryen import të mbeturinave në kundërshtim me nenin 93 të këtij ligji;

35) kryen eksport, import , transit të mbeturinave në kundërshtim me nenin 96 t[ këtij ligji dhe

36) kryen aktivitete në kundërshtim me lejen e dhënë gjegjësisht pajtueshmëritë e dhëna në pajtim me nenin 97 të këtij ligji.

(2) Personi përgjegjës i personit juridik për veprimtarinë sipas paragrafit (1) të këtij nenit do ti shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për personin juridik të mikro tregtisë, 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, 6.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj.

(3) Kryerësi i kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksion kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë.

(4) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi kompetent për kundërvajtje mund të shqiptojë sanksionin kundërvajtës për ndalimin e kryerjes së detyrës.

(5) Organ kompetent kundërvajtës për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga ky nen është gjykata kompetente.

### **Neni 133**

#### **Kundërvajtja për tarifën e mbeturinave**

(1) Gjobë në shumën prej 4,000 deri në 5,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 9,000 deri në 10,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 26,000 deri në 29,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga 43,000

deri në 48,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje për ofruesit e shërbimeve nëse:

- nuk ka të dorëzuar kërkesë për përcaktimin e tarifës për mbeturinë deri te Komisioni Rregullator në pajtim me nenin 107, paragrafi (4) të këtij ligji;

- nuk është dorëzuar vendim për përcaktimin e tarifës në afat prej 15 ditësh në pajtim me nenin 108, paragrafi (14) të këtij ligji;

- vendim për përcaktimin e tarifës sipas nenit 108, paragrafi (14) të këtij ligji nuk është dorëzuar në afat prej tetë ditësh nga miratimi i saj deri te kryetari i komunës ose qyteti i Shkupit (neni 108, paragrafi (14) të këtij ligji);

- zbatim të tarifës së miratuar për mbeturinë gjegjësisht të tarifës së miratuar rregullatore për mbeturinë nuk ka filluar të zbatohet në afat prej 45 ditësh në pajtim me nenin 109 paragrafi (1) të këtij ligji dhe neni 110, paragrafi (10) të këtij ligji ;

- nuk i ka harmonizuar vendimet me aktvendimet e miratuara nga ana e Komisionit Rregullator (neni 109, paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumën prej 6,000 deri në 7,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 13,000 deri në 14,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 37,000 deri në 41,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga 62,000 deri në 69,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje për ofruesit e shërbimeve nëse:

- të dhënat e bashkangjitura në kërkesën nuk janë të sakta dhe të besueshme dhe nuk janë në përputhje me evidencën e kontabilitetit dhe dokumenteve tjera të ofruesit të shërbimeve (neni 107, paragrafi (12) të këtij ligji;

- nuk i respekton kushtet në bazë të cilës është përcaktuar tarifa për mbeturina (neni 109, paragrafi (4) të këtij ligji dhe

- nuk ka siguruar qasje në hapësirat personale për kryerjen e kontrollit të Komisionit Rregullator dhe nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e plotë në këqyrje e nevojshme për kryerjen e kontrollit (neni 122, paragrafi (4) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumën prej 9,000 deri në 10,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mikro ekonomisë, nga 18,000 deri në 22,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, nga 53,000 deri në 59,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe nga 88,000 deri në 98,000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj do t'ju shqiptohet për kundërvajtje për ofruesit e shërbimeve nëse:

- ka paguar çmim për mbeturina në tarifën e të cilës nuk është e lejuar nga ana e Komisionit Rregullator (neni 105, paragrafi (12) të këtij ligji) dhe

- nuk ka filluar me zbatim të tarifave të miratuara për mbeturina në periudhë më të gjatë se gjashtë muaj nga dita që është dashur të fillon me zbatim të tarifës së miratuar për mbeturina (neni 109, paragrafi (2) dhe neni 109, paragrafi (10) të këtij ligji).

(4) Personi përgjegjës i personit juridik për veprimtarinë sipas paragrafit (1), (2) dhe (3) të këtij nenit do ti shqiptohet gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtarin, 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e vegjël, 3.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mesëm dhe 5.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtarët e mëdhenj.

(5) Organ kompetent kundërvajtës për kundërvajtje nga ky nen është gjykata kompetente.

## **Neni 134**

### **Sanksionet kundërvajtëse për personat fizik**

(1) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nëse ai lë, hedh dhe/ose lë çdo lloj mbeturine (vajra mbeturinash, mbeturina ndërtimi, goma të mbeturinave dhe lloje të tjera të mbeturinave) në natyrë ose në rrugë (neni 37 paragrafi (6) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë të denarit, do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nëse largon (djeg dhe/ose varros) çdo lloj mbeturine (goma të mbeturinave, vajra të mbeturinave dhe lloje të tjera të mbeturinave) në natyrë dhe/ose rrugë (neni 37 paragrafi (6) të këtij ligji).

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë të denarti, do t'i shqiptohet personit fizik për veprimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nëse ato lihen, hidhen ose braktisen nga afër ujërave ose në trupa ujore (lumenj, liqene, pellgje, kënetë, e të ngjashme).

(4) Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit fizik nëse ai nuk bën seleksionimin dhe nuk e hedh mbeturinat në kontejnerë të veçantë për atë qëllim në pajtim me nenin 63, paragrafi (3) të këtij ligji.

(5) Organi kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga ky nen është Komisioni për Kundërvajtje.

### **Neni 135**

#### **Sanksionet kundërvajtëse për personat zyrtar**

(1) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit zyrtar nëse nuk i shpallë të dhënat për menaxhimin e mbeturinave (neni 102 të këtij ligji).

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet kryetarit të Komunës nëse:

- vepron në kundërshtim me nenin 28, paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk vepron në pajtim me nenin 38, paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk i propozon kushtet, mënyrën dhe skemat e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në pajtim me nenin 61, paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk cakton vende për mbledhje dhe qendra për mbledhje në pajtim me nenin 62 të këtij ligji.

(2) Organi kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga ky nen është gjykata kompetente.

### **Neni 136**

#### **Procedurat për shlyerje dhe marrëveshje**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 130 të këtij ligji, inspektorët kompetent janë të detyruar që kryesit të kundërvajtjes t'i propozojnë një procedurë shlyerjeje me lëshimin e urdhrin të pagesës për kundërvajtje para se të paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 131 dhe 132 të këtij ligji, inspektorët kompetent janë të detyruar t'i propozojnë kryesit të kundërvajtjes procedurë për marrëveshje në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për kundërvajtje

(3) Ministri i cili udhëheq me organi e mjedisit jetësor e përshkruan formën dhe përmbajtjen e urdhrin për pagesë për kundërvajtje.

### **Neni 137**

#### **Udhëheqja e procedurës për kundërvajtje**

Procedura për kundërvajtje udhëhiqet në pajtim me rregullativat për kundërvajtje dhe rregullivate për mjedisin jetësor dhe Ligji për kundërvajtje.

## **XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 138**

#### **Miratimi i planeve dhe dokumenteve programuese për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Planet rajonale për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 24 të këtij ligji do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Plani i parandalimit për krijimin e mbeturinave sipas nenit 25 të këtij ligji miratohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Programet e menaxhimit të mbeturinave sipas nenit 27 të këtij ligji miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Plani për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031 të miratuar në pajtim me Ligjin për menaxhimin e mbeturinave („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16 dhe 63/16 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 31/20)., do vazhdojë të vlejë deri në skadimin e afatit të tij ose deri në miratimin e Planit sipas nenit 23 të këtij ligji.

(5) Planet rajonale në paragrafin (1) të këtij neni, të cilat miratohen deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në skadimin e tyre, ose deri në miratimin e planeve rajonale të menaxhimit të mbeturinave sipas nenit 24 të këtij ligji.

### **Neni 139**

#### **Mbyllja e deponive ekzistuese jostandarde dhe krijimi i deponive rajonale për mbeturina të parrezikshme**

(1) Organi për mjedis jetësor, kryetarët e Komunave dhe kryetarit i Qytetit të Shkupit do ti marrin të gjitha masat e domosdoshme për mbylljen e lokacioneve ekzistuese jostandarde për largim të mbeturinave të identifikuara në Planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031, të cilët nuk kanë leje për kryerjen e veprimtarisë për largim të mbeturinave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Njësia organizative sipas nenit 35 të këtij ligji, kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit në afat prej tre vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të obliguara të mbyllin dhe rikultivojnë lokacionet ekzistues jostandarde për largim të mbeturinave të paragrafit (1) të këtij ligji.

(3) Si përjashtim sipas paragrafit (1) të këtij neni, deri në themelimin e deponive rajonale të nenit 71, paragrafi (1) të këtij ligji, komunat dhe Qyteti i Shkupit nëpërmjet ofruesit të shërbimit të nenit 6, paragrafi (1), pika 25 e këtij ligji, largimi i mbeturinave komunale kryhet nga vendet e identifikuara jo standarde për largim të mbeturinave në territorin e tyre ose në një komunë tjetër më të afërt, e cila identifikohet si një vend me rrezik më të ulët ose të mesëm në pajtim me Planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031.

(4) Lokacionet e identifikuara për largim e mbeturinave me rrezik të lartë në pajtim me Planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031 nuk mund të përdoren nga komunat dhe Qyteti i Shkupit për largimin e mbeturinave.

(5) Deri në themelimin e deponive rajonale sipas nenit 71, paragrafi (1) të këtij ligji, kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit do ti ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për funksionimin më të sigurt të lokacioneve ekzistuese jostandarde për largimin e mbeturinave të identifikuara në Planin për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031.

(6) Kryetari i komunës dhe Qytetit të Shkupit menaxhon me mënyrën e punës dhe trajtimin e lokacioneve ekzistuese jostandarde për hedhjen e mbeturinave sipas paragrafit (3) të këtij neni, deri në krijimin e deponive rajonale për largimin e mbeturinave në rajonin e tyre.

(7) Nëse menaxhimi rajonal i mbeturinave nuk vendoset për një periudhë dhjetë vjeçare nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji, komunat dhe Qyteti i Shkupit largimin e mbeturinave do ta kryen në deponinë rajonale më të afërt e krijuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(8) Njësia organizative e përmendur në nenin 35 të këtij ligji, kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit brenda tre viteve nga ndërprerja e përdorimit të lokacioneve ekzistuese jostandarde për largim të mbeturinave janë të detyruar të mbyllin dhe rikultivojnë lokacionet ekzistuese jostandarde për largim të mbeturinave nga paragrafi (3) të këtij ligji.

### **Neni 140**

#### **Harmonizimi i punës së personave juridikë të cilët menaxhojnë mbeturinat dhe menaxhuesit e mbeturinave**

(1) Personat juridikë dhe personat fizikë që kryejnë veprimtari të menaxhimit me mbeturin janë të detyruar të harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji, në afat prej tre vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë të detyruar të kenë licencë për menaxhimin e mbeturinave, janë të detyruar ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj do të mbarojnë sipas dispozitave të Ligjit për menaxhimin e mbeturinave („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16 dhe 63/16 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 31/20).

#### **Neni 141**

##### **Mbledhja dhe seleksionimi i mbeturinave komunale dhe tarifat për mbeturina**

(1) Kryetari i Komunës dhe Qytetit të Shkupit në pajtim me nenin 62 të këtij ligji është i obliguar në afat prej 6 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të përcakton vende për mbledhje dhe selektim të mbeturinave komunale.

(2) Ofruesit e shërbimeve janë të detyruar që brenda gjashtë muajve pas caktimit të vendeve për mbledhje dhe seleksionimin e mbeturinave komunale të përcaktuara nga kryetari i komunës dhe qyteti i Shkupit sipas paragrafit (1) të këtij neni të vendosin kontejnerë për mbledhjen dhe seleksionimin e mbeturinave në përputhje me nenin 62 të këtij ligji.

(3) Personat juridikë dhe individë që posedojnë PCB, PCB të përdorura dhe pajisje që përmbajnë ose kanë përmbajtur PCB janë të detyruar të raportojnë sasinë, origjinën, natyrën dhe përmbajtjen e PCB, PCB të përdorura dhe pajisjet që përmbajnë ose kanë përmbajtur PCB, tek organi profesional, në afat prej një viti nga dita hyrja në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 142**

##### **Krijimi i sistemit rajonal**

(1) Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të detyruar të miratojnë vendim për lidhje të marrëveshjes për krijim të sistemit rajonal sipas nenit 31, paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Për secilin rajon, në bazë të nenit 32 të këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh duhet të themelohet bordi ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinaveve.

(3) Seanca e parë konstituive e bordit sipas nenit 32 të këtij ligji thirret nga kryetari i komunës me numrin më të madh të banorëve në rajonin e menaxhimit të mbeturinave, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Njësia organizative e nenit 35 të këtij ligji do të vendoset në afat prej gjashtë muaj nga dita e lidhjes së marrëveshjes për vendosje të sistemit rajonal.

(5) Njësia organizative sipas nenit 35 të këtij ligji themelohet brenda gjashtë muajve nga dita e lidhjes së marrëveshjeve për krijimin e sistemit rajonal.

(6) Marrëveshjet për krijimin e sistemit rajonal sipas nenit 31, paragrafi (1) të këtij ligji të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejshin.

(7) Njësitet organizative sipas nenit 35 të këtij ligji, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të funksionojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 143**

##### **Realizimi i provimit për menaxhimin e mbeturinave**

(1) Provimi i parë për menaxhuesit e mbeturinave gjegjësisht menaxhues i lartë për mbeturina sipas nenit 48 dhe 49 të këtij ligji do të mbahet në afat më së shumti 16 muaj nga dita e autorizimit të personit juridik sipas nenit 47, paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Komisioni sipas nenit 47, paragrafi (6) të këtij ligji, do të formohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Ministri do të autorizon person juridik sipas nenit 47, paragrafi (5) të këtij ligji në afat prej një viti nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

(4) Menaxhuesit e mbeturinave të cilët kanë dhënë provimin për menaxhues me mbeturina në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Mbeturinave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13,



51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16 dhe 63/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 31/20), në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji janë të obliguar të dorëzojnë kërkesë për regjistrim në listën sipas nenit 47, paragrafi (15) të këtij ligji.

#### **Neni 144**

##### **Tarifa e mbeturinave**

(1) Rregullativat nënligjore që dalin nga Kapitulli XIII “Financimi” të këtij ligji, të cilat i referohen përcaktimit të tarifës për mbeturina do të miratohen jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2022.

(2) Ofruesit e shërbimit për mbledhje (grumbullim) dhe transportimit të mbeturinave, kërkesat për përcaktimin e tarifës për mbeturina të nenit 107, paragrafi (4) të këtij ligji do të fillojnë të parashtrajnë nga 1 gusht 2023, ndërsa më së voni deri 31 dhjetor 2023.

(3) Dispozitat e Kapitullit XIII “Financimi” që i referohen pagesës së tarifës së mbeturinave do të fillojnë të zbatohen nga 1 qershor 2024.

#### **Neni 145**

##### **Miratimi i rregullativave**

(1) Rregullativa më të përafërta për zbatim të këtij ligji do të sillen në afat prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregullativave më të përafërta të paragrafit (1) të këtij nenit do të zbatohen rregullativat ekzistuese.

#### **Neni 146**

##### **Zbatimi i dispozitave për llojet dhe klasifikimi i mbeturinave**

Dispozitat e neneve 17, 18, 19 dhe 20 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e hyrjes në fuqi të rregullativave të nenin 17, paragrafi (2), nenit 18, paragrafi (16), nenit 19, paragrafi (2) dhe neni 20, paragrafi (6) të këtij ligji.

#### **Neni 147**

##### **Taksat për deponi**

Dispozitat e nenit 82 dhe nenit 132, paragrafi (1), pika 25 të këtij ligji kanë të bëjnë me vendosjen e taksës për deponim të mbeturinave e cila do të fillon të zbatohet me ditën e hyrjes të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

#### **Neni 148**

(1) Dispozitat e neneve 81, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112 dhe 122 të këtij ligji të cilat i referohen kompetencës së Komisionit Rregullativ për Energji dhe Shërbime të Ujit do të fillojnë të zbatohen brenda shtatë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Ligji i Energjetikës në të cilën është rregulluar kompetencat e Komisionit Rregullator, komisioni do të harmonizohet me dispozitat e këtij ligjit në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 149**

##### **Shfuqizimi**

(1) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligjit shfuqizohet Ligji i Menaxhimit të Mbeturinave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16 dhe 63/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 31/20).

(2) Me ditën e fillimit të zbatimit të Rregullores për përcaktim të tarifës për mbeturina të nenit 107 të këtij ligji pushon të vlejë Rregullorja për përlogaritjen e çmimit për mbledhje, transportim dhe largim të mbeturinave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ numër 30/13).

#### **Neni 150**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë të shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.